

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 398 JANAR 2024



Bashkësia Islame e Kosovës
Instituti për Hulumtime
dhe Studime Islame



KONFERENCË SHKENCORE
XHAMIA
TE SHQIPTARËT
histori, mision, identitet




Prishtinë, 9-10 dhjetor 2023

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME MYFTIUN
E KOSOVËS, NAIM EF. TËRNAVA

BESIMI NË ZOT, FAKTOR
QETËSUES I BREZIT TË HUTUAR

LIGJI DHE ETIKA E LUFTËS NË ISLAM

Dhe (mua më shpallet) se xhamitë vërtet janë
veçanërisht për ta adhuruar Allahun, e në to mos
adhuroni askënd tjetër krahas Allahut! (El Xhinn, 18)



EDITORIAL

- 4 Pëshpëritja e Islamit në veshët e brezit materialist

INTERVISTË

- 5 Intervistë ekskluzive me Myftiun e Kosovës, Naim ef. Tërnavë

FETARE

- 11 Komentimi i sures El Fet'h (11)
Sabri Bajgora
- 15 Paraqitja e madhe
Eduard Thartori
- 18 Besimi në Zot, faktor qetësues i brezit të hutuar
Hfz. Mehas Alija
- 20 Dëshpërimi i njeriut modern dhe nevoja e tij për besimin
Muhamed B. Sytari
- 23 Metamorfoza e karakterit njerëzor dhe nevoja për freskimin imanor
Ervin Qylafku
- 27 Shpresa e shoqëruar nga veprimi, parim avancues i besimtarit
Vahidin Beluli
- 31 Ligji dhe etika e luftës në Islam
Prof. dr. Mehmet Görmez
- 36 Kuptimi i haditheve në dritën e Kuranit fisnik
Dr. Muhamed Stublla



- 40 Formimi i xhematit të dytë në të njëjtën xhami për faljen e namazit që tashmë është falur njëherë
Myfti Ebrahim Desai

FAMILJE & EDUKIM

- 42 Edukimi si mision i (pa) përmbushur nga institucionet e Kosovës
Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi

HISTORI & CIVILIZIM


- 47 Beteja e Ankarasë - ngjarja që ndryshoi rrjedhën historike
Agon Krasniqi

REPORTAZH

- 51 U promovuan veprat e Myftiut Naim ef. Tërnavë
- 53 U mbajt Konferenca Shkencore "Xhamia te shqiptarët – histori, mision, identitet"

AKTIVITETE

- 56 U konstitua Kryesia e re e Bashkësisë Islame të Kosovës



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 398 • viti 37 • Janar 2024
• Xhumadel-Ahireh / Rexheb 1445
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.

Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net

Shtypi:
"NTG", Blendi



*“I dëshpëruar qoftë
robi i dinarit, i dësh-
përuar qoftë robi i
dërhemit...”*

(Buhariu, nr. 2887)

Pëshpëritja e Islamit në veshët e brezit materialist

Ta përshkruash tipologjinë psikosociale të brezit bashkëkohor dhe vorbullën e perceptimeve në të cilat sorollaten bijtë dhe bijat e kësaj shoqërie, duket një mision tejet delikat. Mbase për një soditës që vështron në heshtje prirjet dhe pasionet e tyre, këtu e gjetiu, do të bindet se ata ngarendin vullshëm drejt të panjohurës. Gara e frikshme në trasenë e luksit, marrosja pas epshit e parasë, si dhe tundimi pas jetës puro materialiste, ka marrë një trend të frikshëm të lëvizjes që i lë pa fjalë edhe ata që dikur pretendonin se kanë në dorë shkopin magjik për zgjidhjet e të gjitha krizave e problemeve shoqërore. Ky stil jetese, e ka bërë individin që të nëpërkëmbë detyrat e veta shoqërore e familjare, duke harruar se ai, pos që është thjesht një individ, për njerëzit që e rrethojnë, ai sigurisht se është edhe një prind, vëlla, bashkëshort, fqinj e bashkëqytetar. Ky tabor njerëzish, shtëpinë e kanë shndërruar thjesht në një bujtinë apo hotel, siç do të thoshte historiani e filozofi me nam, Will Durant, ku në të vetëm natën e kalojnë, pa ndier as prehje as qetësi, e pastaj në mëngjes do të vazhdojë secili në punën dhe rrugën e tij. Mund të duket etiketë jo e denjë, por këta jo rrallëherë iu bie të kenë harruar se janë njerëz, qenie humane e që në trupin e tyre fizik kanë edhe një shpirt.

Për këto kategori njerëzish që dikur mund të ishin të paktë, por sot përbëjnë një grumbull të madh, i Dërguari ynë, Muhamedi a.s., foli me një ton këndellës, kur tha: *“I dëshpëruar qoftë robi i dinarit, i dëshpëruar qoftë robi i dërhemit...”* (Buhariu, nr. 2887). Dinari dhe dërhemit në këtë tekst autentik profetik, nuk na u përmendën thjesht si monedha që mund të blihet e të shitet me to. Përtej kësaj janë përmendur si simbolikë e sinonim i gjithçkaje që është materiale e që i përket egos dhe lakmisë së shthurur të njeriut. “I dëshpëruar”, duket të jetë përkthimi më literal i tekstit të hadithit, përndryshe në komentet e dijetarëve të fushës gjejmë se hadithi mëton të quaj robin e dinarit e të dërhemit edhe njeri të mallkuar. Si të mos jetë kështu kur qenia më sublime, të cilës vetë Zoti i dha shpirt, të mbërthehet pas materies, e cila në fund të fundit është krejt pa shpirt. Këta, po që janë vetë robërit e dinarit dhe dërhemit, që mbetën të ngatërruar së pari me vetveten, por sigurisht edhe me të gjithë të tjerët që ende gjejnë kohë për të kërkuar paqen shpirtërore dhe sadopak njerëzi.

Për të vendosur pikat mbi shkronja, s’do harruar se Islami, nuk ka kërkuar nga njeriu që të ngulfatë kërkesat e tij trupore e fizike, që i përkasin natyrës materialiste, por ka kërkuar që përgjigjja ndaj atyre kërkesave të mos bëhet asnjëherë në kurriz të atyre shpirtërore e vlerore, pa të cilat njeriu, shumë pak mbetet njeri. Allahu na e kërkoj këtë ekuilibrim kur na tha: *“Dhe me atë që të ka dhënë Allahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos le mangët atë që të takon nga kjo botë, dhe bëj mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty, e mos bën të këqija në tokë, se Allahu nuk i do çrregulluesit.”* (El Kasas, 77). Kërkesa për të mos lënë mangët hisen tonë nga kjo botë, jo aksidentalisht, vije pas asaj që të fitojmë botën tjetër, ngase ajo, e jo kjo botë, është e përhershëmja pa mbarim. Ky mesazh i ekuilibruar kuranor, edhe më kumbueshëm se sa në epokën kur ka zbritur, i flet sot brezit modern që dashurinë ndaj materiales e ka injektuar pamëshirshëm si një “narkozë” në gjakun e vet të njomë. Ai dhe shumë citate të tjera hyjnore, janë një kurë e vërtetë për shqetësimet sociale, për pasigurinë, dhunën, frikën dhe ankthin, nga çka duket që nuk po kursehen shumë nga anëtarët e shoqërisë sonë.

Është ekuacion i dijshtëm se zhytja në pasione e teprimi në lukse materialiste janë prerogativë e natyrshme e privimit nga një paqe shpirtërore e individuale dhe na sjellin doemos deri te një deficit i kënaqësisë dhe kohezionit shoqëror. Ajo e para derivon të dytën. Kështu po krijohet një brez që duket se posedon “gjithçka”, por në realitet nuk kënaqet dhe nuk ndien shije shpirtërore për asgjë. Kohën e as luksin për eksperimente të reja nuk e kemi. Mbase edhe trokitja për ndihmë në derën e gabuar, është aventurë që gjithnjë shtrenjtë ka kushtuar, andaj me ç’arsye sërish të njëjtën ne duhet provuar!

E po, Islami, ka shumë për të thënë në këtë rrafsh, vetëm duhet dëgjuar pa paragjykim të thënat e tij!

Mr. Driton Arifi

Intervistë ekskluzive me Myftiun e Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim ef. Tërnavën

“Misioni ynë është që sa më mirë dhe sa më drejt ta shpjegojmë fjalën e të Madhit Zot”

I nderuari Myfti, shprehim mirënjohjen dhe falënderimin tonë në emër të redaksisë së “Diturisë Islame”, për gatishmërinë tuaj për intervistë, njëherësh e lusim Allahun Fuqiplotë që të të falë shëndet e mirëqenie në jetë, por edhe ta lehtësojë barrën fisnike në punën tuaj në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës!

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit! Së pari ju uroj juve si kryeredaktor i “Diturisë Islame” që përmes kësaj reviste po arrini të depërtoni nëpër të gjitha shtëpitë e besimtarëve të besimit islam, dhe që po kontribuoni që kjo revistë të jetë edhe më afër lexuesve tanë fisnikë e bujarë, e që përmes saj, të edukohen me mësimet e drejta burimore, fisnike islame, që dalin nga Kurani, thëniet e Muhamedit a.s., nga thëniet e dijetarëve të ndryshëm nga bota mbarë, mirëpo edhe prej teologëve të vyeshëm e të arsimuar, që i ka përgatitur tashmë kombi ynë këtu brenda në Kosovë, por edhe brenda trojeve tona etnike shqiptare. Është më se e vërtetë që unë para dy muajsh, edhe një herë jam rizgjedh si Myfti i Republikës së Kosovës, si kryetar i Bashkësisë Islame, andaj edhe në këtë rast, dëshiroj t’i falënderoj të gjithë ata kolegë, vëllezër të mi, xhematin e mreku-llueshëm që kemi, të cilët më dhanë besimin e plotë, e kjo për mua do të thotë shumë. Do të thotë që, përkundër asaj që kemi arritur dhe kemi korrë suksese të shumta në rrafshet të ndryshme, si në infrastrukturë, arsim, edukim, dhe në fusha të tjera, gjithashtu kjo më shtyn dhe më motivon mua dhe të gjithë kolegët e mi në Kryesinë e BI-së dhe anekënd Republikës sonë, që ta ndiejmë

edhe më shumë përgjegjësinë tonë në shpirt, në zemër e në mendje, ngaqë është një përgjegjësi hyjnore, të cilën e kemi marrë mbi supet tona, që ta bartim, ta kumtojmë, ta shpjegojmë e ta transmetojmë drejt e mirë te masa e gjerë e popullit tonë këtu në Kosovë. Andaj besoj që edhe kësaj radhe na duhet bashkërisht një unitet i madh, siç jemi mësuar ta kemi në mesin e teologëve, imamëve e nëpunësve të Bashkësisë Islame, e me këtë unitet do t’ia dalim të korrim suksese të reja dhe do të punojmë për një të ardhme sa më të mirë të vendit tonë në edukimin dhe fisnikërimin e mirëfilltë të mësimëve fisnike islame.

I nderuari Myfti, meqë ju i prini një institucioni, shumica dërmuese e punëtorëve të të cilit janë imamë-prijës fetarë islamë dhe



Na duhet bashkërisht një unitet i madh, siç jemi mësuar ta kemi në mesin e teologëve, imamëve e nëpunësve të Bashkësisë Islame, e me këtë unitet do t’ia dalim të korrim suksese të reja dhe do të punojmë për një të ardhme sa më të mirë të vendit tonë në edukimin dhe fisnikërimin e mirëfilltë të mësimëve fisnike islame.

të tjerë, a mund të na thoni se cili duhet të jetë roli i një imami brenda shoqërisë tonë, tani, por edhe në të ardhmen?

Dëshiroj që me këtë rast, t'i falënderoj të gjithë imamët tanë, anekënd Republikës sonë, për kontributin e dhënë edhe para, por edhe tash pas luftës në Kosovë. Të gjithë ata kanë bërë një punë jashtëzakonisht të madhe, të mrekullueshme në vetëdijesimin e gjithmbarshëm të besimtarëve të besimit islam në Kosovë. Mirëpo, gjatë punës, sigurisht se kemi pasur raste ku kemi pasur dobësi, lëshime, edhe të qëllimta por edhe të paqëllimta, por që falë Zotit janë të pakta. Në disa raste, disa nga imamët tanë kanë kapërcyer apo kanë kaluar kompetencat, të cilat duhet t'i ketë një imam, duke dashur që të japin më shumë nga vetja e tyre, apo në disa raste edhe për të fituar simpati nga të tjerët, apo edhe për t'u përmendur emri i tij. Kemi raste kur imamët kanë tejkaluar edhe doktrinën e pastër burimore islame dhe profesionin fisnik që ka imami, dhe me këtë, paksa kanë devijuar nga realiteti që buron nga Kurani dhe thëniet e Muhamedit a.s.. Roli kyç i imamit, si në të kaluarën, por edhe tash, duhet të jetë edukimi i xhematit. Imami duhet të jetë brenda xhematit në raste të ndryshme, qofshin ato raste gëzimi, fatkeqësie apo edhe hidhërimi. Ai duhet të jetë në vazhdimësi në kontakt me xhematin e vet, në mënyrë që të mos lejojë që dikush nga jashtë të hyjë në xhematin e tij, për ta devijuar nga e drejta, që është rrugë e vetë Islamit, por edhe për ta larguar atë nga konditat dhe rregulloret që i ka Bashkësia Islame e Kosovës, e në këtë mënyrë t'ju hapet mundësia të tjerëve që të luajnë me fatin e xhematit tonë.

Cilat janë ato linjat e gjera dhe standardet e etabluara që duhet t'i respektojë një imam apo cildo nëpunës tjetër i Bashkësisë Islame, pos përgatitjeve shkencore që duhet t'i ketë plotësuar për të qenë puna dha angazhimi i tij më konstruktiv në shtetin tonë? A iu duhet atyre ndonjë riedukim i brendshëm edhe nga BIRK-u ?

Imami, e që në këtë rast edhe unë jam imam, dhe flas për të gjithë imamët pa përjashtim, e kemi një mision të përbashkët. Misioni është që sa më mirë dhe sa më drejt ta shpjegojmë falën e të Madhit Zot dhe porosinë e Muhamedit a.s.. Vlen të theksohet se para dy dekadave, kemi pasur vetëm 12% të imamëve me përgatitje superiore, derisa tashmë kemi mbi 80% të imamëve brenda Republikës sonë që kanë përgatitje superiore. Nëse para 20 vjetësh kemi pasur një

Hoxhallarët tanë, edhe në të kaluarën kanë qenë shumë të përgatitur dhe e kanë shpjeguar dhe e kanë shtjelluar Islamit burimor ashtu siç duhet te masa e gjerë e popullit.

doktor të teologjisë, sot kemi mbi 55 të tillë, e të mos flasim për magistratura e të tjera. Kjo vetvetiu dëshmon se pa liri, në asnjë mënyrë nuk do të mund t'i arrinim kapacitetet që i kemi arritur. Liria na e solli këtë mundësi dhe studentët tanë shkuan sikur "bletët" që dalin për ta kërkuar nektarin për ta sjellë në fole, e të kthehen në Kosovë që t'i kontribuojnë vendin të tyre. Sigurisht që gjatë këtyre studimeve kemi pasur raste, e që falë Zotit nuk janë numër i madh, që studentët tanë janë kthyer nga disa shtete me adete, zakone e tradita, të cilat bien ndesh me traditat e zakonet e kombit shqiptar. Edhe këtu Bashkësia Islame e Kosovës ka bërë një punë jashtëzakonisht të madhe në rivetëdijesimin e tyre për ta bërë dallimin mes traditës e zakonit që kanë kombe të ndryshme dhe atyre që ka vetë kombi shqiptar, që ato të mos përzihen, ngase sjellin vetëm të liga brenda kombit tonë. Sigurisht se në këtë drejtim është punuar shumë dhe mund të them se janë arritur rezultate të kënaqshme. Kemi punuar vazhdimisht që atyre t'ua bëjmë me dije se indoktrimimi i mundshëm, me mësim të cilat nuk i përkasin mësimëve burimore islame apo tentativat e individëve, grupeve të ndryshme që në një farë mënyre të devijojnë nga kursi i deritanishëm i jurisprudencës islame këtu brenda kombit shqiptar, qofshin ata në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, kudo që jetojnë, kanë qenë, janë dhe në të ardhmen do të jetë të pavend.

Hoxhallarët tanë, edhe në të kaluarën kanë qenë shumë të përgatitur dhe e kanë shpjeguar dhe e kanë shtjelluar Islamit burimor ashtu siç duhet te masa e gjerë e popullit. Asnjë imamë, në asnjë mënyrë, nuk guxon që të jetë në shërbim të dikujt tjetër, të punojë për interesa të dikujt tjetër, të punojë për interesa klanore, grupore, e të cilat mund të vijnë me sugjerime edhe nga jashtë Kosovës, në mënyrë që këtu brenda shoqërisë sonë të krijohet një turbulencë, e cila do t'i bënte dëm vetë Kosovës sonë, vetë

identitetit tonë kombëtar dhe fetar. Ne këtu duhet të jemi edhe më të fortë dhe më unikë, duke ua bërë me dije të gjithë atyre se Kosova është vendi ynë, është shteti ynë, për të cilin është derdhur gjak dhe kanë rënë me qindra e mijëra dëshmorë për ta fituar këtë liri të cilën ne sot e gëzojmë. Andaj, nisur nga ky parim, po ndërlihem me pjesën e dytë të pyetjes: BIK-u ka mbajtur trajnime me imamë, por edhe në mbledhjen e fundit të Kryesisë së BIK-ut, që është mbajtur para pak ditësh, është marrë një vendim, e i cili për mua është vendimi më me vend. Aty është vendosur që të gjithë

studentët, të cilët kryejnë studimet jashtë Kosovës, t'i nënshtrohen dy semestra Akademisë së Bashkësisë Islame, në mënyrë që, krahas mësimave që kanë marrë nëpër botë, ata të njihen edhe me realitetin që mbretëron në Kosovë. Pse? Sepse, ne duhet që vetes sonë mos t'ia lejojmë t'i kënaqim të tjerët me lëshimet, me pësimet tona.

Bashkësia Islame e Kosovës, tashmë disa çështje primare që ka pasur, siç ka qenë forcimi i kuadrit, shkollimi i tij, ngritja e infrastrukturës, mund të them që në një përqindje të madhe veçse i ka përfunduar, andaj besoj që ky mandat, do të jetë mandat ku ne do t'i kushtojmë rëndësi të madhe vetëdijesimit të imamëve, të nëpunësve tanë, mirëpo edhe të xhematit, ashtu që xhemati të mos bie pre e disa organizatave të huaja, të cilat janë në Kosovë, e të cilat kanë tentativa të vazhdueshme, dhe po them, janë të drejtuara direkt edhe kundër vetë shqiptarëve.

A mund të kemi një rifunksionalizim të rolit të imamëve për ta rikthyer institucionin e mejtepit, dhe të përgatitjes së një kurrikuleje unifikuese, e cila do të realizohej në tërë territorin e Kosovës, meqë kërkesa për futjen e lëndës fetare nëpër shkollat tona ende nuk po has në mirëkuptimin e qeveritarëve? Cili është edhe roli i mualimeve tashmë së fundi në këtë fushë?

Çdo imam, kur krijon marrëdhënie pune me Bashkësinë Islame të Kosovës, nënshkruan kontratë, ku obligohet edhe për mësim-besimin në xhami. Besoj që edhe kjo, aplikimi në shkollë, do të ndodh në të ardhmen e afërt, sepse tashmë është standard evropian. Por, kemi disa nga imamët, të cilët i ikën kësaj përgjegjësie. Kjo është për të ardhur keq, se përse imami nuk e ndien këtë përgjegjësi aq sa duhet në shpirtin e tij. Nesër kur do të dalim para Zotit, do të dalim me këtë vakum, do të dalim me këtë mungesë para Zotit, me atë që nuk e kemi mbajtur fjalën për diçka që jemi zotuar. Sigurisht se ka imamë të shumtë, të cilët në mënyrën më të mirë të mundshme i kryejnë këto detyra, dhe dëshiroj t'i përgëzoj për punën madhore që kanë bërë dhe që po bëjnë.

Siç potencuat edhe ju, mualimet janë ato, të cilat kohëve të fundit po japin një kontribut të jashtëzakonshëm në këtë drejtim. Unë kisha dashur që lënda fetare të futet nëpër shkollë, por në mungesë të saj, jemi detyruar që ta zhvillojmë mësimin në xhami, ashtu që fëmijët tanë të kenë mundësi, sikur bashkëmoshatarët e tjerë në Evropë, ta njohin fenë e tyre, ta dinë se cilës fe i përkasin, kush janë ata, cilat janë obligimet e tyre dhe cila është përgjegjësia e tyre. Kjo ne na imponohet si kërkesë, edhe për shkak të përhapjes së dukurive negative, siç është përdorimi i substancave narkotike, pastaj vetëvrasja si një dukuri e pasluftës, që ka një përqindje aq të madhe, sepse para luftës kemi pasur shumë rrallë ngjarje të tilla. Pastaj, dhuna në familje, në veçanti tash kohëve të fundit ndaj grave, ku fatkeqësisht kemi shumë gra që janë vrarë, mirëpo kemi edhe një dhunë sistematike ndaj tyre. E roli i imamit këtu është më se i domosdoshëm. Pastaj kemi fatkeqësi të shumta që po ndodhin në komunikacion, dhe kjo si rrjedhojë e mospërfilljes së direktivave, të cilat dalin nga Kurani dhe nga thëniet e Muhamedit a.s. për

ruajtjen e jetës sonë dhe të të tjerëve. Një dukuri tjetër, shumë rrëqethëse është vëllavrasja që e kemi brenda shoqërisë sonë. Këto edhe shumë të tjera, na tregojnë se ne imamët, por jo vetëm, mirëpo të gjitha institucionet e vendit, të gjitha strukturat, duhen bashkuar forcat në një, për t'i zbutur sadopak, edhe nëse nuk arrijmë t'i shërojmë tërësisht. Këto ndodhi sikur trokasim në zemrën, në shpirtin e në mendjen e çdonjërit prej nesh, në veçanti të imamit, i cili ka obligim, urdhër nga i Madhi Zot, që të japë kontribut në luftimin e gjërave të liga, të cilat kanë marrë hov, janë prezentë dhe po shtohen brenda shoqërisë sonë.

I nderuari Myfti, ne shqiptarët e Kosovës, duke qenë një komunitet me shumicë myslimane, që jetojmë në kontinentin evropian, si duhet që të ekuilibrojmë në njërën anë lidhjet shpirtërore që na lidhin me vendet e shenjta të cilat gjeografikisht janë në lindje (Mekë, Medinë), dhe në anën tjetër të mbajmë lidhjet gjeopolitike me perëndimin e instancat veri-atlantike ku e synojmë integrimin tonë në të ardhmen?

Jo vetëm Islami si fe, por edhe kombet e tjera që janë këtu, fetë, po them pasuesit e librave të shenjta në Evropë, që të gjithë, të krishterët, hebrenjtë, janë të lidhura me Lindjen, atje kanë vendzbritjen e shpalljeve dhe dërgimit të të dërguarve, andaj kjo është një e përbashkët e të gjithëve. Sikur ne që e kemi burimin atje, edhe të krishterët, edhe hebrenjtë, edhe protestantët, e kanë burimin atje. Pra të gjitha burimet janë të lidhura atje.

Diversiteti është prezent në shoqëritë evropiane. Shumica e evropianëve brenda Bashkimit Evropian i përkasin besimit të krishterë, dhe ne si myslimanë autoktonë, marrim pjesë vetëm me 5% brenda BE-së, ngase myslimanë autoktonë janë vetëm shqiptarët dhe boshnjakët. Ne jemi qytetarë, që Zoti na ka krijuar këtu në këtë vend, ky është vatani-atdheu ynë. Ky është vendi ynë dhe ne jemi pjesë e pandarë e Evropës. Besimet duhet të na afrojnë e jo të na ndajnë, të krijojmë ura miqësie edhe më të forta mes vete. Ne vazhdimisht duhet të trokasim në dyert e familjes së madhe evropiane, ngase aty e kemi vendin. A duhet ne të ndihemi të kompleksuar kur trokasim në këto dyer? Absolutisht jo! Unë jam evropian, i përkas këtij kontinenti dhe dëshiroj të ulem rreth sofrës evropiane, sepse Zoti këtu më ka krijuar. Meqë më ka krijuar këtu, unë kam obligim ndaj kombit shqiptar.

Përgjithësisht, ne, Shqipëria, Maqedonia e të tjerë, kudo që jetojnë shqiptarët, duhet t'ua bëjnë me dije evropianëve se besimi nuk guxon të jetë pengesë për integrimin sa më të shpejtë brenda familjes së madhe evropiane dhe unë asnjë pengesë sado të vogël nuk e shoh në këtë aspekt. Në këtë drejtim, edhe imamët, edhe ne si Bashkësi Islame duhet dhënë kontribut, se këtë e kemi obligim ta bëjmë.

I nderuar myftiu, a mendoni që vonesa e rregullimit të infrastrukturës ligjore brenda shtetit të Kosovës rreth bashkësive fetare ka qenë hendikep për zhvillimin me ritëm normal të Bashkësisë Islame të Kosovës (miratimi i Ligjit për Liritë Fetare që së fundi u miratua nga Qeveria e Rep. të Kosovës dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut në parlament

në maj të vitit 2023)? A i përmbushë ky ligj, tashmë i publikuar, standardet e avancuara të vendeve të zhvilluara dhe aspiratat e komunitetit mysliman në Kosovë?

Jo vetëm për Bashkësinë Islame të Kosovës, por për të gjitha bashkësitë fetare të Kosovës, ka qenë, është dhe do të mbetet një hendikep i madh mungesa e ligjit dhe qartësimi të pozitës juridike të bashkësive fetare në Kosovë. Ne kemi pengesa ndonjëherë të pakapërcyeshme gjatë punës sonë të përditshme që kemi si bashkësi, andaj shumë herë kemi folur në lidhje me këtë problematikë. Besoj që Qeveria e Kosovës ka vullnet për ta bërë këtë, ka pasur edhe në të kaluarën, ka edhe tash. Ne kemi një bashkëpunim, çka është shumë e vërtetë, por kemi edhe pengesa, të cilat duhen shikuar edhe një herë, ngase vërejtjet të cilat shkojnë nga një komunitet, në këtë rast në veçanti në komuniteti më i madh shumicë në Kosovë, nga Bashkësia Islame, besoj që komisioni i Qeverisë duhet t'i marrë në konsideratë, t'i shqyrtojë dhe ato të futen brendapërbrenda atyre neneve të atij ligji. E sa shoh unë, në këtë drejtim, kam përshtypjen se ky ligj do t'u imponohet bashkësive fetare, në këtë rast, me të madhe Bashkësisë Islame të Kosovës. Do të imponohet diçka që për ne do të jetë e papranueshme, mirëpo e respektueshme, sepse nëse aprovohet ligji kështu siç është,

Ne jemi qytetarë, që Zoti na ka krijuar këtu në këtë vend, ky është vatani-atdheu ynë. Ky është vendi ynë dhe ne jemi pjesë e pandarë e Evropës.

nuk dua të bëjë ndonjë krahasim apo analogji, mirëpo, i përngjanë ligjit në Rusi, fjala është për dy-tri nene, të cilat do të mundësonin formimin e më shumë bashkësive si në Moskë, ku janë lejuar të formohen njëmbëdhjetë bashkësi islame. Të lejosh që sot në Kosovë, me pesëdhjetë nënshkrime të bëhet bashkësi fetare, do të thotë ta shkatërrosh shoqërinë kosovare, kjo do të thotë që ndoshta pa e menduar mirë, të ndahen edhe myslimanët në entitete të veçanta. Kosova ka një Myfti, dhe brenda kësaj ombrelle janë të gjithë myslimanët, qofshin ata turq, boshnjakë, goranë apo egjiptian, çfarëdo qofshin ata që i përkasin besimit islam. Me këtë do të krijohet mundësia e krijimit të shumë bashkësive fetare, që më pas, do të detyrohet prapë Qeveria e Kosovës që të rikthehet në këtë që po e them unë. Pse? Sepse ne duhet ta ruajmë Kosovën si sytë e ballit. Ne duhet të mos lejojmë që asnjëherë feja të jetë pengesë e proceseve. Ne nuk guxojmë që tash me këtë ligj t'ju mundësojnë të kemi bashkësi islame një etnike dhe të fraksioneve të ndryshme, si të vehabistëve, selefistëve, egjiptianëve, goranëve, boshnjakëve, turqve etj.. Ne këtu i kemi dhënë vërejtjet tona, ju kemi thënë që të merrni modele vendet e rajonit që i kemi përreth nesh, si shembull Kroacinë, dhe ta aprovoni, mirëpo siç po shihet nuk është një gatishmëri e tillë. Unë



do të mundohem me tërë fuqinë që të ndikoj që ky ligj, kështu si është, të mos aprovohet, të mos kalojë.

Kur jemi te kohezioni ndërjetar në Kosovë, si një vlerë e dëshmuar e popullit tonë me shekuj, a keni bindjen se ndonjëherë roli i Bashkësisë Islame në këtë rrafsh disi edhe është marginalizuar?

Po, madje edhe shumë është marginalizuar. Nëse ne e shikojmë paksa të kaluarën dhe punën që tash bëjmë, se sa i kushtohet kujdes kësaj nga institucionet që duhet ta kenë hatër punën që është bërë, sikur shihet se asnjëherë, po shprehem kështu, nuk ju ka dhënë haku që e meriton Bashkësia Islame. Nuk është e tepërt dhe të ripërsëritem. E kam përmendur sa herë, është e paprueshme dhe jonjerëzore të dëgjosh shumë herë, po them çdo ditë fjalë fyese në raport me besimin. Në anën tjetër, atë që e ka bërë Bashkësia Islame e Kosovës, pak kush e ka bërë në Kosovë, në veçanti nga viti 89' e këndeje. Faktet flasin. Kur arritëm që ta largojmë pluhurin e sistemit komunist në petkun e Bashkësisë Islame që për një kohë të gjatë i kishte pluhurosuar xhamitë, vendet ku ne adhurojmë Zotin tonë, atëherë, sikur neokomunistët u rizgjuan nga një pushim i tyre i përkohshëm dhe i dhanë vetes detyrë që të bëjnë edhe më shumë se prindërit e tyre, duke sulmuar çdo gjë që është islame në Kosovë. Si institucion kemi bërë shumë edhe për ta ruajtur kohezionin, mirëpo shumë pak është dalë në pah puna jonë. Në vitin 1989, unë atëherë kam qenë përgjegjës për ndihmat që vinin nga Bosnja dhe Hercegovina. 220 maune me ndihma, me ushqim e veshmbathje patën ardhur nga Bosnja, dhe kurrë këtë askush nuk e përmend. Medreseja edhe në atë kohë ishte shndërruar në magje për popullin, prej ku ushqehet populli anakënd Kosovës. Pastaj, kështu vazhduam deri në luftën e fundit dhe e dimë ne të gjithë se sa është bërë dhe çfarë ka bërë Bashkësia Islame e Kosovës, në atë kohë me në krye dr. Rexhep ef. Bojën. E dimë se çfarë ka bërë Medreseja në atë kohë kur unë vetë isha drejtor, dhe sa është kontribuuar në këtë drejtim. Mbi 1230 tubime të karaktereve të ndryshme janë mbajtur në Medrese, pastaj 37 imamë kanë ra shehidë. Serbia ka pasur qëllim edhe spastrimin etnik edhe fetar këtu. Kur

Kosova është unike, do të jetë shumë e fortë, ne duhet të punojmë për ruajtjen dhe respektimin e besimeve në vend, duke respektuar besimin e njëritjetrit dhe duke e ditur se ne jemi shqiptar dhe se kemi një gjak, një flamur, një vatan dhe ju përkasim kryesisht tri besimeve, islam, krishterë, pra katolik e ortodoks.

ndalemi dhe e analizojmë, p.sh. nëse e marrim vetëm Prishtinën, vetëm institucioni i Bashkësisë Islame është djegur, është djegur arkiva gjashtëqind e sa vjeçare. Janë djegë shtëpitë e krerëve të BIK-ut, shtëpia e Rexhep Bojes e shumë të tjerëve.

Kosova është unike, do të jetë shumë e fortë, ne duhet të punojmë për ruajtjen dhe respektimin e besimeve në vend, duke respektuar besimin e njëritjetrit dhe duke e ditur se ne jemi shqiptar dhe se kemi një gjak, një flamur, një vatan dhe ju përkasim kryesisht tri besimeve, islam, krishterë, pra katolik e ortodoks. Ne do të punojmë që bashkërisht ta ruajmë këtë unitet, duke ruajtur kështu këtë thesar që e kemi trashëguar me shekuj nga të parët tanë. Këtë begati nuk guxojmë në asnjë moment, me asnjë çmim ta lëkundim, sepse nëse lëkundim këtë kemi bërë mëkat, ngase Zoti na ka mësuar në Kuran që ne duhet t'i respektojmë besimet e njëritjetrit, siç ka thënë Ai: **"Ju keni fenë tuaj, ata kanë fenë e tyre."**

I nderuari Myfti, ditëve të fundit janë shfaqur grupe të kompleksuara me identitetin e tyre fetar. A ju shqetëson diskursi i tyre që për burim duket se ka inferioritetin identitar? A e keni përshtypjen se ata mund ta lajthisin ndonjë shtresë shoqërore, përderisa thërrasin publikisht për braktisje të Islamit?

Për mua është vërtet e çuditshme dhe nuk po mundem ta konceptoj atë që po dëgjoj nganjëherë në televizionet tona apo që po lexoj në portalet tona, kësaj nuk mund t'i them asgjë më tepër vetëm se çmenduri e kohës dhe ligësi e madhe në raport me besimin islam që e kanë përqaftuar shumica dërmuese e këtij populli. Çështja e përcaktimit të besimit është kryer me shekuj në Kosovë, dhe unë kam bindjen e thellë se kështu do të vazhdojë. Le të na sulmojnë, kurse ne do të punojmë, ne do ta ruajmë njëritjetrit, do ta respektojmë besimin e tjetrit, do ta ruajmë tolerancën, do ta ruajmë vëllazërinë mes vete, por qe besa edhe këtyre duhet t'u themi "mjaf!" ngase nuk është as edukative, e as njerëzore që dikush ta fyejë besimin e dikujt.

Unë mendoj se këto thirrjet e fundit janë prodhim i këtyre fyerjeve të vazhdueshme,

në veçanti tash e 20 vjet, që, përmes ekranit, shtypit, librave, gazetave që kanë qenë apo edhe portaleve, i bëhen ndjenjës islame në Kosovë. Në këtë drejtim është punuar dhe është investuar shumë nga qarqe të ndryshme. Në këtë drejtim po them që ka argat të ndryshëm, dhe kjo argati e tyre dihet se shkon direkt në dëm të të qenit shqiptar, në dëm të kombit, atdheut e vatanit tonë. Unë edhe këta i kam parë, me disa bile gjatë luftës kemi punuar shumë dhe ata i pashë se pas tubimeve të tyre, ata ishin nëpër xhamia për ta falë xhumanë, por ata thirren në shqiptari. Sigurisht se brenda një shoqërie mund të ketë individë që kanë keqkuptuar dhe kanë keqinterpretuar, mirëpo, ky flamur nuk duhet të merret dhe më pas të krijohet urrejtje ndaj një besimi, në këtë rast të besimit islam, e më pas të mbahen e të krijohen forume me lëvizje çfarë po themi se trumbetojnë në shqiptarizëm.

Unë dua të them publikisht se i përkas një familje *endeshiste* (Lëvizja Nacionale Demokratike Shqiptare) dhe jam i edukuar në këtë frymë. Mua më kujtohet sikur sot, babai im (rahmet pastë!), i cili ka vdekur në moshën 51-vjeçare, në vitin 1968, kur ka ardhur në shtëpi i gjakosur, ka ardhur me flamur nën sjetull. Vazhdimisht e kemi pasur të varur flamurin në odën tonë, e ylli i vogël asnjëherë nuk është dukur, gjithnjë ka qenë i mbuluar. Unë e di që nga klasa e parë që asnjëherë nuk kam shkuar në shkollë me fotografinë e Titos në libër, ngase babai im e ka shqyer menjëherë atë, në praninë time. Kështu jam edukuar unë. Flamuri është një armatosje e brendshme shpirtërore që të shtyn ta japësh edhe jetën për atdheun, për flamurin, për të gjitha. Unë jam i vetëdijshëm se këto që po i them, edhe mund të keqinterpretohen dhe keqkomentohen, mirëpo kështu është, dhe vazhdimisht do të mbetet kështu.

E kemi qartësuar edhe në 89' përcaktimin tonë çfarë kemi pasur, e keni të incizuar më 10.06.1989 dhe do të bindeni se çfarë ka qenë vizioni i Bashkësisë Islame atëherë edhe tash.

E kam thënë dhe po e përsërisë, të jesh besimtar i mirë i besimit islam, do të thotë të jesh atdhetar i mirë. Ai i cili është kundër atdheut, kundër flamurit, ai nuk është mysliman i mirë, ngase është kundër asaj që porositi Zoti. Veprimet e tyre sanksionohen edhe me ligj, mirëpo askujt nuk i bie ndërmend që të bëjë një gjë të tillë nga institucionet e vendit. Të fyesh ndjenjat e besimit, çfarëdo besimi qoftë, ajo penalizohet me ligjet në Kosovë dhe këta duhet të penalizohen. Çdonjëri është i lirë në besim, por nuk është i lirë ta fyjë besimin e tjetrit. Askush nuk është i lirë të dalë e ta shaj Islamin dhe të thërras për largim prej Islamit.

Krejt në fund, çfarë i ofron Islami një shoqërie bashkëkohore kosovare, nëse kuptohet dhe praktikohet mirëfilli pa lajthitje e devijime tendencioze? A mund ai të ofrojë zgjidhje për brengat dhe fenomenet shqetësues që ndonjëherë na duken se për to nuk ka kurrfarë zgjidhjeje?

Islami fe e Zotit, si i tillë është shërues, që shëron sëmundje që janë brenda shpirtit, mendjes e logjikës së njeriut. Nëse

njeriu ka kapacitete ta marrë atë ilaç, atë bari shërues, ashtu siç duhet, pa kapërcyer kufijtë, ai do t'i ofrojë individit një model jetese për të mirë. Islami është shprehje hyjnore, nuk është prodhim i mendjes. Nuk është produkt i angazhimit të individit apo shoqërisë, por është shprehje hyjnore e të Madhit Zot, i dërguar te Pejgamberi a.s., në këtë rast, Kurani te Muhamedi a.s., përmes melekut Xhibril. Kur themi shprehje hyjnore, do të thotë, janë njohuri që i ka zbritur i Madhi Zot, dituria e të Cilit është absolute, e pakufizuar. Me këtë rast shohim se ato mësim plotësojnë në vazhdimësi nevojat që ka individ, familja dhe shoqëria.

Mua njëherë më është bërë një pyetje: “A lejon Islami reforma?” I kam thënë: “Jo, Islami urdhëron reforma”. Reforma në mënyrën e thirrjes në Islam e të tjera, mirëpo nëse e quajmë reformë ndryshimin e asaj që e ka urdhëruar Zoti dhe asaj që e ka ndaluar, atëherë ajo nuk mund të jetë reformë e as fe, ngase një fe që ndryshon sipas stinëve apo sipas politikave ditore, ajo nuk është fe.

Ta marrim një shembull konkret: Zoti xh.sh. na ka thënë që është haram vrasja. A të reformohemi e të themi që është hallall? Jo, jo! Ajo është e prerë deri në Kiamet. Përdorimi i alkoolit është haram, këtu nuk ka reformim, ngase është urdhër i Zotit. Zoti ka urdhëruar namazin, a të bëjmë reforma që të mos falemi?! Jo! Në çdo pore tjetër të jetës së kësaj bote, në çdo fushë tjetër të Islamit, duhen praktikuar reformat nëse ato shpijnë kah e mira, apo ka një përparim për individin, familjen apo shoqërinë mbarë. E tentativat e disave që ta ngushtojnë, që ta ngufatin Islamin, duke ngrit zëra të pakuptueshëm e duke ngrit teza të pakuptueshme, janë kundër dhe që edhe unë i urrej.

Ne themi që Islami është sikur një dritë, për të gjithë njerëzit që dëshirojnë të marrin dhe të pajisen me këtë dritë, të pajisen me këto mësim, të cilat kishin me ua ndriçuar rrugën dhe kishin me i udhëzuar kah e mbara dhe e mira. Po flasim për një Islam të mirëfilltë, ngase e keni dëgjuar duke thënë “Islami politik”, “Islami ekstrem”, jo, jo, nuk ka Islam politik e as Islam ekstrem, ka myslimanë që merren me politikë. Nuk ka as Islam ekstrem e as Islam radikal nuk ka. Mund të ketë myslimanë radikalë e ekstremë, ashtu qysh ka edhe te fetë e tjera. Të dalësh e të bësh keq në emër të fesë, të dalësh e të vrasësh në emër të fesë, kjo është kundër logjikës, kundër Kuranit, kundër mësimave të Zotit, e kundër mësimave të Muhamedit a.s.. Prandaj, ne si shoqëri islame, si shoqëri shqiptare me shumicë, duhet të bëjmë edhe më shumë në ruajtjen e unitetit, duhet në vazhdimësi të ndihmojmë proceset nëpër të cilat po kalon Kosova, për të arritur aty ku dëshirojmë të gjithë.

Lusim Zotin xh.sh. që të na bëjë prej atyre që i përjetojnë ato dëshira që i kemi bashkërisht dhe që Kosova të jetë një shtet shembull, jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë! Ju faleminderit!

Intervistoi kryeredaktori i revistës: Mr. Driton Arifi

Komentimi i sures El Fet'h (11)

PËRSHKRIMI I TË DËRGUARIT A.S. DHE I SAHABËVE TË NDRERSHËM

Sabri Bajgora

مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ وَالَّذِينَ مَعَهُ أَشِدَّاءُ عَلَى الْكُفَّارِ
رُحَمَاءُ بَيْنَهُمْ تَرَاهُمْ رُكَّعًا سُجَّدًا يَبْتَغُونَ فَضْلًا مِنَ
اللَّهِ وَرِضْوَانًا سِيمَاهُمْ فِي وُجُوهِهِمْ مِنْ أَثَرِ السُّجُودِ
ذَلِكَ مَثَلُهُمْ فِي التَّوْرَةِ وَمَثَلُهُمْ فِي الْإِنْجِيلِ كَزَرْعٍ
أَخْرَجَ شَطْأَهُ فَآزَرَهُ فَاسْتَغْلِظَ فَاسْتَوَىٰ عَلَىٰ سَوَاقِهِ
يُعْجِبُ الزَّرْعَ لِيُغَيِّظَ بِهِمُ الْكُفَّارَ وَعَدَّ اللَّهُ الَّذِينَ
آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ مِنْهُمْ مَغْفِرَةً وَأَجْرًا عَظِيمًا

29. Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të (sahabët), janë të ashpër me jobesimtarët dhe të mëshirshëm me njerëjtjetrin. I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar mirësi prej Allahut dhe kënaqësinë e Tij. Në fytyrat e tyre shihen gjurmët e sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Tevrat, ndërsa në Ungjill, ata përshkruhen si një farë e mbjellë që nxjerr filiz. Kur ai forcohet e trashet dhe qëndron fortë në kërcellin e vet, e mahnit mbjellësin, dhe nëpërmjet tyre (sahabëve), ua shton mllëfin jobesimtarëve. Kurse atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Allahu u ka premtuar falje dhe shpërbllim të madh.

LIDHJA E KËTIJ AJETI ME ATA PARAPRAKË

Në ajetet paraprake, i Madhërishmi e bëri të qartë se ëndrra e mirë e Pejgamberit a.s., se do të hynte në Mekë së bashku me sahabët e tij, do të realizohej, në momentin kur Ai me Dijen e Tij absolute e sheh të arsyeshme, dhe njëkohësisht e përgëzon Pejgamberin a.s., dhe mbarë myslimanët, se feja islame do të rritet e do të triumfojë mbi çdo fe tjetër. Kurse tash në ajetin e fundit të kësaj sureje, që në fillim të

tij, Allahu e vërteton pejgamberin e Muhamedit a.s., se është i Dërguar i Tij, dhe i lavdëron sahabët e Resulullahut s.a.v.s., me cilësitë më të mira, me të cilat janë përshkruar në Tevrat dhe në Inxhil.

KOMENT:

“Muhamedi është i Dërguar i Allahut...”

Ajeti i fundit i sures El Fet'h, është një prej ajeteve më madhështor të Kuranit famëlartë. Në të, fillimisht vërtetohet edhe njëherë se Muhamedi a.s. është i Dërguar i Allahut, e që ndërlidhet fuqishëm edhe me fundin e ajetit paraprak: “Mjafton Allahu si dëshmitar!”, që d.t.th., të mjafton ty o Muhamed, që Allahu është dëshmitar se ti vërtet je i Dërguar i Tij, edhe nëse krejt njerëzimi të mohojnë.¹ Ndërkohë, ky ajet është edhe një kundërpërgjigje e fortë ndaj hezitimeve të Suhejl ibn Amrit, të autorizuarit nga kurejshët, që të mos e shkruante në marrëveshje fjalinë: “Muhamedi, i dërguari i Allahut”. Nëpërmjet kësaj fraze hyjnore: “Muhamedi është i Dërguar i Allahut...”, i Madhërishmi dëshiron ta qetësojë e kënaqë shpirtërisht Muhamedin a.s., që mos të ndikohej nga qëndrim mohues i kurejshëve karshi tij, sepse të refuzuan ata apo jo, ti vërtet je i Dërguari Im, jo vetëm për kurejshët, por për mbarë njerëzimin.

Meqë ky ajet, i përshkruan sahabët e Resulullahu s.a.v.s., në mënyrën më meritore, atëherë Allahu xh.sh. e filloi këtë ajet pikërisht me përshkrimin e të Dërguarit të Vet, me këtë frazë kaq të shkurtër, por me kuptime shumëdimensionale, pas së cilës nuk ka peshë asnjë përshkrim tjetër, sepse është përshkrimi më gjithëpërfshirës dhe më i bukuri i mundshëm.

Ajeti i fundit i sures El Fet'h, është një prej ajeteve më madhështor të Kuranit famëlartë. Në të, fillimisht vërtetohet edhe njëherë se Muhamedi a.s. është i Dërguar i Allahut, e që ndërlidhet fuqishëm edhe me fundin e ajetit paraprak: “Mjafton Allahu si dëshmitar!”, që d.t.th., të mjafton ty o Muhamed, që Allahu është dëshmitar se ti vërtet je i Dërguar i Tij, edhe nëse krejt njerëzimi të mohojnë.

“...Ata që janë me të (sahabët), janë të ashpër me jobesimtarët dhe të mëshirshëm me njeri-tjetrin...”

Të Dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s., për ta kryer me sukses këtë mision të thirrjes në besimin e drejtë, përveç fuqizimit nga ana e Allahut xh.sh., do t'i nevojiteshin edhe shokë e përkrahës, të cilët nuk do të hezitnin për asnjë çast të hidheshin në zjarrin e luftës, me qëllim të lartësimit të fesë së Njëshmërisë. Këta ishin sahabët e ndershëm, gjenerata më fisnike që e shoqëroi të Dërguarin e Allahut gjatë misionit të tij të shenjtë. Sipas shumicës dërmuese të dijetarëve, ky ajet i përfshin të gjithë sahabët, kurse është transmetuar nga Ibn Abasi, se në këtë ajet, synohen vetëm ata që ishin dëshmitarë të Hudejbijes.² Sidoqoftë, mendimi i parë është më i pranuar.

Sipas unanimitetit të dijetarëve të Ehli Sunetit, të gjithë sahabët konsiderohen njerëz të drejtë e të mirë. Ata ishin të dashurit e Allahut dhe më të zgjedhurit prej krijesave pas pejgamberëve të cilët Ai i zgjodhi nga njerëzit.³

Ashtu siç shihet në këtë ajet, përkrimi i sahabëve, është një përkrim i jashtëzakonshëm, përkrim që ishte përmendur për ta më parë edhe në Tevrat dhe në Inxhil. Sahabët e Resulullahut s.a.v.s., ishin shembulli më i lartë i devotshmërisë, i besnikërisë dhe i përkushtimit. Ata përveç përlësisë që e stoliste karakterin e tyre, megjithatë kur ballafaqoheshin me armikun, ishin të ashpër dhe sypatrembur, dhe nuk ndjenin aspak frikë se mund të vriteshin, sepse qëllimi i tyre kryesor ishte fitimi i kënaqësisë së Allahut dhe rënia shehid në fushëbetejë.

Edhe në rastin e marrëveshjes së Hudejbijes, sahabët e Resulullahut s.a.v.s., duke qenë të brumosur me një iman të fortë, dhe duke e ditur se ishin në të vërtetë, nuk kishin qenë të kënaqur me këtë marrëveshje, sepse sipas shumicës prej tyre, kjo ishte dorëzimi para kërkesave irracionale të kurejshëve, ndërkohë që ata ishin të gatshëm të vdisnin e të mos ktheheshin të thyer shpirtërisht. Natyrisht, ky hidhërim dhe pikëllim u kishte hije sahabëve të Resulullahut s.a.v.s., gjë të cilën e ka cekur edhe Ibn Ashuri në tefsirin e tij. Madje mund të themi se Ibn Ashuri është ndër të paktët prej mufesirëve që e ka pikasur këtë element nga sjelljet e sahabëve të ndershëm. Ata ishin këmbëngulës në insistimin e tyre që pavarësisht pasojave, të hynin në Mekë për ta kryer umren. Megjithatë, në këtë rast, ata nuk kishin qasje në fshehtësitë dhe urtësitë e Allahut, për të cilat dinte vetëm i Dërguari i Allahut. Ata këtë e bënin vetëm për hir të dashurisë ndaj Allahut dhe ndaj Pejgamberit a.s., sepse imani i tyre i fortë, i shtynte drejt kësaj. Ata i ndjenin drithërimat e këtij nuri

imanor në zemrat e tyre, prandaj ishin gati të vdisnin e të mos ktheheshin prapa.⁴

Këtë mëshirë të sahabëve në mes vete, dhe ashpërsinë që kishin ndaj armikut, e ka përshkruar Allahu xh.sh. edhe në disa ajete kuranore, si f.v.: “O besimtarë! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dijeni se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan; të përlurur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit; që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi...” - (El Maide, 54), ndërkohë që në shumë hadithe të Resulullahut s.a.v.s.,

është përshkruar raporti i shëndoshë i besimtarëve islamë në mes vete, si: “Shembulli i besimtarëve në dashurinë, mëshirën dhe solidaritetin reciprok është sikurse shembulli i trupit; nëse ankohet një gjymtyrë, i tërë trupi lëngon nga temperatura dhe pagjumësia.”⁵

“... I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar mirësi prej Allahut dhe kënaqësinë e Tij. Në fytyrat e tyre shihen gjurmët e sexhdes. Ky është përkrimi i tyre në Tevrat...”

Sahabët fisnikë të Resulullahut s.a.v.s., që shfaqnin ashpërsi e fortësi ndaj armikut, ishin shumë të mëshirshëm në mes vete. Ata ishin njerëzit më modestë dhe më të përlurur para Madhërisë së Allahut në rukutë dhe sexhdet e namazit. Ata e përjetonin thellë në shpirtat dhe në zemrat e tyre, këtë dashuri ndaj të Madhit Zot. Meditonin thellë për çdo ajet që e lexonin gjatë namazeve të tyre ditore, po edhe më shumë gjatë namazit vullnetar të natës.

Sahabët e ndershëm, ashtu siç i përshkruan ky ajet, nuk e bënin këtë adhurim, për të kërkuar shpërblim tek Allahu, përkundrazi, ata duke qenë të vetëdijshëm se si qenie njerëzore kanë mangësi, lëshime e gabime të natyrave të ndryshme, i kërkonin mirësitë e Allahut dhe kënaqësinë e Tij. Vetëm pas kësaj, shpresonin në Xhenetin si shpërblim.⁶

Në fytyrat e sahabëve, përkrim që sipas dijetarëve vlen edhe për çdo besimtar të devotshëm e të sinqertë, deri në Ditën e Gjykimit, shiheshin qartë gjurmët e këtyre sexhdeve. Këto gjurmë nuk nënkuptojnë gjurmë fizike në ballë, siç pretendojnë disa shkurtpamës, por nënkupton se në fytyrat e atyre që bien në sexhde para Krijuesit, shihen drita, shkëlqimi dhe madhështia, të cilat shenja e shpërfaqin mirësinë dhe përlësinë e një robi të devotshëm. Qëllimi me fjalën: “gjurmët e sexhdes” është për gjurmët e adhurimit, por i Madhërisë dhe përzgjedhje fjalën “sexhde”, sepse ky veprim yni bë namaz, gjatë vënies së ballit në sexhde, nënkupton përlësinë, përvujtninë, devotshmërinë dhe adhurimin e Allahut në formën më të plotë. Shumë prej dijetarëve të mëdhenj nëpër shekuj, duke u bazuar edhe në disa thënie profetike, kanë thënë se namazi i natës i zbukuron fytyrat e

besimtarëve gjatë ditës. Disa të tjerë kanë thënë se mirësia reflekton dritë në zemër, shkëlqim-vezullim në fytyrë, shtim të rrizkut dhe dashuri në zemrat e njerëzve. Në lidhje me këtë, Omeri r.a., ka thënë: “Ai që ndërgjegjen e brendshme e ka të pastër e të mirë, Allahu do t’ia shpërfaq mirësinë edhe në veprimet e jashtme”⁷.

Ky është përshkrimi i sahabëve të Resulullahut s.a.v.s. në Tevrat, të cilin e devijuan dhe shtrembëruan çifutet, por megjithatë, në disa kopje të vjetra, siç janë disa kopje të viteve 1800 dhe fillimit të viteve 1900, të Dhiatës së Vjetër, mund të haset përshkrimi i tyre edhe në Tevrat. Në kopjen biblike të Richard Wats të vitit 1822, e gjejmë këtë citat biblik: “Zoti erdhi nga Sinai dhe prej Seirit rrezatoi mbi ta; dhe u paraqit në madhësinë e tij nga mali Paran, dhe me të ishin mija të pastër, e nga e dhathta e tij, dilte për ta një ligj i zjarrtë”⁸.

Duke e krahasuar këtë kopje të Biblës, me kopjet e sotme të saj, shohim se nga to është hequr krejtësisht fjala “mija të pastër”, për t’u zëvendësuar me fjalën: “mija shenjtore”.

Ndërsa ky pasus, në Dhiatën e sotme të vjetër, në versionin elektronik, gjendet në këtë formë: “Zoti erdhi prej Sinait, prej Seirit rrezatoi mbi ta, vezulloi prej malit Paran, bashkë me mijëra të shenjtë. Zjarr flakërues, lëshonte dora e tij e dhathtë.”⁹ Pa dyshim, fjala Paran, apo në arabishte Faran, sipas të gjithë studiuesve të teksteve biblike, nënkupton malin e Mekës, ku zbriti shpallja e fundit hyjnore, ndërsa me fjalën “mija të pastër” apo “mijëra të shenjtë”, aludohet në sahabët e Pejgamberit a.s., gjatë çlirimit të Mekës.

“...ndërsa në Ungjill, ata përshkruhen si një farë e mbjellë që nxjerr filiz. Kur ai forcohet e trashet dhe qëndron fortë në kërcellin e vet, e mahnit mbjellësin, dhe nëpërmjet tyre (sahabëve), ua shton mllefin jobesimtarëve.”

Tash kemi një përshkrimin besnik dhe autentik e sahabëve të ndershëm të Resulullahut s.a.v.s., që si citat ka qenë më parë edhe në Inxhil, duke aluduar për filltet e para të Islamit, kur numri i tyre ishte fare i vogël, dhe ngjanin me një farë të brishtë, e cila mbillet dhe ngadalë nxjerr filizat e saj. E pastaj, ky filiz merr hovin e rritës së tij, dhe kur forcohet, bujku që e ka mbjellë, mahnitet me bukurinë dhe fortësinë e tij. Ky shëmbëllim përputhet plotësisht me gjendjen e sahabëve, të cilët pasi që ishin të paktë në numër, numri i tyre erdhi duke u shtuar dita-ditës, dhe kur ndodhi shpërngulja e bekuar në Medinë, ata tash kishin filluan të forcoheshin dhe të tregonin forcën dhe përkushtimin e tyre, mu ashtu siç i përshkruan ajeti në fjalë: “kur ai forcohet e trashet dhe qëndron fortë në kërcellin e vet, e mahnit mbjellësin”.

Fatkeqësisht, në Ungjijtë e sotëm, të cilët kanë shpërputhje të mëdha edhe në mes vete, pothuajse janë larguar fare apo janë shtrembëruar të gjitha ato citate, që mund të aludonin në përngjasime të tilla për të Dërguarin a.s. dhe sahabët e tij, sepse mëria dhe urrejtja e jobesimtarëve nga radhët e Ehli Kitabit, ishte dhe vazhdon të jetë paskajshmërisht agresive, armiqësore dhe jotolerante. Mirëpo, dijetarët myslimanë, duke studiuar Ungjijtë që sot janë të kanonizuar nga të

krishterët, kanë gjetur në Ungjillin sipas Metës apo Mateut një shëmbëllim shumë të përafërt me përshkrimin kuranor të sahabëve: “Mbretëria e qiellit është e ngjashme me kokrrën e sinapit, të cilën njeriu e mori dhe e mbolli në arën e vet. Ajo është, pa dyshim, më e vogla ndër të gjitha farërat, por, kur rritet, bëhet më e madhe se të gjitha barishtet, zhvillohet në pemë, sa që shpendët e qiellit vijnë e bëjnë çerdhe në degë të tij.”¹⁰

Ndërsa në vetë Kuranin famëlartë, ashtu siç e ka përshkruar mufesiri bashkëkohor, Muhamed esh Shenkiti, gjejmë me dhjetëra ajete që e përshkruajnë këtë shëmbëllim të sahabëve kur në filltet e para të Shpalljes, ata ishin të dobët dhe të paktë në numër si p.sh.: “*Dhe kujtohuni kur ishit pak në numër, ishit të dobët në tokë e kishit frikë se njerëzit (jobesimtarët) do t’ju gllabëronin!...*” - (El Enfal, 26); “*Allahu ju ndihmoi në Bedër, kur qetë të pafuqishëm, andaj frikësojuni Allahut, për të qenë falënderues.*” - (Ali Imran, 123), etj.¹¹

Kurse pjesa e fundit e pasusit të ajetit në fjalë: “*dhe nëpërmjet tyre (sahabëve), ua shton mllefin jobesimtarëve.*”, shpërfaq madhësinë e sahabëve, sepse ashpërsia e tyre në luftë kundër idhujtarëve, dhe mëshira që e kishin në mes vete, bëri që jobesimtarët të ndjenin mllef e urrejtje ndaj tyre. Sahabët e Pejgamberit a.s., me të cilët kjo fe e ndritshme islame u lartësua dhe mori hov duke u përhapur në të katër anët e botës, ishin gjenerata më fisnike që jetoi deri më sot. Ata ishin njerëzit më të privilegjuar e më të zgjedhur të këtij ymeti, meqenëse patën rastin ta shoqëronin njeriun më të madh të njerëzimit – Muhamedin a.s., të cilin Allahu xh.sh. e dërgoi udhëzues dhe mëshirë për botët. I Lartmadhërishtmi, i ka lavdëruar sahabët e Resulullahut s.a.v.s. në shumë vende në Kuran siç është ky ajet i fundit (29) i sures El Fet’h, pastaj: “*Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për të mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni Allahun.*” - (Ali Imran, 110).

Kurse i Dërguari i Allahut për shokët e vet ka thënë: “Mos i shani sahabët e mi, mos i shani sahabët e mi, se për Atë në Dorën e të Cilit është jeta ime, nëse ndonjëri prej jush do të jepte (shpenzonte) sasi të arit sa kodra e Uhudit, nuk do të arrinte mirësinë e ndonjërit prej tyre, madje as sa gjysmën e tyre.”¹²; si dhe: “Njerëzit më të mirë janë gjenerata ime (sahabët), pastaj ata që vijnë pas tyre (tabi’injtë) dhe pastaj ata që vijnë pas tyre (tebei tabi’injtë)...”¹³ E në një version tjetër: “Gjenerata më e mirë është gjenerata ime (sahabët), pastaj ata që vijnë pas tyre (tabi’injtë) dhe pastaj ata që vijnë pas tyre (tebei tabi’injtë)...”¹⁴

Sipas disa dijetarëve, shembulli i sahabëve që është përmendur në Tevrat, është i lidhur ngushtë me ibadetin e shumtë të tyre dhe me përkushtimin e përlësinë që kishin në raport me Krijuesin Fuqiplotë, tradita të cilat çifutët i kishin hedhur pas shpine që moti, sepse ata njihen si popull që i ka preokupuar për së tepërmi luksi dhe jeta e kësaj bote si dhe grumbullimi i pasurisë, dhe nuk çajnë kokën për afrim të Zoti xh.sh., me adhurim. Ndërsa shembulli i sahabëve, i

përmendur në Inxhil, është krahasimi në mes tyre dhe të krishterëve në çështjen e adhurimit dhe të përpjekjeve për këtë botë. Dihet se të krishterët vetë e shpikën murgjërinë, me qëllim të lënies pas dore dynjanë dhe preokupimin me adhurim ndaj Zotit, gjë të cilën Allahu nuk ua kishte urdhëruar, andaj i Madhërishmi ua tërheq vërejtjen se murgjërinë e tyre nuk ditën ta ruanin e as ta praktikonin në formën e duhur, duke e humbur edhe këtë botë, edhe botën tjetër, ndërkohë që sahabët ishin të devotshëm në adhurim, por ishin gjithashtu edhe në ballë të xhihadit dhe ndërtimit të shoqërisë njerëzore në parime të shëndosha, dhe nuk u mbyllën nëpër xhamia për ibadet, por krahas ibadetit, shkruan faqet më të ndritshme të historisë islame, me përhapjen e fesë islame, ngado që shkuan.¹⁵

Pjesa përmbyllëse e ajetit të fundit të kësaj sureje, përfundon me një premtim të madh përgëzues nga ana e Allahut të Gjithëmëshirshëm për besimtarët: *“...Kurse atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Allahu u ka premtuar falje dhe shpërblim të madh”*.

Pas këtij nderimi dhe lartësimi të sahabëve nga ana e të Madhërishmit, të cilët preokupim kryesor kishin fitimin e kënaqësisë së Allahut ndaj tyre, tash në fund vjen përgëzimi hyjnor se ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të kenë falje dhe shpërblime të mëdha. Ky përgëzim, i premtuar nga Allahu Fuqiplotë do të thotë se Ai kurrë nuk i thyen premtimet e Tij, prandaj, ata që besojnë bindshëm dhe drejt në Njëshmërinë e Tij, që besojnë në ekzistencën e engjëjve, në Librat e shenjtë, në të Dërguarit e Allahut, në Kadanë dhe Kaderin e Allahut, dhe në Ringjallen pas vdekjes, këtyre, i Madhërishmi iu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh në jetën e Ahiretit. Me këtë përgëzim, mbyllet perdja e kësaj sureje fisnike, duke përçuar një mesazh të fuqishëm për çdo kohë dhe për çdo brez të besimtarëve deri në Ditën e Gjykimit, se vetëm besimi i drejt në Krijuesin, është rruga që shpie në lumturinë e përhershme si në këtë dynja, ashtu edhe në Ahiret.

POROSIA E AJETIT (29)

- Vërtetimi i pejgamberisë së Muhamedit a.s. nga ana e Krijuesit Fuqiplotë me dëshminë më madhështore që i përfshin të gjitha kuptimet: *“Muhamedi, i dërguari i Allahut”*, e cila njëkohësisht vjen si kundërpërgjigje ndaj kurejshëve, të cilët nuk e pranonin Muhamedin a.s. si pejgamber.

- Në zemrat e besimtarëve është rrënjësuar thellë dashuria për Pejgamberin a.s., sepse ky është zotëria i krejt njerëzimit dhe zotëria i krejt pejgamberëve nëpër kohë. Është vula e profetëve dhe është i pari që do të ndërmjetësojë në Ditën e Gjykimit me lejen e Allahut. Prandaj, mjafton dëshmia e Allahut, se ai, Muhamedi a.s. është i dërguar i Allahut.

“...Kurse atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Allahu u ka premtuar falje dhe shpërblim të madh”.

- Përshkrimi i sahabëve të ndershëm si të mëshirshëm në mes vete e të ashpër ndaj armiqve dhe jobesimtarëve, është një përshkrim besnik i shpirtave të tyre, sepse Allahu i Madhërishëm e përzgjodhi këtë gjeneratë që të ishte bartëse e fanarit dhe dritës së Islamit, në të katër anët e botës.

- Përshkrimi i sahabëve në Tevrat dhe Inxhil, me cilësitë më të lavdëruara, është edhe një argument shtesë për vlerën e tyre, e njëkohësisht, ky ajet shpërfaq djallëzitë e çifutëve dhe të të krishterëve, të cilët kanë ndërhyrë në tjetërsimin e librave të tyre të shenjtë, duke hequr citate e duke shtuar citate, sipas tekeve dhe interesave të tyre.

- Sahabët e ndershëm të Resulullahut s.a.v.s., shumë lehtë dalloheshin nga të tjerët, sepse fytyra e tyre ndriçonte nga nuri i imanit që u vlonte në zemra. E këto shenja dalluese ishin namazi i natës, devotshmëria dhe lutjet e pafund drejtuar Zotit Fuqiplotë që t’ju jepte mirësi në këtë botë, dhe ta meritonin kënaqësinë e Tij me Xhenetin si shpërblim.

- Në fund, kemi premtimin hyjnor për besimtarët të cilët punojnë vepra të mira, se mbi ta do të jetë falja, mëshira dhe shpërblimi i Allahut xh.sh..

Ajeti i fundit i kësaj sureje, është i veçantë, sepse sipas shumë studiuesve të mrekullisë kuranore është i vetmi ajet kuranor, në të cilin janë përmbledhur të gjitha shkronjat e alfabetit arab.¹⁶ - Fund -

- 1 Et-Tenasuku-l mevduiju fi sureti-l Fet’h, f. 427.
- 2 Ibn Atijje el Endelusi, El-Muharreru-l vexhiz fi tefsir-l Kitab-l Aziz, Bejrut, 2007, vëll. VII, f. 689. (botim i Ministrisë së Vakëfit të Katarit).
- 3 Et-Tefsir el mevdui li suveri-l Kuran, vëll. VII, f. 330.
- 4 Et-Tahriru ve-t-tenviru, vëll. 26, f. 204.
- 5 Buhari (6011); Muslimi (2586). (hadithi është i kategorisë ‘sahih’).
- 6 Dr. Adil bin Ali esh Shiddi, Nedharatun fil ajeti “Muha.medun Resulullahi” – dirasetun tahlilijeh, mukareneh, Rijad, 2010, f. 19.
- 7 Tefsiri i Ibn Kethirit, Kajro, 2000, vëll. 13, f. 134. (redaktuar nga grup dijetarësh në krye me Mustafa es Sejjid Muhamed).
- 8 Nedharatun fil ajeti “Muhamedun Resulullahi” – dirasetun tahlilijeh, mukareneh, f. 21.
- 9 Ligji i përtërirë 33:2 (AL).
- 10 Ungjilli sipas Mateut (13: 31-32); <http://ëëë.bibla.net/?cid=1,939>.
- 11 Muhamed esh-Shenkiti, Advau-l bejani fi idahi-l Kurani bi-l Kurani, Mekë-Xhedë, 1426 h., vëll. VII, f. 646.
- 12 Buhari (3673); Muslimi (2541); Ebu Davudi (4658).
- 13 Buhari, (2652); Muslimi (2533). (hadith ‘sahih’).
- 14 Ibn Rexheb, Xhamia’l ulumi ve-l hikem, (2/477). (hadith ‘sahih’)
- 15 Nedharatun fil ajeti “Muhamedun Resulullahi” - dirasetun tahlilijeh, mukareneh, f. 26.
- 16 <https://www.albayan.ac/across-the-uae/2009-08-23-1.462407>; <https://al-maktaba.org/book/31617/50290>

Paraqitja e madhe

Eduard Thartori

Pastaj diçka tjetër e madhe ndodh. Sot në fakt është dita kur ndodhin gjërat e mëdha. Një ofshëtimë e madhe dëgjohej dhe qielli nis të hapet...

Hapet qielli i parë dhe krejt engjëjt zbresin aty dallgë-dallgë të rreshtuar. Pastaj hapet edhe qielli i dytë dhe prej atje zbresin engjëjt dallgë-dallgë. Po kështu edhe nga qielli i tretë dhe i katërti, i pesti, i gjashti dhe i shtati. Engjëjt rreshtohen në rreshta gjigande, pritët një shfaqje e madhe.

Krejt njerëzimi që gjendet aty, së bashku me xhindet, kur shohin këtë fenomen, nisin të bien në sexhde. Njerëz dhe xhinde, besimtarë dhe jobesimtarë, të mirë dhe të këqij. Të gjithë bien në sexhde. Mirëpo kush nuk e njohu çfarë është sexhdeja në këtë botë, në atë moment, nuk do të mundet të përkulet në sexhde. I mjeri, do të dojë që dhe ai të bëjë sexhde. Por trupi nuk do t'i përgjigjet. Shtylla kurrizore është bllokuar në një të vetme. Atëherë ai i mjerë hidhet përmbys, veç ta bëjë atë sexhde.

XHEHENEMI PO SILLET ATY PRANË

Shtatëdhjetë mijë vegjë mbajnë një enë të madhe gjigande, që e ka emrin Xhehenem. Në çdo vegjë, janë shtatëdhjetë mijë engjëj, që e ngrenë atë peshë.¹

"Ditën kur Xhehenemi do të ndizet..." (Et Tekvir, 12).

Ky krater gjigand që është afruar në Mahsher, është aq i thellë, sa për të rënë në flakët e tij, nga maja ku është vendosur ura e Siratit, duhen shtatëdhjetë vjet rënie e lirë. Ai turfullon, zjarri aty është i errët. Nxehësia e tmerrshme e djeg edhe dritën. Asgjë aty nuk i ngjan zjarrit që e njohim. Pejgamberi a.s. ka thënë se vetëm një pikë zjarri i Xhehenemit të hidhet mbi këtë botë, do ta mbushte krejt atmosferën tonë me erë të qelbur dhe do ta bënte jetën të pamundur këtu.² Tashmë Xhehenemi është gati të pranojë banorët e tij. Por akoma nuk janë bërë gati banorët e tij për të hyrë aty. E kujt ia mban ta

Shtatëdhjetë mijë
vegjë mbajnë një
enë të madhe
gjigande, që e ka
emrin
Xhehenem. Në
çdo vegjë, janë
shtatëdhjetë mijë
engjëj, që e
ngrenë atë peshë.

shohë atë vend? Mirëpo vetëm zhurma e tmerrshme e tij, ka futur panik të madh në Mahsher. Vaj e lot. Lutje me aman o Zot, mos më hidh në Xhehenem. Ah sa shumë njerëzit do luten në ato momente.

PESHORET

Pas një kohe të gjatë pritje, më në fund vjen koha e madhe. Vendosen peshoret...

Ndërkohë që peshoret vendosen, diçka tjetër po ndodh aty në fushën e madhe të Mahsherit. Disa njerëz po zgjidhen mes të tjerëve. Engjëjt janë futur në turmat e njerëzve dhe po tërheqin zvarrë ata që kanë qenë më barbarët. Ata më kriminelët, që vranë dhe shfarosën njerëz të pafajshëm. Diktatorët, spiunët, servilët, shtypësit e popujve të vet. Tradhtarët, ata që për një fjalë që ia thanë armikut, shkaktuan gjenocid mbi popujt e pafajshëm. Të gjithë ata, tani po merren.

Ata nuk do të gjykohen fare. Nuk do ta kenë atë nder. Nderin që të paktën të dëgjohej çfarë kanë për të thënë. Jo, ata thjesht do merren zvarrë, do të grumbullohen të gjithë në një vend dhe aty engjëjt e tjerë do t'i bëjnë ata një lëmsh të madh mishrash njerëzore dhe frymërash xhindesh. Të gjitha bashkë këto specie barbare, do të hidhen në zjarr të Xhehenemit, menjëherë. Nuk ka asgjë që e ndalon.

Përsëri ndodh një fenomen i ngjashëm... Kësaj radhe engjëjt të tjerë të veshur bukur dhe shkëlqyeshëm, po ulen me kujdes. Ata zgjasin duart e tyre dhe ngrenë disa njerëz të tjerë. Kësaj radhe ata vijnë me respekt dhe me dashuri. Shtatëdhjetë mijë veta, dhe pas çdo njërit prej tyre edhe shtatëdhjetë mijë të tjerë, po ngrihen lart. Ata nuk do të merren në llogari fare. Janë amnistuar. Allahu, ata i ka nderuar dhe nuk do që të mundohen këtë ditë.

"Ata të cilët më parë u ka prirë mirësia, do të jenë të evituar nga ai (Xhehenemi). Nuk do ta dëgjojnë zhurmën e tmerrshme

të tij. Ata do të jenë në vendin ku do të kenë përjetësisht gjithçka që do të duan. Nuk do të frikësohen prej atij tmerrri të madh. Ndërsa i presin engjëjt, duke u thënë: “Kjo është dita juaj që u është premtuar.” (El Enbija, 101-103).

E pra sot është koha që ata ta gjejnë premtimin e Zotit, për të gjitha vuajtjet e tyre. Për qëndresën e tyre në të drejtë. Ata janë pejgamberët a.s., janë dëshmorët dhe njerëzit e singertë. Janë ata që në këtë botë u quajtën budallenj. Janë ata që në këtë botë përbuzeshin dhe i quanin njerëz të trashë, që nuk dinë të gënjejnë dhe ta dredhin si shumica. Ata sot u morën dhe po nderohen. Bashkë me ta edhe familjarët e tyre.

PASTAJ FILLON GJYKIMI

Asnjë gojë nuk do të flasë. Asnjë njeri, xhind, apo engjëll, nuk ka leje të flasë. Vendin e kaplon një heshtje e madhe. Të gjithë janë në tmerr. Allahu, Mbreti i Ditës së Gjykimit, ka vendosur. Askush nuk pipëtin. As engjëjt, as xhindet dhe as njerëzit, madje as kafshët. Sigurisht edhe kafshët janë ringjallur. Edhe ato janë aty në ditën e gjykimit. Por ndryshe nga njerëzit dhe xhindet, ato pas gjykimit, do të shpërbëhen duke u bërë thjesht dhe.

Fillon gjykimi. Peshorja ka dy anë. Njëra është për veprat e mira dhe tjetra për veprat e këqija. Të gjitha do futen aty.

Do të jetë e çuditshme ajo peshore. Aty në krahun e majtë, të punëve të këqija, do të hyjnë edhe disa vepra të mira. Ne na dukeshin se filani e kishte bërë diçka të mirë atë vepër. Por ku ta dinim ne se ai nuk e ka pasur me sinqeritet? Madje edhe engjëlli që e ka shkruar, e ka shkruar si punë të mirë.

Por Allahu nuk e vlerëson të tillë. Sepse nuk e ka dhënë atë sadaka për hatrin e Allahut, por që të thuhej se ky është bujar i madh. Edhe shumë dituri që dijetari ka shpërndarë, po këtë fat do të kenë. Nuk futen në anën e djathtë të peshores, sepse nuk e ka pasur për hatrin e Allahut. Por për të fituar postin e kryetarit. Madje aty do të hyjë edhe gjaku i dëshmorit. Po mor po! Edhe disa dëshmorë do dalin huq atë ditë, sepse nuk luftuan për hatrin e Allahut. Por luftuan për partinë, për idealet komuniste apo fashiste. Mbrojtja e atdheut nuk është justifikim, sepse këtu nuk ka më atdhe dhe asnjë vepër që nuk ka qenë për hatrin e Zotit, nuk mund të futet në anën e djathtë të peshores.³

Do të ketë prej tyre që peshorja e anës së djathtë do të peshojë shumë. Por kur të vendoset ajo fjala me të cilën tradhtoi besimin e Allahut, të gjitha të mirat e tij bëhen pluhur.

Do të vijnë edhe shumë humanistë. Ndoshta do të kenë shumë vepra humanitare që kanë bërë. Por të gjitha shkojnë bosh. Sepse nuk janë bërë për Allahun, Zotin dhe Mbretin e kësaj dite. Nuk janë bërë për këtë gjykatë sot. Ato janë bërë për zota të tjerë, që sot janë zhdukur. Zota që sot janë vetë aty duke u gjykuar.

Sot njerëzit do të kërkojnë për ndonjë të mirë të tyre, ku të kenë mundësi të mbledhin sa më shumë, sepse peshorja duhet të mbushet. Nëse jo, Xhehenemi është aty, duke turfulluar. Nuk ka shpëtim. E vetmja rrugë është mbushja e peshores me vepra të mira. Disa do të jenë me fat. Sepse në këtë botë, janë përgojuar shumë, andaj do të merren nga ata që i përgojuan dhe do t'u jepet këtyre që u përgojuan.

Disa të tjerë do të marrin ca të mira, nga malli që i është vjedhur në këtë jetë. Dikujt iu rrëmbye pa të drejtë toka, dikujt pensioni, dikujt pasuria. Sot hajdutët do të dorëzojnë çfarë kanë vjedhur. Eh sa me fat që janë. Ku ka ditë më të mirë, për të marrë mbrapsht hakun e vet? Sot më shumë se kurrë, u duheshin ato.

Dikush do të jetë i dështuar komplet. Ka bërë shumë të mira, por ka bërë edhe shumë të këqija. Ka ofenduar, ka përgojuar, ka vjedhur, ka dhunuar. Të gjitha viktimat e tij tashmë po marrin prej tij, edhe ato pak të mira që ka bërë. Kur të mos ketë më për të dhënë, viktimat e tij, do të shkarkojnë tek ai gjynahet e tyre. Kështu ai do mbytet në gjynahe, edhe pse ka bërë shumë të mira.⁴

Disa të tjerë nuk po e mbushin dot peshoren e vet, andaj shkojnë te nëna apo babai i vet. I kërkojnë atyre, por ata janë keq për vete. “Shko more andej, se kam hallet e mia”, i përgjigjen. Po kështu edhe gruaja që ndanë të njëjtin shtrat bashkë. Sot nuk i bie kujt mendja. Kanë hallet e veta. Të gjithë thonë: “Kam hallet e mia...”

Në peshore gjithçka vlen. Çdo fjalë e mirë që ke thënë në jetën e dynjasë, do të ketë vlerë të madhe në këtë ditë. Ka shumë njerëz që do të shpëtojnë vetëm prej një fjalë të mirë që i thanë një ditë një njeriu të dëshpëruar. Ata nuk e dinë, por dikujt ajo fjalë i ka shpëtuar jetën. Por pikërisht një fjalë mund të të shkatërrojë të gjitha të mirat që i ke bërë. Thënë dikur, pa ndonjë rëndësi të madhe prej teje. Por ajo ka bërë dëm të madh. Një sekret familjar ke zbuluar, një akuzë thënë ashtu kot, për nderin e dikujt. Sot ajo të shkatërron të gjitha punët e mira që ke bërë.

Gjyqi funksionon në mënyrë të përkryer. Thirren dëshmitarët. Por ata nuk janë si dëshmitarët e kësaj bote. Janë më realistë. Aty dëshmi të rreme nuk ka. Vetë duart do të dëshmojnë se e kanë kryer atë veprim të keq. Vetë syri do të flasë, e do të tregojë se e ka parë. Vetë këmbët e njeriut do të dëshmojnë se kanë shkuar. Atje nuk flet më goja. Por flet trupi yt që i ka bërë ato të mira ose ato të këqija.⁵

Pastaj është koha e ndërmjetësimeve. Po, atje ka ndërmjetësues. Ai është Pejgamberi a.s., i cili vazhdimisht i lutet Allahut për ymetin e vet që po merren në llogari. Atje janë edhe engjëjt që po luten për besimtarët, që Allahu t'i mëshirojë. Atje janë edhe Kurani, agjërimi, sadakaja, gjaku i dëshmorit, pluhuri i tokës së betejës. Të gjitha do të dëshmojnë dhe do të ndërmjetësojnë që Allahu ta falë robin besimtar.

Aty dëshmojnë edhe hekurat e birucës, edhe kamxhiku i xhelatit, që ka torturuar besimtarin. Kërkojnë falje për të.

Allahu ka premtuar për besimtarët se do t'i mëshirojë. Nga 100 pjesë që e ka ndarë mëshirën e Tij, 99 prej tyre i ka rezervuar për këtë ditë.⁶

Po, është e vërtetë. Askush nuk mund të shpëtojë në këtë gjykim, me drejtësinë e Allahut. Nëse do të shpëtojmë, kjo do të ndodhë vetëm prej mëshirës së Allahut.

E megjithatë ka dhe prej tyre që nuk janë të bindur në këto fjalë. Njëri prej tyre kërkon të shpëtojë me drejtësinë e Allahut. Pasi mendon se ai ka bërë shumë punë të mira dhe mund t'ia hedhë vetë këtij gjykimi.

Jo, thotë Allahu, vetëm me mëshirën Time do të shpëtosh. Por ky akoma nuk është i bindur. Atëherë Allahu jep urdhër t'i paraqiten të gjitha veprat e mira që ka bërë. Vërtet që janë shumë. Pastaj nga ana tjetër e peshores, Allahu urdhëron të sjellin vetëm një nga shumë mirësitë që i ka dhënë robit të Vet. Mirësinë e shikimit. A do të mjaftojnë krejt ato vepra të mira, për të falënderuar Zotin, vetëm për këtë mirësi të shikimit që i ka dhuruar?

Kur vendosen në peshore, shikimi peshon më shumë. E veprat e mira fluturojnë krejt. Atëherë rob bindet se nuk mund të kalojë pa mëshirën e Allahut. Pastaj thërret me të madhe: "Veç me mëshirën Tënde o Allah." E vetëm kështu mund të shpëtojë.

Interesant është fakti se gjykimi do të bëhet për të gjithë, në të njëjtën kohë, nga Krijuesi i tyre, Allahu. Dikush nuk e koncepton dot, sesi Zoti do të jetë duke gjykuar miliarda njerëz në të njëjtën kohë. Për Zotin kjo është e lehtë. A nuk kemi parë sesi Allahu në të njëjtën kohë i ushqen dhe i mban gjallë miliarda njerëz?

Miliarda njerëz dhe xhinde tashmë kanë mbaruar punë me gjykimin. Secili tashmë e di rrugën e vet. Disa për në Xhenet dhe disa për në Xhehenem. Por akoma ka shpresë.

Kur gjithçka ka mbaruar në gjykim, njëri doli nga peshoret i falimentuar. Ai e di se nuk ka shpëtim për të. Sepse në të gjitha ato vepra që kishte vetëm një të mirë i kishte rezultuar. Por çfarë mund të bëjë ajo e mirë, para shumë të këqijave që i janë palosur në anën e majtë? Kështu i mjeri njeri, shpresëfikur, sheh ndonjë fatkeq tjetër që t'ia dhurojë atë të mirë që ka. Të paktën dikush të shpëtojë. Dhe e gjen vërtet dikë. Ai ishte barazi, të mirat dhe të këqijat ishin njësoj. Ishte i hutuar dhe nuk dinte nga të shkonte. Shpresonte për Xhenet dhe për falje prej Zotit. Por gjynahet që kish bërë e mbanin peng. Derisa vjen ky fatkeqi i parë. "Merre këtë sevap", i thotë. "Shpëto ti të paktën, se mua nuk më duhet më. Por ti mund të shpëtosh me këtë." Tjetrit i çelet fytyra nga lumturia dhe

Pastaj është koha e ndërmjetësimeve. Po, atje ka ndërmjetësues. Ai është Pejgamberi a.s., i cili vazhdimisht i lutet Allahut për ymetin e vet që po merren në llogari. Atje janë edhe engjëjt që po luten për besimtarët, që Allahu t'i mëshirojë.

shpresa iu kthye se mund të shpëtojë. Ato momente diçka e madhe ndodh.

Allahu i Madhëruar i flet robit të Tij që i dhuroi sevapin tjetrit: "O rob im, kjo që bëre është bujari e mirë prej teje. Por ti nuk je kurrsesi më bujar se Unë. Andaj ti dhe ai tjetri të dy jeni të falur prej Meje dhe të dy do të shkoni në Xhenet."

Do të ketë aty edhe mënyra të tjera shpëtimi nga Xhehenemi.

"Kush shpëton prej Xhehenemit, do të futet në Xhenet. Ai është shpëtimi i vërtetë." (Ali Imran, 185).

Të gjithë e dinë tashmë këtë fakt. Disa shehidë, që Allahu i ka graduar me nder të madh në gradën e dëshmorit. Sot është dita juaj, i thotë Allahu. Zgjidhni shtatëdhjetë familjarë dhe njerëz që doni nga ata që kanë mbetur në llogari. Ky është nderim i madh për ta. Sot ata kanë leje të marrin për dore prindërit e vet, gratë dhe fëmijët e vet, dajat e xhaxhallarët, e krejt ata njerëz që i kanë dashur në këtë botë. Kushti i vetëm është që të kenë qenë besimtarë dhe të kenë vdekur si besimtarë. Pasi për jobesimtarët nuk ka

asnjë ndërmjetësim.⁷

Pastaj Allahu i jep leje fëmijëve të vegjël që kanë vdekur në vegjëli. Sot ata janë të rritur, dhe vrapojnë te prindërit e tyre në llogari. I marrin ata për dore dhe i tërheqin edhe ata në Xhenet.

Disa të tjerë do t'i marrin në Xhenet sadakatë e tyre. Kanë ushqyer të varfër, kanë mjekuar të sëmurë. Kanë shpëtuar jetë.

Tashmë njerëzimi ka mbaruar përfundimisht punë në peshore. Një grup bëhet gati për Xhenet. Një grup nuk është aspak gati për t'u hedhur në Xhehenem. Por po pret radhën kur ta marrin. Ka dhe një grup tjetër që dolën barazim. As në Xhenet, as në Xhehenem. Është një vend aty pranë që quhet Arafë. Është vendi asnjans ku ata do të qëndrojnë deri kur të merret vendimi përfundimtar për ta.

Përpara është ura e Siratit

Për të gjithë, rruga kalon mbi urën e Siratit...

1 Transmeton Muslimi.

2 Gjendet te Tirmidhiu me numër 2585. Transmetuar nga Abdullah ibën Abasi. Hadithi është hasen sahih (i saktë), sipas standardeve të Buhariut dhe Muslimit.

3 Bazuar nga një hadith të Pejgamberit a.s., përmbledhur nga Tirmidhiu në gradën sahih, me nr, 2382.

4 Bazuar nga një hadith të Pejgamberit a.s., përmbledhur nga Muslimi në gradën sahih.

5 Frymëzuar nga Kurani, sure Fussilet, 21.

6 Bazuar në hadithin që e transmeton Buhariu, me numër 6000.

7 Bazuar në hadithin e Pejgamberit a.s. për shpërblimin e dëshmorëve. Transmetuar nga Ahmedi, Tirmidhiu dhe Ibën Maxhe.



Besimi në Zot, faktor qetësues i brezit të hutuar

Hfz. Mehas Alija

Në kohët e sotme, brezi i ri po përjeton një gamë të gjerë sfidash dhe dilemash që shpesh mund ta bëjnë atë të ndjehet i hutuar dhe të përballët me ankth. Bota dhe njerëzimi, në kohë dhe momente të caktuara të jetës, pas sfidave të caktuara, ndryshon dhe nuk kthehet më si më parë. Çdo ngjarje e madhe në botë, qoftë luftë, krizë financiare, pandemi apo diç tjetër, shkakton ndryshime globale dhe, ndonjëherë, lë pasojë dramatike të shoqëria njerëzore dhe të brezat që vijnë më pas. Përveç kësaj, “njeriu modern”, i ndikuar nga ideologji dhe sisteme laike, është i ndikuar nga iluzioni se nuk ka nevojë për vlera dhe përmbushje shpirtërore dhe se Zoti nuk i nevojitet më atij. Kjo është një pikë e dobët e njeriut dhe ai harron se besimi në Zot është një faktor që i shërben shumë qetësimi të tij shpirtëror, mendor dhe emocional.

Brezi i ri, ky brez që në rrugët e jetës duket i hutuar, i ngutshëm, i pashpresë, i dezorientuar, ka nënvleftësuar dy gjëra shumë të rëndësishme.

E para, se jeta është me sprovë, me ngritje dhe rënie. Jeta na sjell çdo ditë sprovë të reja me të cilat duhet të mësohemi dhe prej tyre të nxjerrim mësimin e duhur. Një i urtë më parë është shprehur: “Habitem me atë njeri që kërkon në këtë botë atë që nuk është e kësaj bote, e që është rehatia.”¹ Pra, jeta në këtë botë është e kufizuar me sprovë dhe janë testet e kësaj

bote ato që i dallojnë të mirët dhe të suksesshmit nga të këqijtë dhe dështakët. Nuk kanë për t’u hutuar vetëm ata që dinë t’i menaxhojnë dhe të mbështeten te Zoti në rastin e vështirësive, sprovave dhe fatkeqësive në jetë. Po ashtu, sot, mirëqenia dhe bollëku janë sprovë e madhe për njerëzimin dhe nuk janë vetëm fatkeqësitë dhe sprovat ato që na hutojnë.

E dyta, njeriu duhet të di se ai është rob, e do apo nuk e do këtë epitet. Ai është rob i Allahut xh.sh.. Jeta e tij është në dorën e Tij. Mjafton një sekondë e vetme që ai të humbë aftësitë e tij për të lëvizur dhe për të folur.² Mjafton një trombozë me përmasa sa maja e një gjilpërë në ndonjërin prej arterieve të trurit dhe ai e humbë aftësinë për të lëvizur.³ Mjafton vetëm një krizë ekonomike që t’i çojë në falimentim qindra e mijëra kompani dhe korporata të mëdha, etj.. Kur ta kuptojmë se ne, njerëzit, jemi krijuar të dobët, me qëllim që ta ndiejmë varësinë dhe nevojën për Zotin dhe ndihmën e Tij, aspekti ynë shpirtëror, mendor dhe emocional do të jetë më i qëndrueshëm.

Pse sot ndodhin gjithë këto çrregullime, probleme dhe vrasje të padrejta në mesin tonë si shqiptarë dhe në botë në përgjithësi? Pse njerëzimi duket kaq i hutuar sot? Sepse, harruam se si të përballemi me sprovat dhe ia kthjem shpinën Zotit, si Kujdestari suprem yni dhe i gjithësisë që është.

Mungesa e një qëllimi të lartë në jetë dhe rënia e fuqisë shpirtërore të njeriu shkaktoi hutimin dhe humbjen e ekuilibrit të tij. Sipas Kuranit fisnik, kur njeriu është i lidhur fortë me Zotin, ai posedon një ndërgjegje të edukuar, një shpirt të lumtur dhe rehati shpirtërore e psikike.⁴

Një ditë Muhamedi a.s. ishte duke udhëtuar me Abdullah ibën Abasin r.a., në atë kohë një djalë i ri, dhe ia tha këto porosi: “O djalosh, po t’i mësoj disa fjalë: “Ruaje Allahun, që Ai të të ruajë ty! Ruaje Allahun, që ta kesh pranë! Kur të lypësh, lyp Allahut, e kur të kërkosh ndihmë, kërko nga Allahu! Gjithashtu, dije se, po qe se të gjithë njerëzit do të mbledheshin për të të bërë mirë, nuk do të mund të të bëjnë mirë, pos asaj që ta ka caktuar Allahu, dhe anasjellas, nëse bashkohen për të të bërë dëm, nuk do të mund të të dëmtojnë, përveç asaj që ta ka caktuar Allahu. Tashmë lapsat janë ngritur dhe fletët janë tharë.”⁵



Siç mund të kuptojmë nga kjo këshillë e Pejgamberit a.s. dhe nga udhëzime të tjera, mund të themi se e vetmja rrugëdalje e shpëtimit tonë është kthimi kah Zoti. Edukimi dhe lartësimi ynë shpirtëror do të na çlironte nga prangat materialiste dhe do të na ngrinte mbi nivelin e pasioneve tona, të cilat shpeshherë çojnë në kokëçarje dhe dëme private e shoqërore. Besimi në Allahun xh.sh. është ndriçim në rrugët e errëta të jetës dhe në çaste të hutimit dhe të dëshpërimit, besimtari nuk harron strehën hyjnore dhe e di se ka një Zot, tek i Cili mund të mbështetet dhe të kërkojë ndihmë dhe kështu ai është i qetë dhe i tejkalon më lehtë tmerret dhe fatkeqësitë që e godasin. Në Kuranin fisnik, Allahu xh.sh. thotë: *“Allahu është mbikëqyrës i atyre që besuan, i nxjerr ata prej errësirave në dritë.”* (El Bekare, 257).

Një problem tjetër që e hasim sot te brezi i ri është edhe mungesa e shpresës, e cila ka ndikim të madh në gjendjen emocionale dhe shpirtërore të ta. Si rezultat i këtij problemi, sot kemi probleme në raportet familjare, shoqërore, në shkollë dhe brenda komunitetit. Shikuar nga perspektiva islame, shpresa është një degë nga degët e adhurimit, me fjalë të tjera është një ibadet islam. Madje sipas disave, ibadeti i shpresës, mund të jetë nga më të vlefshmit dhe më të dashurit tek Allahu xh.sh.. Nuk është për t'u habitur që në Kuranin fisnik dhe në jetën e Pejgamberit a.s. hasim shembuj të shumtë që tregojnë për vlerën dhe rolin pozitiv të shpresës në jetën e njeriut. Mjafton të marrim si shembull rastin e Jusufit a.s. me babanë e tij, Jakubin a.s.. Kurani famëlartë na njofton se si pejgamberi Jakub, i cili, duke i dërguar djemtë e tij në Egjipt për të marrë vëllain e tyre, Benjaminin, që ishte robëruar nga sundimtari, u tha atyre: *“O bijtë e mi, shkoni dhe hulumtoni për Jusufin dhe vëllain e tij, e mos e humbni shpresën nga mëshira e Allahut, pse vetëm populli jobesimtar e humb shpresën në Allahun.”* (Jusuf, 87).

Ishte Jakubi a.s., ai i cili për vite të tëra e ushqeu shpresën dhe besonte se një ditë do ta shihte sërish djalin e tij, Jusufin a.s., dhe, siç rrëfen Kurani, Allahu i Madhërishëm, më në fund i bashkoi. Ky është një mesazh i bukur për të mos e humbur shpresën në Allahun xh.sh. kur jemi në situata të vështira, ngase Allahu është i Plotfuqishëm dhe është në gjendje të na tregojë rrugëdaljen, madje, edhe nga nuk e presim.

Imam Ahmedi, në “Musnedin” e tij, ka shënuar një ngjarje ku thuhet se disa njerëz u ankuan te Pejgamberi a.s. për sjelljet e një djaloshi, i cili, edhe përkundër namazit të tij të rregullt, vazhdonte në mëkat, duke i vjedhur njerëzit. Shokët e Pejgamberit a.s. ishin të shqetësuar ndaj sjelljeve të dikujt

“Njeriu modern”,
i ndikuar nga
ideologji dhe
sisteme laike,
është i ndikuar
nga iluzioni se
nuk ka nevojë
për vlera dhe
përmbushje
shpirtërore dhe
se Zoti nuk i
nevojitet më atij.

që i bie në sexhde Zotit, ndërkohë që bënë edhe dëme të tjera. Përgjigjja e Pejgamberit a.s. ishte shpresëdhënëse: “Namazi i tij përfundimisht do ta pengojë atë nga kryerja e atij mëkati.”⁶ Mesazhi i kësaj ngjarje është se ne të gjithë jemi njerëz dhe kemi të metat tona. Ne mëkatojmë natën e ditën, në fshehtësi dhe në publik, aq sa disa prej nesh e kanë humbur edhe shpresën se Allahu i Madhëruar do të na falë ndonjëherë! Ashtu si ky i ri, edhe ne shpresojmë që një ditë, me mëshirën e Allahut dhe me përpjekjet tona, të kthehemi me pendim të sinqertë në rrugën e shpëtimit dhe të lumturisë. Ky mesazh rrit shpresën te njeriu dhe te një brez i tërë se Allahu është më i Madh se mëkatet tona dhe vështirësitë tona.

Në përmbyllje të kësaj teme, në lidhje me rolin e besimit në Zoti si një faktor qetësimi dhe shpëtimi për njerëzit në kohën tonë, themi se edukimi shpirtëror, menaxhimi i sfidave dhe ruajtja e optimizmit, janë

komponentët kryesorë për ndërtimin e fuqishëm dhe të kompletuar të personalitetit dhe karakterit të individit. Me forcimin e kapaciteteve tona shpirtërore arrijmë te këto rezultate:

- 1) mënjanimin e lakmisë, urrejtjes dhe smirës nga zemrat tona;
- 2) largimin e stresit, depresionit dhe problemeve të tjera psikike;
- 3) bëhemi më optimistë, më të disponueshëm dhe angazhohemi më shumë në kryerjen e veprave të mira; si dhe
- 4) shtojmë dashurinë, respektin dhe mirëkuptimin ndërmjet njerëzve, etj.⁷

Vetëm njeriu që beson drejt dhe fuqishëm në Allahun xh.sh. mund të posedojë një qasje të drejtë ndaj vetvetes, të jetë i vetëdijshëm për potencialet dhe rolin që ka në tokë, të ketë një sjellje korrekte ndaj botës së dukshme e të padukshme dhe ndaj ngjarjeve e zhvillimeve që e rrethojnë. Besimtari është i vetëdijshëm për kufizimet e tij dhe për lirinë absolute të Zotit, për dobësinë e tij dhe për fuqinë e Zotit. Për këtë arsye, vazhdimisht mbështetet në Allahun dhe nuk lejon që të shkatërrohet nga mërzia, dezorientimi dhe hutimi.

1 Ammar Basic, Miljenikom inspirisani, Sarajevo, 2022, fq. 141.

2 Muhamed Ratib Nabulsi, Elementët tregues të përgjegjshmërisë, Furkan, Shkup, 2019, fq. 141.

3 Po aty, fq. 142.

4 Afif Abul Fetah Tabbareh, Shpirti i fesë islame, Dituria Islame, Prishtinë, 2020, fq. 238.

5 Tirmidhiu, Sunen, nr. 2516.

6 Imam Ahmedi në Musned, nr. 19431.

7 Zuhdija Hasanovic, 40 hadisa o znazi duhovnosti, El Kalem, Sarajevo, 2022, fq. 59.

Dëshpërimi i njeriut modern dhe nevoja e tij për besimin

Muhamed B. Sytari

Shoqëria jonë, sot përballlet me tendencat e asimilimit, tjetërsimit, ndryshimit të identitetit, ndryshimit të kulturës dhe çrrënjësjes së vlerave (islame), me të cilat të parët tanë jetuan në paqe, harmoni dhe begati, me natyrën, me njeriun (cilindo njeri), me veten (duke dëshmuar pagën e brendshme me Zotin) dhe gjithçka përreth.

Ndaluni pak tek ajeti i 97-të i sures En Nahl, ku Krijuesi i galaktikave dhe i gjithësisë, i drejtohet racës njerëzore: *“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.”*

Betohet Vetë Zoti ynë se besimi dhe vepra e mirë, sipas përkufizimit hyjnor, janë garanci e një jete të bukur, larg dëshpërimit, kaosit, ngarkesave dhe devijimit.

Teksa punoja për monografinë kushtuar jetës dhe veprës së hoxhës sonë të madh shqiptar, dijetarit dhe eruditit të pashembullt, H. Vehbi S. Gavoçit (rahmet pastë!), ndër të tjera e pyeta se cilat janë disa prej pengesave të thirrjes islame në këtë kohë dhe si mund të kapërcehen? Hoxha mu përgjigj: “Vesveset e të mallkuarit që të zbukurojnë rrugën e shtrembër, duke e ushqyer atë me gra e pije, me pasuri të dyshimtë e dëfrime pa kufij. Të largojnë nga mendja pyetje të tilla, si: Kush jam unë? Kush më ka krijuar dhe përse? Çfarë duhet të veprojmë në këtë jetë të gjatë, ku për çdo ditë duhet të lodhem për veten e familje? Ku do të shkoj nesër, kur të vdes e ta lë këtë jetë? Nëpërmjet kërkesave të ulëta e nëpërmjet epsheve të lira, ta mbyll syrin për të parë të vërtetën, të shurdhon për të dëgjuar zërin e arsyes dhe logjikës, të ndalon të përdorësh mendjen si duhet, etj.. Të gënjën me pije, të lakmon femrën e të bën të mendosh se nuk ka ringjallje pas kësaj jete, kështu që duhet shfrytëzuar çdo moment për të ushqyer epshtet!”

H. Muhamedi a.s., na mëson se: “Cilido popull, në mesin e të cilit veprohen veprat e

ndaluara, të cilat kanë mundësi t'i ndryshojnë dhe nuk i ndryshojnë, do t'i përfshijë Allahu me ndëshkim!”¹

Realitetet me të cilat përballlet sot bota jonë në përgjithësi dhe, shoqëria jonë islame në veçanti, i përngjajnë një labirinti të errët, ku njeriu hyn dhe ngelet peng i hutimit, i humbjes së kohës, i dështimit dhe i moskonkurimit për të arritur më të mirën në jetë, duke e jetuar atë sipas udhrrëfimit hyjnor, me të cilin Zoti e ka begatuar jetën tonë.

Shoqëria jonë, sot përballlet me tendencat e asimilimit, tjetërsimit, ndryshimit të identitetit, ndryshimit të kulturës dhe çrrënjësjes së vlerave (islame), me të cilat të parët tanë jetuan në paqe, harmoni dhe begati, me natyrën, me njeriun (cilindo njeri), me veten (duke dëshmuar pagën e brendshme me Zotin) dhe gjithçka përreth.

Dekadat e fundit po bëhen përherë e më shumë me të egra me myslimanin shqiptar, atë evropian dhe në mbarë botën, duke i ofruar atij modele dhe shembuj, që nuk janë as mund të jenë bashkudhëtarë me botën e tij, me shpirtin e besimit dhe vlerat e Islamit.

Ditë pas dite, shoqëria jonë islame po përballlet me një propagandë sa të fshehur aq të dukshme, në thelbin e së cilës është frika nga Islami dhe tendenca për ta parë atë si një fenomen keqbërës e të kobshëm, që për shekuj e paska ngërthyer për fyti shqiptarin, duke ia marrë frymën atij, duke ia zbehur forcën dhe dritën e shpirtit. Por, kjo nuk është e vërtetë! Është qesharake!

Ditë pa dite, po dëgjojmë thirrje patetike dhe analiza plot patos, në të cilat flitet rreth

dëmeve që Islami (besimi) i ka sjellë popullit tonë, kombit tonë, si dhe rrezikut të madh që i kanoset kontinentit tonë nga vërshimi i tij drejt zemrës së Evropës së lashtë. Janë thjesht thirrje të vjetra në petkun e ri të kohës, por që në thelb fshehin tërheqjen e individit dhe shoqërisë drejt dëshpërimit dhe kaosit të jetës pa besim dhe norma, sikurse lexojmë dhe dëgjojmë ditë pas dite.

Meshkuj që kthehen në femra, fëmijë që nuk pyesin për prindër, shtimi i divorceve për teka banale, vartësia ndaj bimëve narkotike, krimet e shtuara, grabitjet dhe mungesa e sigurisë, martesat brenda së njëjtës gjini, shitja e organeve njerëzore, konsumimi i frikshëm i drogave të ndryshme, alkoolizimi i shoqërive, trafikimi i qenieve njerëzore, kanabisizimi i rinisë, por jo vetëm, janë alarme të përhapjes në masë të dëshpërimit, anarshisë dhe prishjes së ekuilibrit të besimit dhe mungesës së tij në jetën e njeriut të kësaj kohe.

Në vitin 1993, kur sapo kisha mbërritur në Damask, si student, doli në qarkullim një botim serioz i Shtëpisë Botuese "Darul Kalem", me titull: "Mjekë perëndimorë që japin alarmin për pirjen e alkoolit", me autor dr. Hassan Shemsi Basha.

Libri, ndër të tjera bën fjalë edhe për përhapjen e frikshme të alkoolit në Amerikë, deri në atë gradë sa konsiderohet si: "vrasësi i dytë". Autori, duke iu referuar librit të famshëm "Harrison's Principles of internal Medicine" – (McGraw-Hill, Nju Jork, 1992), na sjell në vëmendje se: "90% e njerëzve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës konsumojnë alkoolin. 40-50% e burrave atje, goditen nga probleme kalimtare për shkak të pijeve dehëse, ndërsa 10% e burrave dhe 3-5% e grave janë të prekur nga vartësia ndaj alkoolit."²

Po ashtu, ai tregon me fakte të shumta për dëmet e alkoolit në Evropë, ku lexojmë se: "Franca konsiderohet si vendi evropian me më shumë ankesa nga ky problem. Ndërsa në Britaninë e Madhe, sipas "British Journal of Addiction" 1987, 82:27, 'Humbjet e shkaktuara nga problemet e alkoolit në shëndetësi, arrijnë shumën prej 640 milionë paund në vit. Ndërsa humbjet e përgjithshme për shkak të konsumimit të pijeve dehëse arrijnë shumën e dy mijë milionë paund në një vit!'

Artikulli në fjalë kujton gjithashtu se: 'Dyqind mijë persona vdesin për çdo vit në Angli, për shkak të alkoolit'.

Në librin "Safe food", 1991, lexojmë: "Gjysmën e krimeve që ndodhin në Britaninë e Madhe, e kryejnë njerëz të dehur. Një e treta e aksidenteve rrugore ndodhin për shkak të alkoolit. Alkooli është shkaktar i 2/3 të vetëvrasjeve në Angli, i 1/5 së ngacmimeve seksuale të fëmijëve, i gjysmës së vdekjeve për shkak të zjarreve, i 3/5 të lëndimeve të rrezikshme në kokë, i 1/3 së lëndimeve brenda shtëpisë..."³

Po ashtu, në Enciklopedinë e Universitetit të Kalifornisë në ShBA, lexojmë, (botimi i vitit 1991): "Një e treta e të rinjve në Amerikë konsumon pije dehëse deri në gradën e pamundësisë së aktivitetit studimor në shkollë, ose që shpie në probleme

me ligjin amerikan. Shumica e këtyre të rinjve e kanë nisur konsumimin e pijeve dehëse para moshës 13 vjeçare."⁴

Po të vazhdojmë më tutje, në rrezikun e madh të sëmundjeve të frikshme, për shkak të marrëdhënieve intime jashtëmartesore, do të gjejmë shifra dhe të dhëna, gati-gati të pabesueshme, por të vërteta. Fjala bie: "Prania e virusit (HIV) te njeriu, përbënë një sfidë të madhe për punonjësit në sektorin e shëndetësisë dhe mjekësisë njerëzore në mbarë botën. Në fillim të muajit gusht 1988, janë regjistruar 100.410 raste preksh me SIDA, sipas të dhënave të OBSH-së. Këto prekje ishin evidente në 138 shtete të botës. Mementalisht, ka 5-10 milionë njerëz të prekur nga ky virus..."⁵

Duke u kthyer në tefsirin e ajetit 97 të sures En Nahl, dr. Muhamed Ratib en Nabulsi, në veprën e tij, shkruan: "Vepra e mirë është të vepruarit konform asaj që ka ardhur në Kuranin famëlartë dhe në traditën e pastër... Lumturia që fiton besimtari, kur drejtohet në rrugën e urdhëresave të Allahut, kur ndjen se Allahu është i kënaqur me të dhe se Ai do t'ia shtojë atij dashurinë, do ta mbrojë... ju betohem, kjo është jeta e mirë, me të cilën gëzohet çdo frymë, sikurse ndjenja e njeriut se Allahu i Madhëruar është i kënaqur me të, kjo është jeta e mirë dhe e bukur!"⁶

Pra, raca njerëzore ka nevojë për atë që thotë dijetari i shquar, H. Reshid el Khatib el Meusili (1303-1400 h.), në tefsirin e tij: "Këto mësimet janë rregull për racën njerëzore, prandaj kushdo që punon me to, mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, sepse besimi (imani), është burimi i veprave të mira në formën e tyre të saktë, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur..."⁷

Nga ana tjetër, karshi kësaj fushate të vjetër që thërret në prishje e dëshpërim, secilit prej nesh, i del për detyrë, që të kontrollojë veten e tij, ta marrë për dore drejt udhëzimit dhe më pas të kalojë te tjetri, me këshillë dhe urtësi, në rrugën e rregullimit të asaj që është prishur dhe që ka për tendencë të degradojë në tjetërsim.



Këtë ndërmarrje besimi dhe udhëzimi, secili ta bëjë, siç thotë Imam Gazaliu: “Transmetohet se Allahu i Madhëruar i shpalli Hz. Isait a.s.: “O Isa, këshilloje nefsin tënd, nëse ai e pranon këshillën, këshillo edhe njerëzit, përndryshe, të kesh turp prej Meje!”⁸

Përhapja e alkoolit në masë në realitetet shqiptare, trashëgimi i veseve më negative nga periudha e ateizmit, si: gënjeshtria, mashtrimi, prerja në besë, smira, përgojimi në masë, egoizmi i sëmurë, sharja me shenjtërit e fesë (për fat të keq akoma vazhdojmë të dëgjojmë aty-këtu), betimi në krijesat e Zotit, jo në Madhninë e Tij, koprracia, imoraliteti, zhveshja e femrës në emër të modave dhe etiketave të kohës, mosfalja e namazit, mosagjërimi, mosleximi i Kuranit, mosmësimi i dijeve elementare të fesë, mosthëllimi në dije e shkencë, privimi nga dhënia e zekatit, mosbërja e dhikrit në formë të përditshme (në shtëpi, xhami, punë etj.), zbrazja e shtëpive nga salavati, tehexhudi, namazi i natës e lutjet në sexhde, ndalimi i fëmijëve për të ndjekur mësimet e besimit a shfaqjes së etiketës islame dhe moralit të përkushtimit, kamata, ryshfetet etj., janë një alarm i madh për besimtarët, për krejt shoqërinë tonë. Ato janë një ftesë për të kthyer vëmendjen drejt një urdhërese të hershme islame, të zbritur në Kuran, të porositur nga Resulullahu a.s., të zbatuar nga sahabët dhe brezat pas tyre, shekull pas shekulli: “Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi i të keqes në jetë!”

Në Kuranin famëlartë, Zoti urdhëron: “(O Muhamed) Merre të lehtë, urdhëro për mirë dhe largohu prej të padijshmëve.” (El Arafë, 199). Po ashtu urdhëron: “Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, që urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit.” (Ali Imran, 104).

Në komentimin e këtij ajeti, Imam Razi, në tefsirin e tij, tërheq vëmendjen, se: “Pjesa: “Nga ju le të jetë një grup”, nuk ka për qëllim veçimin e një grupi të caktuar, për dy arsye: E para: sepse Allahu ia ka obliguar krejt ymetit urdhërimin për mirë dhe ndalimin e të keqes, në ajetin 110 të sures Ali Imran, ku thotë: “Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, urdhëroni për mirë, ndaloni nga veprat e këqija dhe besoni në Allahun”. Së dyti: Çdo i ngarkuar me obligueshmëritë e adhurimeve (mukelef), e ka për detyrë të urdhërojë për të mirë dhe të ndalojë nga e keqja, me dorën e tij, me gjuhën e tij ose me zemrën e tij, sikurse secili e ka për detyrë të largojë të keqen nga vetja. Nëse është kështu, themi se: kuptimi i këtij ajeti është: Bëhuni thirrës drejt të mirës, duke urdhëruar për të mirë dhe duke ndaluar të keqen...”⁹

Allahu i Madhëruar i ka cilësuar besimtarët si njerëz që janë pranë njëri-tjetrit, të dashur në mes vete, të lidhur me mirësitë e besimit, në mbrojtje të kësaj shoqërie të lartë besimi, sipas kuptimeve të ajetit 71 të sures Teube, ku thotë: “Besimtarët dhe besimtare janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zekatin, respektojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij. Të tillët do t’i mëshirojë Allahu.”¹⁰

Ndërsa Resulullahu a.s., thoshte: “Çdo profeti, që Allahu e ka dërguar në ymetin përkatës, para meje, i ka dhënë nga ai popull përkrahës dhe shokë, që ndiqnin traditën e tij dhe e zbatonin fjalën e tij. Pastaj, nga ata erdhën breza, që thoshin atë që nuk e vepronin dhe që vepronin atë për të cilën nuk urdhëroheshin. Kushdo që i ndalon ata me dorën e tij, është besimtar. Kushdo që i ndalon ata me gjuhën e tij, është besimtar. Kushdo që i ndalon ata me zemrën e tij, është besimtar. E pas kësaj, nuk mbetet më as sa një kokërr meli, besim.”¹¹

Dhe, sikurse kanë thënë edhe dijetarët tanë: “kur myslimanët e lanë pas dore këtë obligim dhe e neglizhuan zbatimin dhe përkujdesjen ndaj tij, u kushtoi përcmim e nënshtrim, humbje dhe devijim. U zvogëluar në sytë e të huajve dhe u sulmuan në shtëpitë e tyre. Popujt u vërsulën drejt tyre si egërsira drejt kafshatës së saj të lehtë e të njomë për dhëmbët.”¹²

Prandaj, detyra e secilit është të jetë i vëmendshëm në respektimin e fesë së Allahut, në veten e tij, në familjen e tij, në fëmijët e tij, në shoqërinë e tij, duke vlerësuar urdhëresat me zbatimin e tyre dhe duke iu nënshtruar Zotit në ndalesat e Tij, duke u larguar dhe distancuar prej tyre.

Në funksion të këtyre shënimeve, po lexoja një material me shumë vlerë nga shejh Ahmed Keftaro (1915-2004), në fund të cilit shkruan se: “Edukimi i vërtetë fetar dhe besimi i sinqertë, janë ato që ndërtojnë në zemrën e poseduesit të tyre besën dhe këshillën, sinqeritetin dhe të vërtetën, dëlirësinë dhe pastërtinë, në hak të atdheut dhe me njerëzit mbarë. Besimi i vërtetë, është ai që e largon të zotin nga pabesia dhe tradhtia, nga ligësitë dhe krimi, nga mashtrimi dhe dredhite...”¹³

Zoti na faltë e na udhëzoftë dhe mos e bëftë asnjërin prej nesh “të vdekur në mesin e të gjallëve”, për të cilin, kur u pyet sahabiu i nderuar Hudhejfe ibnul Jemani r.a., tha: “Ai që nuk e ndalon të keqen, as me dorën e tij, as me gjuhën e tij dhe as me zemrën e tij!”¹⁴

1 Transmetuar nga Ebu Davudi, nga Ebu Bekri r.a..

2 Dr. Hassan Shemsi Basha, vep. e cit., f. 9.

3 Dr. Hassan Shemsi Basha, vep. e cit., f. 12-13.

4 Po aty, f. 17.

5 M.A. Ansary – S.K. Hira – A.C. Bayley – C. Chintu – S.L. Nyaywa, AIDS, Sh.b. “Er Reshid”, botimi i parë, Damask, 1993, f. 3.

6 Dr. Muhamed Ratib en Nabulsi, Tefsirun-Nabulsi, Sh.b. “El Fursan”, botimi i parë, Aman, 2016, vëll. i 5-të, f. 173-174.

7 Shejkh Reshid el Khatib El Meusili, Tefsirul-Kur’anil-Adhim, Sh.b. “Ervika”, botimi i parë, Aman, 2014, vëll. i 4-t, f. 497.

8 Imam Ebu Hamid el Gazali, Ihjau Ulumiddin, botimi i parë, Bejrut, 2000, vëllimi i 2-të, f. 384.

9 Imam Fehrudin Razi, Et Tefsirul kebir, botimi i parë, Bejrut, 1990, vëllimi i 8-të, f. 145.

10 Kurani, Et Teube, 71.

11 Transmetuar nga Imam Muslimi, nga Abdullah ibni Mesudi r.a.

12 Dr. Mahmud Akkam, Sebilul-ma’ruf, botimi i parë, Haleb, 1996, f. 14.

13 Zahir Ebu Davud, Min hedjil Kur’an, Libraria “Darul-mehabbe”, Damask, pa vit botimi, f. 188.

14 Imam Ebu Hamid el Gazali, vep. e cit., f. 383.

Metamorfoza e karakterit njerëzor dhe nevoja për freskimin imanor

Ervin Qylafku

Njeriu bashkëkohor është pjesë e ndryshimeve të mëdha. Edhe ai, si pjesë e rëndësishme e tërësisë së krijimit hyjnor, zotëron dinamikën e ndryshimit të vazhdueshëm. Herë si aktor i ndryshimeve, e herë të tjera thjesht si vëzhgues.

Kjo në fakt lidhet edhe me natyrën e tij si qenia e fundit e krijuar nga Zoti, ku i është ngarkuar detyra e kujdesjes ndaj kësaj ekzistence. Ai është mëkëmbës i Zotit në këtë jetë dhe detyrimisht është i pajisur me aftësinë e daljes nga vetvetja, pra ta shmangë përqendrimin vetëm te benefitet personale dhe të jetë aktor i zhvillimeve shoqërore, ekonomike, politike.

Egocentrizmi e dëmton funksionin e tij dhe e kthen atë së prapthi, nga një qenie e angazhuar për komunitetin në një krijesë individuale, e përqendruar te vetja e tij. Por, realisht ky habitat nënkupton denaturalizmin e tij. Në Kuran ne vërejmë se njeriu ka natyrë ekscentrike, që do të thotë se ai ka tendencën të shpërngulet nga vetvetja dhe të drejtohet për te transcendentja, pra për nga Zoti. Por, për hir të së vërtetës, i gjithë sistemi global, që para tri shekujsh, ka tentuar që t'ia devijojë këtë nevojë. Dikur ishte Zoti qëllimi i gjithë përpjekjeve njerëzore, ndërsa sot është materia. Me gjasë njerëzit i janë kthyer edhe njëherë filozofisë materialiste para sokratike e ta brendësojnë atë si këdo të vetën.

Pra njeriu i sekularizuar nuk ka më transcendencën qëllimin e udhëtimit të tij përtej vetes, emigrimi tij është fokusuar drejt materies. Ka marrë këtë drejtim, sepse nuk

del dot nga sistemi mbi të cilin është organizuar shoqëria njerëzore. Në të kundërt, do të ndihet i vetëm, i braktisur nga çdo gjë, i dalë kundër mënyrës sesi funksionon jeta moderne.

Publiciteti ka marrë përsipër të na kujtojë me një farë obsesioni se, në rast se dyshojmë se nuk jemi pjesëmarrës në shoqërinë ku jetojmë, se jemi të përjashtuar, humbës ose pafat, dyshimi hiqet me anë të konsumit. Kur Dekarti, nxori matricën e tij, për të vërtetuar ekzistencën e njeriut, e cila thoshte “Mendoj kështu që ekzistoj”, njeriu modern dyshimin e vetvetes së tij e largoi duke thënë “Konsumoj prandaj ekzistoj.” Por në këtë mënyrë ai i ka mohuar vetes furnizimin me ushqim të një pjese të ekzistencës së tij, shpirtit.

Në brendësi të tij ndeshet nevoja shpirtërore për hyjnoren me kërkesat e jetës së materializuar në çdo qelizë. Ndihet konfuz por tashmë e ka zgjedhur drejtimin. Ai jeton në botë, siç thotë Albert Einstein, për dashurinë e njerëzve të tjerë, mbi të gjitha, të atyre nga buzëqeshja dhe mirëqenia e të cilëve varet lumturia e tij. Pra, me një fjalë ai ka humbur lirinë, të cilën Dostojevski, e përkufizonte me mundësinë e të jetuarit siç dëshiron.

Por realisht sot njeriu modern nuk jeton siç e mendon ai jetën, ekzistenca e tij varet nga një zinxhir i gjatë ku ai është një hallkë e tij e varur nga pararendësja e saj si dhe pasuesja. “Ai është rob i objekteve, mjeteve. Njeriu modern është mishëruar aq shumë me sistemin, saqë nuk mund të dallojë se

Kur Dekarti, nxori matricën e tij, për të vërtetuar ekzistencën e njeriut, e cila thoshte “Mendoj kështu që ekzistoj”, njeriu modern dyshimin e vetvetes së tij e largoi duke thënë “Konsumoj prandaj ekzistoj.” Por në këtë mënyrë ai i ka mohuar vetes furnizimin me ushqim të një pjese të ekzistencës së tij, shpirtit.

çfarë gjëje është esenciale për të dhe e domosdoshme dhe çfarë është artificiale. Kjo sepse kapitalizmi shenjtëron materien dhe njeriun e vendos në plan dytësor, pra ai nuk është sistem human.”¹

Kërkimet shkencore theksojnë se të dhënat lidhur me nivelin e lumturisë në ShBA, për shembull gjatë periudhës 2004-1975, tregojnë se rritja e nivelit të të ardhurave ka pasur një ndikim pozitiv mbi nivelin e lumturisë.² Atëherë për çfarë lumturie flitet? Ajo ka të bëjë thjesht me shtim të ardhurash, sepse “ky ndikim është më se i kompensuar nga disa faktorë negativë. I pari midis tyre është ai i marrëdhënieve. Tregues të ndryshëm flasin për rritje të shkallës së vetmisë, të mungesës së komunikimit, të mosbesimit të tjerët, të izolimit, të paqëndrueshmërisë brenda familjes, të mungesës së solidaritetit dhe të ndershmërisë apo për tërheqje nga jeta civile e sociale dhe për përkeqësim të klimës sociale.”³

Pra varfërimi i marrëdhënieve njerëzore ka shkaktuar një mungesë të theksuar të lumturisë, por e cila nuk varet nga të ardhurat e as nga prezenca fizike e njerëzve në jetën e tij, por nga zbrazëtia e së brendshmes. Që nga koha kur janë krijuar qytetet, pra rreth pesë mijë vjet më parë, ato kanë pasur tendencën për t’u zgjeruar. Por, megjithëkëtë, njeriu bashkëkohor po përjeton atë që sociologët e quajnë atomizimin e shoqërisë. Njeriu sot jeton në qendra të mëdha urbane ku qindra njerëz shkëmbehen në rrugë, takohen në ashensorë, markete të mëdha, në transportin publik, por janë të huaj për njëri-tjetrin. Me sigurinë më të madhe mund të themi se ne po përjetojmë kohën e shpërbërjes së themeleve të shoqërisë njerëzore dhe institucioneve të saj, familjes,

objektit të kultit dhe vendit të adhurimit, klasës së tij shoqërore.

Me të drejtë mund të ngrihet një pyetje, megjithëkëtë investim dhe fokusim te njeriu, me zhvillimin ekonomik, shtimin e të ardhurave, zotërimin e teknologjisë, e cila pothuajse ka arritur majat e saj, pse njeriu nuk është më shumë i lumtur se dikur? “Është më se e vërtetë se pasuria dhe përparimi e kanë bërë të ngathët mendjen e njeriut. Konceptet moderne, si racionalizmi dhe pozitivizmi, që kanë ndërtuar kulturën moderne, filozofia karteziene e Dekartit, mbizotërimi i sasisë mbi cilësinë, doktrinat dhe prirjet realiste në filozofi dhe art, e kanë ngushtuar horizontin e njeriut, e kanë bërë më të cekët mendjen e tij, intelektin e është shterpëzuar. Mendimi laik, sekular, profan modern perëndimor, e ka shkëputur gjithësinë nga parimi dhe realiteti universal me të cilin ajo është lidhur, që do të thotë, e ka larguar njeriun nga e vërteta hyjnore dhe kozmologjike, ai filloi të mendojë e më vonë të besojë se e vërteta ka të bëjë vetëm me termat lëndore fizike që plotësojnë përditshmërinë e tij.”⁴

Pra me një fjalë, faktori kryesor i mungesës së shpresës së njeriut për të bërë një jetë të lumtur në të tashmen, por dhe në të ardhmen është mungesa e Zotit në përditshmërinë e tij. Njeriu është krijuar për të qenë i varur diku. Fillimisht ai ishte rob i Krijuesit, por më vonë lindi nevoja për t’ia hequr varësinë ndaj Zotit në mënyrë që të besojë verbërisht në sistemin në të cilin ai jeton, ta konsiderojë atë zot. Përpjekjet për të skllavëruar njeriun vazhdojnë ende, megjithëse ligji për ndalimin skllavërisë e tij tashmë është efektiv në çdo vend të globit. Vendi i fundit që e hoqi ishte Mauritania në vitin 2007. Pavarësisht kësaj, metodat moderne të skllavërimit si dhe largimit të idesë së Zotit Krijues dhe mbikëqyrës të aktivitetit jetësor gjenden edhe në detajet më të parëndësishme të jetës sonë, në fuqinë mbinatyrore që i jepet materies, në përshkrimin e simptomave të anomalive në jetën tonë, në shëndetin tonë, në kurimin e gjendjes emocionale të rënduar, por edhe shqetësime të tjera nëpërmjet shkencës së psikologjisë. I gjejmë ato në art, madje thuhet që arti u krijua si rebelim ndaj Zotit, në letërsi duke filluar me Renesancën, e deri te shkencat natyrore si dhe shoqërore.

Në shekullin e nëntëmbëdhjetë, ateizmi ishte njëherë e mirë rend dite. Përparimet në shkencë dhe në teknologji po krijonin një frymë të re të autonomisë dhe të pavarësisë, që i shtyu disa të shpallnin pavarësinë e tyre nga Zoti. Ky ishte shekulli



në të cilin Ludvig Foerbah, Marks, Darvini, Niçe dhe Frojdi krijuan filozofitë dhe interpretimet shkencore të një realiteti që nuk kishte vend për Zotin. Në të vërtetë, deri në fund të shekullit, një numër i konsiderueshëm njerëzish kishin filluar të mendonin se nëse Zoti nuk kishte vdekur akoma, ishte detyrë e qenieve racionale njerëzore dhe të emancipuara ta vrisnin atë.⁵ Vrasja e Zotit, pikërisht kjo shprehje famëkeqe u prodhua nga filozofi gjerman, Frederik Niçe, i cili thoshte se Zoti ka vdekur filozofikisht dhe se njeriu i shekullit të njëzetë e ka vrarë nocionin e Zotit me anë të shkencës, racionalizmit dhe humanizmit, por në proces e sipër ai e ka humbur busullën e tij. Çdo pyetje morale dhe çdo pohim i vërtetë ka mbetur pa busull, dhe busull jemi bërë ne. Pra njeriu është në fokus, por pavarësisht kësaj ai jeton i pa shpresë, i zbrazët në mirëqenien e tij, i palumtur.

Ç'DO TË THOTË TË HUMBËSH SHPRESËN PËR TË ARDHMEN, PËR JETËN?

Në një varg kuranor, Zoti tregon se humbja e shpresës nuk është sjellje e njeriut që beson. Ai thotë: *"Shpresën në mëshirën e Allahut nuk e humb askush, përveç jobesimtarëve."*⁶

Në ajetin e sipërcituar, Zoti përmend fjalën "kafirun" e cila është shumësi i "kafir". Po ta analizojmë në terma gjuhësorë, epistemologjikisht kufër do të thotë mbulim⁷ (shiko: el kamusul muhijt), pra kafirunët, janë individë të një shoqërie, të cilët për shkak të akteve dhe shprehive të tyre, besimin në Zot e kanë të mbuluar.

Fshehja e besimit deri në nivel asimilimi të plotë bën që individëve të tillë t'u mungojë referenca që ia kthjellon atij kuptimin për jetën, si dhe mënyrën sesi funksionon ajo. Ata nuk i japin dot përgjigje pyetjeve pse ekziston gjithësia, po unë si individ pse ekzistoj dhe a ka gjë tjetër përveç këtij realiteti në të cilin unë gjendem?

Po ashtu, në ajetin e lartpërmendur, Kurani citon fjalën "reuh" e cila do të thotë "çlodhje, çlirim, gëzim" por edhe "hapësirë, gjerësi, kalim nga një gjendje në një tjetër."⁸ (shiko: el kamusul muhijt). Pra ai që nuk beson nuk gjen hapësirë, nuk e ndien gjerësinë e botës, por ajo i duket shumë e ngushtë, shqetësimet i zënë frymën, përjeton një mungesë të gëzimit

Fshehja e besimit deri në nivel asimilimi të plotë bën që individëve të tillë t'u mungojë referenca që ia kthjellon atij kuptimin për jetën, si dhe mënyrën sesi funksionon ajo. Ata nuk i japin dot përgjigje pyetjeve pse ekziston gjithësia, po unë si individ pse ekzistoj dhe a ka gjë tjetër përveç këtij realiteti në të cilin unë gjendem?

e lumturisë deri në nivel vrasar. Pikërisht për këtë, Zoti, kur përmend jobesimtarët thotë: *"...ndërsa atij që Zoti dëshiron ta lërë në humbje, (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin si të jetë duke u ngjitur në qiell. Kështu, Allahu, i ndëshkon ata që nuk besojnë."* (El En'am, 125).

Shkencërisht thuhet se sa më shumë që të ngjitesh në atmosferë, aq më tepër rrallohet ajri, e në këtë mënyrë frymëmarrja bëhet shumë e vështirë. Njeriu ndien një presion që ushtrohet mbi të, që ia shtyp kraharorin. Kështu vepron edhe mohimi i Zotit mbi njeriun jobesimtar, ia bën shumë të vështirë jetën, saqë shpesh mendon t'i japë fund asaj.

Një kohë, në Zvicër, në disa lagje të qyteteve, tarracat e ndërtesave të banimit izoloheshin me tela. Kjo bëhej me qëllim që të ndaloheshin nga vetëvrasja njerëzit me varësi ndaj lëndëve narkotike ose të dëshpëruarit nga jeta. Ndërsa qytetarët e Cyrihut thonë se atje ndodhet një urë nga e cila hidhet pothuajse çdo javë një person duke kryer vetëvrasje nga dëshpërimi, borxhet, pamundësia e pagimit të taksave, tradhtisë, etj., problematika të shoqërisë zvicerane, por jo vetëm.

SI MUND TA RINGJALLË NJERIU SHPRESËN PËR NJË JETË TË LUMTUR?

Para së gjithash duhet të kuptojmë se çfarë është lumturia. Thuhet se qëllimi i jetës në këtë botë është lumturia, pra njeriu të shijojë bekimet e krijimit të natyrës dhe të përjetojë sa më pak vuajtje, të përpiqet për kënaqësi maksimale dhe dhimbje minimale. Por, në fakt, në këtë nuk e gjejmë në Kuran. Ajo që shpreh Kurani si qëllim i krijimit është adhurimi, *"Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë."*⁹ Krahas kësaj Zoti nuk krijon asgjë kot. Përderisa Ai nuk përfiton asgjë nga adhurimi ynë, çfarë përfitojmë ne prej tij? Normalisht që është shpërblimi në jetën tjetër dhe kënaqësia e Zotit.

Në një varg tjetër të Kuranit thuhet: *"A mendoni se ju krijuam kot dhe ju nuk do të ktheheni te Ne?"*¹⁰ Në vargjet e Kuranit, pyetja e ringjalljes përsëritet shumë herë bashkë me çështjen e urtësisë së krijimit. Arsyetimi i Kuranit mbështetet mbi idenë se kjo botë ka një Zot, i cili nuk vepron asgjë kot dhe se njeriu së fundmi do kthehet tek Ai. Por, realisht, që të adhurosh Zotin, duhet ta njohësh Atë fillimisht dhe me

Shpresa është
çështje besimi,
njeriu që beson
ka shpresë,
ndihet i gjallë,
jeton. Kur në një
zemër lindin
shpresa, vullneti
dhe
vendosmëria, të
gjitha fatkeqësitë,
shqetësimet,
dhimbjet e
vuajtjet në jetë
kapërcehen.
Nëse njeriu ia del
që të besojë në
Zot dhe i
dedikohet Atij
me gjithë zemër,
atëherë aty nuk
mbetet vend për
pesimizëm apo
fat të keq.

njohjen e Tij arrin t'i japësh
përgjigje shumë pyetjeve,
mes tyre si erdhi kjo botë
në ekzistencë, nga rastësia,
u krijua vetvetiu apo nga
diçka tjetër. *"A mos vallë,
ata janë krijuar nga hiçi
apo mos janë ata krijues të
vetvetes?!"*¹¹

Nëse nuk do ishte pyetja
e njohjes së Zotit si para-
kusht i adhurimit, njeriu
do të kishte dështuar në
realizmin e qëllimit të
ekzistencës së tij dhe për
pasojë do të dështonte në
gjetjen e lumturisë. Në
Kuran, Allahu na tregon se
mes qenieve njerëzore që
kishin kuptuar qëllimin e
jetës ishte edhe Ibrahim
a.s., i cili kur lutej thoshte:
*"Lutja ime, adhurimi im,
jeta ime dhe vdekja ime
janë për Allahun, Zotin e
botëve."*¹²

Prej këtij vargu kuranor
vërejmë se qëllimi i gjithë
jetës së njeriut është besimi
dhe bindja se ka vetëm një
Krijues dhe se qëllimi i
denjë për njeriun është
vetëm Ai. Ky njeri e jeton
besimin e tij në çdo qelizë
të tij, e kjo i shkakton atij
lumturi, çdo synim tjetër

në jetë është dytësor. Sipas këtij arsytimi, njohja e Zotit dhe
adhurimi i Tij është shkak i lumturisë në jetë, e më tej
motivues për të përballuar çdo vështirësi e të papritur. Njeriu
që beson, arrin të perceptojë se shpresë do të thotë që njeriu
të zbulojë shpirtin e tij dhe të ndijojë fuqinë e madhe që
fshihet brenda atij shpirti. Falë këtij ndijimi, ai arrin të krijojë
lidhje me Fuqinë e pashtershme të përtej gjithësisë, duke
fituar kështu një forcë dhe fuqi që do të mjaftonte për t'ia
arritur çfarëdo synimi. Falë saj, thërmija më e vogël mund
të bëhet diell, bulëza më e vogël e ujit një det i tërë dhe shpirti
i tij shndërrohet në një frymim të gjithësisë.

Pra, shpresa është çështje besimi, njeriu që beson ka
shpresë, ndihet i gjallë, jeton. Kur në një zemër lindin shpresa,
vullneti dhe vendosmëria, të gjitha fatkeqësitë, shqetësimet,
dhimbjet e vuajtjet në jetë kapërcehen. Nëse njeriu ia del që



të besojë në Zot dhe i dedikohet Atij me gjithë zemër, atëherë
aty nuk mbetet vend për pesimizëm apo fat të keq. Individ
arrin të ekzistojë për aq sa ka shpresë, falë saj ringjallet e tërë
shoqëria, duke hyrë kështu në rrugëtimin e bukur të
zhvillimit. Ndërsa një individ, i cili e ka humbur shpresën
krejtësisht, jo vetëm që ekzistenca e tij nuk mund të
konsiderohet ekzistencë, por bashkë me të mund të thuhet se
paralizohet edhe një shoqëri e tërë.

1 Ali Bulac, Koncepte dhe sisteme bashkëkohore (Logos A, Shkup, 2005), 45.

2 Stefano Bartoloni, Manifest për lumturinë (Shtëpia botuese "Marin Barleti", Tiranë, 2014), 34.

3 Po aty.

4 Ali Bulac, Koncepte dhe sisteme bashkëkohore (Logos A, Shkup, 2005), 43-44.

5 Karen Armstrong, Karen Armstrong (Shtëpia botuese "Albas", Tiranë, 2020), 497.

6 Jusuf, 87.

7 El Fejruz Abadi, el Kamus el Muhit (Darul Fikr, Bejrut, 2008), 424.

8 Ibnu Mendhur, Lisanul Arab (Darul Mearif pa vend dhe vit botimi), 3/1763-1771.

9 Dharijat, 56.

10 El Muminun, 115.

11 Et Tur, 35.

12 El Enam, 162.

Shpresa e shoqëruar nga veprimi, parim avancues i besimtarit

Vahidin Beluli

“Njerëzit e suksesshëm janë heronj, ata e arrijnë edhe të paarritshmen, janë të tillë, janë të suksesshëm, sepse ata besojnë dhe punojnë.” Abdirrahim Idrizi, udhëheqës i Poliklinikës Psikologjike “Galaxy”.

Ne çdo ditë lexojmë se numri i vetëvrasjeve, gjë e cila nuk ka qenë e rëndomtë ndër shqiptarët në përgjithësi e te myslimanët në veçanti, është në rritje e sipër. Sipas statistikave, në 20 vjetët e fundit, në Kosovë kanë ndodhur më shumë se 1000 vetëvrasje.

Prandaj ne parashtrojmë pyetjen se ku është arsyeja dhe çka i shtynë këta njerëz të përfundojnë jetën e tyre tragjikisht, duke lënë plagë të pashëruara në zemrat e familjarëve, të afërmeve, shokëve e miqve. Përgjigjet mund të jenë të ndryshme dhe të bazuara nga aspekte të ndryshme. Ne nganjëherë mendojmë se, më parë, njerëzit kanë qenë më religjioz dhe më të vendosur, kurse tash si pasojë e largimit nga vlerat fetare njerëzit nuk gjejnë forcë për t’u ballafaquar me sfidat e jetës dhe vendosin të përfundojnë jetën e tyre duke zgjedhur vetëvrasjen.

Nga ana tjetër, kur shikojmë statistikën e vetëvrasjeve në Gjermani dhe në Austri, e shohim se atje numri i vetëvrasjeve ka qenë shumë më i lartë deri në vitet e tetëdhjeta, kurse tash është në rënie të dukshme, thjesht është përgjysmuar. Atëherë mund të parashtrojmë pyetjen, a thua është rritur vetëdija religjioze apo ka edhe diçka tjetër?

Kurse kur bëjmë një krahasim në statistikën botërore, të bie në sy se në vendet myslimane, vetëvrasjet janë më të vogla, për

këtë arsye gati të gjitha shtetet i gjejmë në listë kah fundi. Dhe kjo na bëri përshtypje për të shikuar arsyet e rënies së vetëvrasjeve në Gjermani dhe Austri, si dhe arsyet pse në Evropë shteti i Lituanisë është në rangun më të lartë të vetëvrasjeve. Kështu që, sipas ekspertëve, ajo që ka ndikuar në uljen e vetëvrasjeve në Gjermani dhe Austri është ndërmarrja e masave efektive parandaluese, ngritja e vetëdijes, si dhe rritja e sensibilizimit përmes informimit medial. Kurse ajo që ka ndikuar në ngritjen e kursit të lartë të vetëvrasjeve në Lituaninë është humbja e besimit nga të tjerët, përpjekja për t’i zgjidhur problemet në formë vetjake, si dhe përdorimi i lartë i alkoolit. Këto rezultate na kthejnë prapë të mendojmë tek aspekti fetar. Masat parandaluese efektive, ngritja e vetëdijes, sensibilizimi përmes thirrjes islame, ndihma e ndërsjellët në mes shoqërisë, ndalimi i alkoolit dhe dukurive të tjera negative në Islam, janë gjërat që parapërgatitin shoqërinë për të qenë të qëndrueshëm dhe për të përballuar çfarëdo stuhie të jetës së përditshme. Këto janë gjërat që e mbajnë njeriun optimist dhe njëherësh janë dhe arma më e fortë kundër pesimizmit. Pesimizmi asnjëherë nuk sjell rezultat edhe nëse pesimisti e ngushëllon vetveten me të.

SPROVIMET E PEJGAMBERËVE TË ALLAHUT TË LARTËSUAR

Nuhu a.s., i zhgënjyer me popullin e tij pas gjithë atyre përpjekjeve për t’i drejtuar në rrugën e drejtë, pati ndjenja pesimiste dhe shprehu dëshirën e tij kundër atij populli duke menduar se nga ky popull nuk do të ketë të ardhme (Nuh, 26-27). Ndërsa, kur ta shikosh nga prizmi tjetër, Nuhu a.s.,

“Njerëzit e suksesshëm janë heronj, ata e arrijnë edhe të paarritshmen, ata e arrijnë edhe të pamundshmen, janë të tillë, janë të suksesshëm, sepse ata besojnë dhe punojnë.” Abdirrahim Idrizi



llogaritet babai i dytë i njerëzimit, pasi që njerëzia u shumua pikërisht nga populli i tij. Po ashtu, një dozë pesimizmi e Junusit a.s. (El Enbija, 88), nuk gjeti përkrashje tek Allahu xh.sh. dhe ai, Junusi a.s., duhej të ballafaqohej me konsekuenca për ta kuptuar gabimin e tij kur shfaqti pesimizëm përballë popullit të tij. Kur të mendojmë nga ana tjetër, kush mund të jetë më i sprovuar se Ejubi a.s. në familje dhe pasuri? Pse nguronte ai t'i drejtohet Allahut me dua për zgjidhje? Çka e mbajti atë të qëndrueshëm edhe në kohën kur sipas parametrave logjik nuk ja vlen të jetohet? Mendoj se si përgjigjeje e mundshme apo edhe e vetme në këtë pyetje është vetëdija e Ejubit a.s. për të qenë falënderues për gjithë atë që ka pasur më herët si dhunti nga Zoti i Gjithëmëshirshëm, si dhe shpresa dhe optimizmi i paluhatshtëm që kishte, gjithmonë duke shpresuar se Zoti do të bëjë zgjidhjen më të mirë për të (Sad, 41-44).

Kush është më i sprovuar që nga fëmijëria në ndjenjat, karakterin dhe identitetin e tij moral dhe njerëzor se Jusufi a.s., i cili u dëbua nga vëllezërit e tij (Jusuf, 9), u shit në treg si plaçkë nga tregtarët (Jusuf, 20) dhe u dënua me burgim si përdhunues në shtëpinë ministrore nga ku edhe u ushqye dhe u rrit (Jusuf, 25)? Çka e mbajti atë të fortë dhe të qëndrueshëm, qoftë në aspektin psikik qoftë në të qenët optimist se një ditë do të shkëlqej dielli mbi personalitetin e tij (Jusuf, 34)? S'ka dyshim se ishte besimi në vetvete dhe bindja e fortë që kishte tek Allahu xh.sh., si dhe lutja e tij apo strategjia që e vërtetë të dalë në dritë (Jusuf, 51). Prandaj s'ka dyshim se optimizmi i tij e bëri që jo vetëm ta shpëtojë vetveten, por t'i dalë në krah udhëheqësit të asaj kohe dhe popullatës së atij vendi, e cila do të rrezikohej me ekzistencë

(Jusuf, 55). Prandaj, që nga këta shembuj, por edhe shumë të tjerë, mund të konstatojmë se shpresa është faktori esencial i suksesit të njeriut, pavarësisht rrethanave me të cilat ai ballafaqohet.

ÇKA ËSHTË SHPRESA NGA PRIZMI I FESË ISLAME?

Me shpresë “er rexxau” nënkuptohet dëshira që del nga zemra për të arritur diçka të dashur në të ardhmen me ndihmën e Allahut të Lartësuar, duke u angazhuar në arritjen e saj dhe duke u mbështetur fuqishëm tek Allahu xh.sh.. Kjo dallon nga dëshira përtace që nuk shoqërohet me veprim. Ai i cili i shfrytëzon shkaqet për të vepruar vepra të mira dhe për t'u larguar nga veprat e ndaluara, si dhe duke shpresuar nga mëshira, bujaria, fisnikëria dhe bamirësia e Allahut quhet shpresues (raxhij), kurse ai i cili nuk i shfrytëzon shkaqet për të vepruar, nuk mund të quhet shpresues, por dëshirues-iluzionist (mutemennij). Këto dy definicione argumentohen me ajete kuranore, ku Allahu xh.sh. thotë: “Kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të punojë vepër të mirë, dhe, le të mos i bëjë shok askujt në të adhuruarit e Zotit të vet!” (Kehf, 110). “Nuk është (shpëtim) sipas dëshirave tua as sipas dëshirave të ithtarëve të librit. Kushdo që bën keq, do të ndëshkohet me të dhe, pos Allahut, nuk ka për t'i gjetur vetes as mbrojtës as ndihmës.” (Ali Imran, 123).

Po ashtu dallimin në mes shpresës me veprim “rexha” dhe dëshirës pa veprim “temena” e gjejmë edhe në hadithet e Pejgamberit a.s., i cili thotë: “I zgjuar është ai i cili e gjykon vetveten dhe punon për (jetën) pas vdekjes, kurse i pafuqishëm është ai i cili i ndjek tekat e veta dhe pret nga Allahu plotësimin e dëshirave.” (Tirmidhiu, 249).

Edhe Ibni Kajimi në librin e tij “Midraxhu Salikin” thekson: “Të gjithë dijetarët janë unanimit se shpresa nuk realizohet ndryshe, përveçse duke vepruar.”

Sipas parimeve të fesë islame, shpresa ka një pozitë të lartë dhe llogaritet në kategorinë e ibadeteve apo devocionit shpirtëror dhe ndërlidhet ngushtë me dashurinë ndaj Allahut të Lartësuar dhe frikën prej Tij. Në Kuran, Allahu xh.sh. thotë: “Ata që i luten atyre, vetëkërkojnë mënyrë ndërmjetësimi te Zoti i tyre, cili është më i afërt, shpresojnë mëshirën e Tij dhe i frikohen dënimit të Tij. Me të vërtetë, dënimit të Zotit tënd çdokush duhet t'i ruhet.” (El Isra, 57).

Kërkimi i ndërmjetësimi te Zoti apo kërkimi i afrimit tek Ai, nuk bëhet ndryshe vetëm se përmes ibadetit dhe veprave

të zemrës nga të cilat edhe ndërtohet besimi, si: dashuria, frika dhe shpresa.

Xhabiri r.a. transmeton dhe thotë se e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut tri ditë para vdekjes së tij duke thënë: “Asnjërin nga ju të mos e gjej vdekja ndryshe vetëm se duke pasur mendim të mirë për Krijuesin e tij.” (Muslim, 2877). Po ashtu, në një hadith kudsij, Allahu xh.sh. thotë: “Unë jam me mendimin e robit tim, prandaj ai le të mendoj çfarë të dojë.” (Ahmedi, Darimiju dhe Ibni Hibani).

Se shpresa është nga cilësitë e besimtarëve të vërtetë, e shohim edhe nga lavdërimi që Allahu u bënë robërve të tij besimtarë: “Ata të cilët besuan, ata që u shpërngulën dhe luftuan në rrugën e Allahut, ata meritojnë të shpresojnë në mëshirën e Tij. Allahu falë shumë dhe është mëshirues.” (El Bekare, 218).

Kurse në anën tjetër, Allahu xh.sh., porositë besimtarët që e kanë ngarkuar veten me gabime, që në asnjë mënyrë të mos i humbin shpresat nga Ai, sepse në çdo situatë dhe për çdo problem zgjidhjet janë të mundshme, edhe atëherë kur mendësia e njeriut nuk i parasheh.

Thuaj: “O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse Allahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshirues!” (Ez Zumer, 53).

Kështu që, çdo njeri që di të logjikojë, e kupton se asnjëherë nuk duhet të humbë shpresën, sepse mëshira e Allahut për robërit e Tij është gjithmonë në favor të njeriut, dhe ai që edhe pas kësaj nuk shpreson, bën edhe njëherë gabim pas gabimeve të shumta që i ka bërë më herët. Për të përfituar nga mëshira e Allahut kërkohet veprim, dhe veprimi yt në këtë rast është të pendohesh dhe pranimi i pendimit tënd është i garantuar me Kuran.

SHPRESA NGA KËNDVËSHTRIMI PSIKOSHKENCOR

Shpresa nuk është kërkesë e domosdoshme vetëm nga aspekti fetar, ajo është faktori esencial për suksese në të gjitha fushat. Shpresa rrit motivimin e njeriut, dhe po të humbet shpresa, njeriu lufton e humb rrjedhimisht edhe motivimin. Pa shpresë, natyrisht se mungon fuqia dhe arsyeja për të qenë i durueshëm dhe i vendosur, dhe më pas zë vend frika se gjithçka do të jetë e kotë. Për aq kohë sa njeriu ka shpresa se do të

bëhet mirë, ai ka mundësinë për t’iu rezistuar frustrimeve, problemeve dhe krizave. Për këtë arsye, është e rëndësishme të mendohet pozitivisht për ta pasur të qartë se ne mund të përmirësohemi, t’i parandalojmë pasojat, të fillojmë përsëri nga e para, apo të gjejmë edhe zgjidhje të tjera. Me shpresë njeriu mund të arrij objektivat dhe qëllimet. Ta shikosh të ardhmen me pozitivitet, fiton vendosmëri dhe stabilitet. Nëse njeriu është i bindur diçka të arrij, ai i tejkalon të gjitha pengesat, dhe kështu ai vjen deri te qëllimi. Shpresa të shpie në zbatim dhe zbatimi sjell sukses. Po ashtu shpresa përmirëson shëndetin dhe mundëson edhe shërimin. Ajo ndikon pozitivisht si në trup po ashtu edhe në shpirt. Ne mund t’i bartim dhimbjet më lehtë dhe mund të shërohemi më shpejt. Shpresa për të bërë më mirë është shumë e rëndësishme për vetë shërim. Pavarësisht sëmundjeve dhe diagnozave, hulumtimet kanë vërtetuar se shpresa ka fuqi të jashtëzakonshme vetë shëruese, forcon sistemin e imunitetit, zvogëlon frikën dhe mënjanon depresionin.

HOPE THEORY E CHARLES RICHARD SNYDER

Richard Snyder (1944-2006), psikolog amerikan i specializuar në psikologjinë pozitive ka nxjerrë teorinë e shpresës (Hope Theory), teori e cila flet për besimin si faktor qendror për zhvillimin e suksesshëm të njeriut dhe organizatave. Gjatë hulumtimit të tij, ai pyeste njerëz të ndryshëm për qëllimet dhe objektivat e tyre dhe se çfarë do të thotë shpresa për ta. Në pah dolën tre faktorë themelorë, të cilët janë vendimtarë për besim dhe arritje të qëllimeve; objektiviteti, aftësia vepruese dhe kreativiteti. Snyder i sheh veprimet njerëzore si thelbësisht të orientuara drejt qëllimit. Për të, besimi do të thotë të kesh pritshmëri optimiste për të ardhmen dhe të shikosh përpara me emocione pozitive. Kjo përfshinë tri procese qendrore: orientimin e qëllimit, të menduarit strategjik dhe aftësinë për të vepruar. Pra besimi është një qëndrim i brendshëm. Ju vendosni qëllime, gjeni mënyra dhe motivoni veten për të ndjekur këto rrugë në mënyrë që qëllimi juaj të arrihet. Nëse ky proces ndodh me një qëndrim të sigurt, do të keni më shumë sukses dhe to t’i arrini qëllimet tuaja më shpejt. (Zentrum).

Nëse do të mundohemi ta kuptojmë teorinë e shpresës së Snyder dhe ta shikojmë atë përmes prizmit të Kuranit,

“Kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të punojë vepër të mirë, dhe, le të mos i bëjë shok askujt në të adhuruarit e Zotit të vet!”

(Kehf, 110)

Pavarësisht sëmundjeve dhe diagnozave, hulumtimet kanë vërtetuar se shpresa ka fuqi të jashtëzakonshme vetë shëruese, forcon sistemin e imunitetit, zvogëlon frikën dhe mënjanon depresionin.

mendoj se do ta gjejmë atë në ajetin kuranor: “E kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun, se Allahu i do ata që mbështeten.” (Ali Imran, 159).

Pra në këtë ajet gjejmë orientimin e qëllimeve, urdhrin për të vepruar si dhe shpresën tek Allahu xh.sh. si faktorë që garantojnë suksesin. (V.B.).

SHPRESA NUK ËSHTË GJENDJE E PËRHERSHME

Shpresa nuk është gjendje e përhershme. Ajo mund të shoqërohet me dyshime, frikë, apo pesimizëm, dhe mund të humbet apo të thyhet. Por nuk duhet harruar që ndonjëherë zgjidhja për një labirint apo enigmë është e vështirë për t'u gjetur dhe mund të na duhet ta kërkojmë atë për një kohë të gjatë. Nëse nuk dorëzohemi në kërkimin e zgjidhjes, do ta gjejmë atë. Në thelb nuk ka e as nuk ekzistojnë probleme. Të gjitha problemet janë thjesht labirinte apo enigma që duhen zgjidhur. Nëse ndërjegjësoheni për këtë, atëherë do të fitoni shpresë dhe do të jeni të sigurt, sepse e dini që thjesht duhet të kërkonim mjaftueshëm për zgjidhjen e labirintit apo enigmës dhe do ta gjeni. “Të kesh shpresë në kohë vështirësish, krizash personale dhe ekonomike, do të thotë të kesh një të ardhme.”

SI TË RUHET SHPRESA?

Rëndësi të veçantë për ta ruajtur shpresën është ta pranosh situatën aktuale, të mos kërkojsh fajtor dhe të mendosh për të bërë hapin tjetër. Injoroni çdo gjë negative dhe përqendrohuni në aspektet e tjera pozitive, konsultohuni me persona të besueshëm. Mundohuni të merrni gjërat e bukura nga e kaluara dhe shoqërohuni me njerëz pozitivë që qëndrojnë pranë jush me këshilla të mira. Kujtoni momentet e suksesit të së kaluarës dhe se si i keni ngadhënjyer. Veproni, sepse t'i përjetosh momentet e vështira me pasivitet kalon në rolin e viktimës, kurse të jesh aktiv në situata të vështira të mundësohet që ta kesh vetëkontrollin ndaj situatës dhe të mundësohen hapësira të tjera vepruese dhe perspektiva të reja.

Edhe nëse këshillat e lartpërmendura janë të bazuara nga të gjeturat psikologjike shkencore, mendoj se të gjitha këto kanë bazë në Kuran

dhe hadithe të Muhamedit a.s., prandaj, edhe është domosdoshmëri e kohës që t'i kthehemi seriozisht këshillimeve fetare dhe shkencore profesionale për t'i mënjeluar të gjitha aspektet negative që sot po na rrethojnë dhe në të njëjtën kohë edhe po na rrezikojnë ekzistencën, qoftë atë materiale po ashtu edhe atë shpirtërore. Mendoj se nuk është e mjaftueshme këshilla e një hoxhe me teologji të përgjithshme apo një mjeku me mjekësi të përgjithshme, por na duhen qendra këshilluese me këshilltarë profesionalë teologjikë, psikologjikë, ekonomikë, zhvillimorë etj., për t'ju dalë në ndihmë gjithë hallexhive, për t'i motivuar që të ngritën në këmbë dhe të shpëtojnë nga ndjenjat e pesimizmit. Po e përmbyllim këtë punim duke ripërsëritur ajetin kuranor: “...mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse Allahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshirues!” (Ez Zumer, 53).

Burimet:

1. Sherif Ahmeti, Kurani, përkthim me komentim në gjuhën shqipe.
2. Hadithet: www.dorar.net
3. Revista Kosvarja: <https://www.kosovarja-ks.com/me-shume-se-1-mije-vetevrasje-kane-ndodhur-ne-20-vitet-e-fundit-ne-kosove/> 17.12.2023
4. Suizidrate in ausgeählten Ländern Europas nach Geschlecht im Jahr 2017, “Të dhënat e suicidit në vendet e zgjedhura të Evropës sipas gjinisë të vitit 2017”
5. <https://de.statista.com/statistik/daten/studie/248379/umfrage/anzahl-der-suizide-in-ausgeaehlten-laendern-nach-geschlecht/> 17.12.2023
6. Suizidrate nach Laender 2019 “Të dhënat e suicidit sipas shteteve 2019”
7. https://de.wikipedia.org/wiki/Suizidrate_nach_Laendern 17.12.2023
8. Groves, Noah. Lituaninen, ein Land im Kampf gegen Selbstmord, Profil, 2017 “Lituanian, një shtet në luftë kundër vetëvrasjeve”
9. <https://www.profil.at/ausland/litauen-selbstmord-8328230> 17.12.2023
10. Idrizi, Abdurahim. Pse shpresa është kaq e rëndësishme? <https://telegrafi.com/pse-shpresa-eshte-kaq-e-rendesishme/> 17.12.2023
11. Xhebrun, Nexhla. Er Rexhau ibadetun kalbijetun, 2017, “Shpresa është ibadet shpirtëror” <https://www.alukah.net/sharia/0/111104/عبادةقلبية-الرجاء/> 17.12.2023
12. Zentrum für Integrative Positive Psychologie, Die Kraft der Hoffnung, Qendra e Psikologjisë Pozitive Integrative, “Fuqia e shpresës” <https://www.zipp.pro/blog/positive-psychologie/die-kraft-der-hoffnung/> 17.12.2023

Ligji dhe etika e luftës në Islam

Prof. dr. Mehmet Görmez

Deri më sot, historia e njerëzimit ka parë shumë masakra barbare. Mirëpo, ky brutalitet në Palestinë, konkretisht në Gaza, për të cilin jemi dëshmitarë për dhjetëra ditë, është i paprecedent. Në histori, gjithmonë ka pasur luftëra. Por, kurrë deri më sot nuk është parë një masakër e tillë, pa kurrfarë ligji dhe etike të luftës siç po ndodh në Gaza. Gjatë kësaj periudhe, brutalisht është shkelur e gjithë ajo që ka të bëjë me ligjin dhe etikën e luftës, që është e miratuar nga të gjitha fetë dhe qytetërimet. Kurrë me kaq mizori nuk janë marrë në shënjestër civilët. Kur civilët strehohen në spitale, bombardohen spitalet. Kur strehohen në shkolla, bombardohen shkollat. Kur shkojnë në kampe, bombardohen kampet. Të gjitha spitalet e atij qyteti të madh janë shndërruar në varreza fëmijësh. Janë të privuar nga ilaçet, ushqimi, drita... Mbi të gjitha, e gjithë kjo po ndodh para syve të botës në kohë reale. Për këtë shkak, unë dua t'i ndaj me ju disa shënime në lidhje me ligjin dhe etikën e luftës në Islam.

Fillimisht dua të theksoj se qytetërimi islam i ka paraqitur njerëzimit një ligj dhe etikë lufte që nuk është parë në asnjë kulturë dhe qytetërim tjetër. Dijetarët e parë të jurisprudentës islame i kanë lënë njerëzimit një trashëgimi të madhe. Në këtë trashëgimi e quajmë kitâbu's-sijer. Sijeri ka dy kuptime. Këtu kemi të bëjmë me sijerin në lidhje me marrëdhëniet ndërkombëtare, e jo me siran që ka kuptimin e jetës së Pejgamberit a.s.. Në këtë literaturë, veçanërisht ligji dhe etika e luftës është trajtuar në të gjitha aspektet e mundshme. Në lidhje me këtë temë, kemi shkrimet e imam Muhamedit, nxënësit të parë të Ebu Hanifes, imamet të medhhebit tonë. Pas Kitâbu's-sijer, Sijer-i sagir, Sijer-i kebir, Serahsi i ka shpjeguar këto, madje janë

përkthyer edhe në gjuhë të tjera. Në fakt janë burime të përkthyera në osmanishte në periudhën e sulltan Mahmutit. Këto vepra vlerësohen si burimet kryesore të librit "Ligji i Luftës dhe Paqes" të Hugo Grotius, i cili në botën perëndimore konsiderohet si themelues i marrëdhënieve ndërkombëtare ose drejtësisë ndërkombëtare. Përveç kësaj, në shekujt e parë, përveç librave të sijerit janë shkruar edhe libra të xhihadit. Edhe në këtë literaturë i është dhënë shumë hapësirë ligjit dhe etikes së luftës.

Cila është përmbajtja e kësaj literature? Cilët janë personat që gëzojnë imunitet gjatë luftërave? Si duhet të bëjmë dallimin civil dhe ushtarak? Si trajtohen civilët që nuk janë pjesëmarrës në luftë? A mund të organizohen sulme të rastësishme kundër armikut pa pasur parasysh objektivin? A mund të bëhen bastisje natën, cila është dispozita në këtë rast? A mund të përdoren civilët si mburoja të gjalla, me në krye fëmijët dhe gratë ose kur përdoren si mburojë e gjallë, si duhet të veprojnë ushtria islame? Si veprohet me ata që kërkojnë siguri? A mund të plaçkitet pasuria e armikut në luftë? Si aplikohet ligji i kafshëve në luftë? Si do të respektohet e drejta e natyrës, ligji i qyteteve? A lejohet tortura edhe nëse ka për qëllim përfitimin e informacioneve ushtarake? Cilat janë dispozitat e robërve të luftës? Le të themi se ka të lënduar, a duhet të mjekohen? Çfarë duhet bërë me armiqtë e vdekur?

Mund të gjejmë plot parime të rëndësishme nën titullin "Dispozita e të vdekurve". Rreth këtyre pyetjeve dhe të ngjashmeve, shohim se me të vërtetë kjo etikë buron nga Drejtësia Hyjnore që mbart mëshirë, me të gjitha parimet e saj, dhe atë do ta sjellë në praktikë qytetërimi islam. Parime dhe vlera morale, këtu e 1300 vjet më parë, në shekujt e parë të

Qytetërimi islam i ka paraqitur njerëzimit një ligj dhe etikë lufte që nuk është parë në asnjë kulturë dhe qytetërim tjetër.

Islamit dhe që janë trajtuar në literaturën e librave të sjerit dhe si të tilla është arritur në përfundimin se janë në përputhje me parimet universale. Në atë gradë sa, në të vërtetë kur e mendojmë, kur e shqyrtojmë këtë literaturë, jemi dëshmitarë të ekzistencës së parimeve të larta njerëzore, që edhe sot akoma nuk praktikohen as që mund të gjenden në marrëveshjen e Gjenevës. Kështu, lind pyetja: si u themelua kjo literaturë, cilat janë burimet e saj? Pa dyshim se themelet e ligjit të luftës dhe paqes, ashtu edhe themelet e ligjit të luftës dhe etikës së luftës i gjejmë në Kuran. Në fakt, myslimanëve për një kohë të gjatë iu është ndaluar luftimi. Mirëpo, pas hixhretit (emigrimit), si pasojë e sulmeve të shumta, Allahu i Plotfuqishëm, ua lejoi luftën me qëllim mbrojtjeje. Ajeti fillon kështu: *“Atyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje të luftojnë, për shkak se u është bërë padrejtësi”*.¹ Por, në ajetet që kanë të bëjnë me lejen për luftë, zakonisht përmendet ky ajet: *“Luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju sulmojnë e mos e teproni (mos i kaloni kufijtë në luftë) se Allahu nuk i do ata që e teprojnë”*.² Këta kufij që përmenden në Kuranin famëlartë, ashtu si në çdo fushë tjetër janë të detajuar nga Pejgamberi a.s., me fjalë dhe me praktikë. Në ligjin e luftës, Pejgamberi a.s., më tepër ka folur për ata që janë të paprekshëm. I Dërguari i Allahut çdoherë kur dërgonte ndonjë grup të vogël ose ushtri në luftë iu drejtohej kështu: *“Shkoni me emrin e Allahut, veproni me emrin e të Dërguarit të Allahut”*. Por, mos vrisni asnjë të moshuar, mos i vrisni foshnjat, as fëmijët, mos i prekni gratë dhe as mos i vrisni ato. Dhe mos e teproni, bëhuni rregullues, bëni mirë. Allahu i do ata që bëjnë mirë!”³

Këto janë fjalimet e Pejgamberit a.s. gjatë shkujarjes në luftë. Jo vetëm me fjalë, por ka luftëra që Pejgamberi a.s. ka marrë pjesë vetë personalisht. Si në Bedër, Uhud, Hendek, Hajber, Tebuk, Mute dhe në gjithë luftërat e tjera deri në çlirimin e Mekës ka lënë parime, vlera që shërbejnë si shembull për

gjithë njerëzimin deri në ditën e Kiametit. Ndonjëherë jemi dëshmitarë që i është tërhequr vërejtja në këto çështje. Për shembull, e dimë se në luftën e Uhudit, hz. Hamzës iu prenë të gjitha organet, iu bënë copa-copa. Kur e pa xhaxhain e tij në këtë gjendje, pasi u lut për të duke lotuar, dolën nga goja e tij e bekuar këto fjalë: *“Falënderimi i takon Allahut, edhe ne do të dënojmë së paku 70 vetë prej tyre”*. Por, Xhibrili si paralajmërim sjell këtë ajet të sures Nahl: *“Kur të merrni hak, ndëshkoni në atë masë sa jeni ndëshkuar ju”*. Pas kësaj pason pjesa: *“Por, nëse bëni durim, kjo është më e mirë për ju”*.⁴ Kështu Allahu Fuqplotë, nëpërmjet Pejgamberit a.s. e ka ndaluar që në luftë të veprohet vetëm me urrejtje, mllef, hakmarrje e të kalohen kufijtë.

Kur vijmë në periudhën e hulefai-rashidinëve, në kohën e hz. Ebu Bekrit dhe Osmanit, kemi letra të mrekullueshme, të cilat ua kanë dërguar komandanteve të luftës e që na kanë arritur deri më sot. Gjithashtu ka fjalime që kanë mbajtur kur kanë dërguar ushtritë. Menjëherë pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut, Ebu Bekri duke e përcjellë Usame b. Zejdin për në Sham, ai përsëri ia radhiti të gjitha parimet e të Dërguarit të Allahut që kanë të bëjnë me ligjin e luftës. *“O ju njerëz, mos tradhtoni, mos e teproni, mos i prekni njerëzit e pafajshëm, mos torturoni, mos i vrisni fëmijët, mos i vrisni të moshuarit dhe gratë, mos i rrëzoni drunjtë e hurmave, mos i digjni, mos e prisni asnjë dru me fruta, mos e therni asnjë dele, lopë, deve, përveçse sa për të mbajtur shpirtin gjallë”*. Pastaj vazhdonte: *“Do të shihni disa njerëz që i janë përkushtuar ibadetit (adhurimit) në manastire, as ata mos i prekni, lërinë në punën e tyre”*.⁵

Në kohën e hz. Ebu Bekrit, Ukbe b. Amir kishte çliruar një qytezë të krishter. Në krye ishte një patriark zullumqar. Ukbe ia preu kokën patriarkut dhe e dërgoi në Medinë. Halifeja e të Dërguarit të Allahut, mllefoset shumë dhe thotë: *“Ju paskeni luajtur mendsh duke i tejkaluar kufijtë! A e keni lënë*



sunetin e të Dërguarit të Allahut dhe keni filluar të ndiqni sunetin e keq të bizantinëve dhe persianëve. Mos më dërgoni mua kokë po më çoni lajm, më dërgoni letër.”⁶ Dhe në fund ia rikujtoi një hadith madhështor të të Dërguarit të Allahut, i cili ndalon torturat: “Tre kategori njerëzish në ditën e kiametit do të vuajnë dënimin e madh: “Ai që vret pejgamberë, udhëheqësi që zvarrit njerëzimin në humbje dhe torturuesi.”⁷

Në periudhën e Hz. Omerit, janë bërë çlirime të mëdha prej Egjipti deri në Iran dhe Azerbejxhan. Të gjitha çlirimet islame pasi që janë bërë gjatë sundimit të Hz. Omerit në këtë periudhë, të gjitha parimet, udhëzimet e ligjit dhe etikës së luftës janë garantuar në mënyrë universale. Hz. Omeri kur e ka dërguar Ebu Ubejden në Sham, i ka mbajtur këtë fjalim: “Shkoni me emrin dhe me ndihmën e Allahut! Shkoni duke kërkuar fitore prej Allahut! Mos u ndani nga e vërteta dhe durimi! Luftoni në rrugë të Allahut, por mos i kaloni kufijtë e ligjit të luftës! Allahu nuk i do ata që i kalojnë kufijtë! Mos t’iu kaplojë frika kur të ndesheni me armikun! Mos i torturoni njerëzit! Kur të fitoni mos e teproni! Mos i vrisni pleqtë, gratë, fëmijët e foshnjat!”⁸ Pastaj shtoi: “Mos i harroni këto edhe kur të jeni në kulmin e luftës, mos vraponi pas plaçkitjes, mjaftohuni me sevapet e xhihadit dhe hairin që do ta fitoni nga tregtia me Allahun. Kjo është mirësia e madhe e Allahut.” Gjatë sundimit të Hz. Omerit në Iran, një ushtar mysliman vrau një ushtar apo komandant nga pala e armikut pasi që ai kërkoj prej tij siguri, dhe pasi që ky i ka thënë: “Në rregull, mos u frikëso!” Ai e ka hequr qafe pasi e ka ulur shpatën e tij duke e prerë kështu në besë. Kur i arriti ky lajm Hz. Omerit, ai i dërgoi një ultimatum komandantit të ushtrisë, dhe i tha: “Kushdo që prek një person pasi e ka marr në besë, dënimin do t’ia jap personalisht unë.”

Sidomos në këto troje palestineze që po i shohim në kohë reale këto ditë, Hz. Omeri, pati bërë një hyrje madhështore, kjo gjashtë vjet pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut, dhe që përmban parime madhështore të ligjit dhe etikës së luftës. Nëse do të krahasoni ligjin dhe etikën e luftës së Islamit me qytetërimet e tjera, hyrja e kryqtarëve në Jerusalem dhe takimi i myslimanëve me të dy, Hz. Omerin dhe Salahudin, mjafton si argument të krahasohet hyrja e tyre në Jerusalem si dhe parimet gjatë sundimit dhe atë që lanë pas. Pa dyshim, këtë gjendje ne do ta vërejmë në vazhdimësi deri te parimet e bashkëjetesës. Këtë e shohim edhe pas Salahudin Ejubit dhe kemi mundësi ta shohim pikërisht në dokumentet që datojnë deri pas Javuz Sulltan Selimit.

Të gjitha
çlirimet islame
pasi që janë
bërë gjatë
sundimit të Hz.
Omerit në këtë
periudhë, të
gjitha parimet,
udhëzimet e
ligjit dhe etikës
së luftës janë
garantuar në
mënyrë
universale.

Ndërkohë, ndërsa historia përparon, të dashur vëllezër dhe motra të mia, pas ndryshimit të formës së luftës, zhvillimet e mëdha në armët e luftës i çuan juristët tanë islamë në disa diskutime të tjera. Asokohe nuk kishte as armë kimike, as bomba bërthamore, as raketa fosfori, as armë të shkatërrimit në masë, as bomba atomike, por atëherë myslimanët u njohën me katapultën për herë të parë. Ose kur hasnin shigjeta me zjarr ose helm në majë, të njohura si zjarri grek, ose kur shihnin se armiqët përdornin fëmijët dhe gratë si mburojë, ata i rishkruanin parimet e ligjit dhe etikës së luftës. Këto situata të reja sollën diskutime të reja. Për shembull, a do të ishte e drejtë të përdroreshin katapultat ose armët e ashtuquajtura “huxhumatul ashvaije-armë” të hedhura kuturu, pra armë që hidhen në mes të qytetit, pa e ditur se kush do të vdesë? Apo, a është e drejtë që qytetet të digjen duke dërguar shigjeta ose raketa me zjarr në majë të tyre? Po ta shikojmë me vëmendje, do të arrijmë në përfundimin se ligji dhe etika e luftës sipas parimeve islame të cilat janë të rëndësishme për të ruajtur ekuilibrin midis nevojave të luftës dhe mbijetesës së ymetit. Për shembull,

sipas këtyre ligjeve mund të goditen me katapultë muret, por jo të shkatërrohen qytetet. Djegia për shembull është e ndaluar kategorikisht. Përdorimi i fëmijëve dhe grave si mburoja është gjithashtu kategorikisht e ndaluar, dhe nëse përdoren nga ana e armikut, atëherë myslimanët do të duhej të ndalonin sulmin dhe t’i përmbaheshin vrasjes së grave dhe fëmijëve. Në periudhën e dytë, pra sidomos pas periudhës së sahabëve dhe tabiinëve, mund të rendisim 5-10 pikat më të rëndësishme që juristët përcaktuan si më kryesore për ligjin dhe etikën e luftës. Para së gjithash, ata që janë të paprekshëm në luftë kanë qenë gjithmonë çështja më parësore. Këto janë pesë kategori njerëzish dhe prej tyre janë: gratë, fëmijët, të moshuarit, priftërinjtë që i përkushtohen adhurimit dhe civilët jo të aftë për të luftuar. Juristët u shtuan këtyre kategori të tjera, bazuar në burime islame. Për shembull, në burimet tona thuhet se të sëmurët, të paaftët, ata që nuk mund të ngrihen në këmbë, të sëmurët mendorë, fermerët, tregtarët, zanatçinjtë dhe barinjtë nuk duhet të preken kurrë dhe konsiderohen si jo luftëtarë, përveç nëse detyrohen ta bëjnë këtë. Aq shumë kujdes është treguar në dallimin mes tyre, sa që disa nga diskutimet janë shumë domethënëse. Pra, për shembull, e dimë që ndalohet vrasja e të moshuarve, por nëse një i moshuar nxirret në front për të dhënë udhëzime mbi strategjinë e luftës, a mund të pushkatohet apo jo? Ose, nëse një grua qëndron para ushtrisë dhe inkurajon ushtrinë duke



hapur të shtënë e parë dhe duke hedhur gurin e parë, ekziston pra dhe ky lloj debati nëse mund të pushkatohet ose jo. Ka debate edhe kur vjen puna te bastisja natën, ngase nuk mund ta dimë se kush do të dëmtohet dhe sa, pra a lejohet të bëhet bastisje natën apo jo. Çështja e përdorimit të civilëve si mburoja njerëzore është absolutisht e papranueshme. Kur e përdorin armiqtë, bihet dakord që të mos sulmohet, të paktën nëse nuk rrezikohet ekzistenca e ushtrisë. Tema e sulmeve pa dallim, ka zënë një vend të rëndësishëm në të gjitha librat e jurisprudencës së luftës dhe të gjitha bien dakord që shënjestrimi i civilëve nuk është i lejueshëm. Çështja e shkatërrimit të qyteteve, p.sh., në luftë, nuk konsiderohet e lejuar t'i ndërpritet uji një qyteti, t'i shkatërrohet ushqimi, të helmohet ose të shkatërrohet ushqimi i kafshëve. Sipas disa mendimeve, është e lejuar vetëm për shkak të nevojës ushtarake. Madje, i Dërguari i Allahut ka thënë: “Nëse dikush i ka dhënë dikujt besën se nuk do t’ia prekë as gjakun e as jetën e tij dhe pastaj vendosë ta vrasë, vetë i Dërguari do të thotë: “Unë jam larg kësaj, edhe nëse i vrari është i pafë.”⁹

Torturat, vëllezërit e mi të dashur,

Nga thëniet e para të të Dërguarit të Allahut e deri te luftërat tona të fundit të Galipolit (Çanakalës) e deri te shumë luftëra të zhvilluara ende nga myslimanët, pika më e theksuar është se tortura nuk lejohet. Ekziston një udhëzim i qartë i Profetit të nderuar dhe konsiderohet si një nga ndalesat më të mëdha. Imam Maliku tha se askush nuk mund të torturohet, qoftë edhe për të marrë informacion ushtarak. Çështja e kërkitimit të sigurisë është trajtuar gjerësisht. Nëse dikush kërkon siguri

duke dërguar një lajmëtar, me gojë ose me shkrim, dhe duke ngritur një flamur të bardhë, ai mbetet i paprekshëm. I Dërguari i Allahut ka thënë: “Nëse i keni dhënë dikujt një garanci se nuk do t’ia prekë as gjakun e as jetën e tij dhe pastaj do ta vrasë, ai do të thotë: “Unë jam larg kësaj, edhe nëse i vrari është i pafë.”

Ka dy nëntituj të rëndësishëm që ia vlen të ndalemi në këto libra, “himâjetu’l-a’jân” - “himâjetu’l-hajvân” që do të thotë të parandalosh dëmtimin dhe të mbrosh pronën dhe kafshët në pronësi të armikut. Një nga parimet kryesore të ligjit të luftës është se nuk lejohet të shkatërrohet pasuria e armiqve. Po kështu, për shembull, pemët frutore nuk mund të priten. Ndërtesat nuk mund të prishen. Qytetet nuk mund të shndërrohen në gërmadha. Imam Evzaiu, një nga imamët e parë, varri i të cilit është tani në Bejrut, thotë se nuk është e lejuar që myslimanët t’i shkatërrojnë qytetet e tyre gjatë luftës. Sepse kjo konsiderohet si përhapje e përçarjes dhe shkatërrimit në tokë (fesat). Prandaj dua ta nënvizoj këtë pikë të rëndësishme. Në veçanti, juristët islamë bëjnë dallimin mes luftës dhe shkatërrimit në tokë. Andaj, ajo që shohim sot në Izrael dhe Gaza nuk është luftë. Nuk ka si të jetë luftë. Krimet e kryera kundër gjithë njerëzimit, pra shkatërrimi i tokës, siç e përmenda, ka dhe nëntituj në lidhje me luftën dhe të drejtat e kafshëve. Aty sqarohet shumë bukur se si duhen trajtuar krijesat dhe gjallesat, qeniet e gjalla pra, kjo pas sqarimit të dallimit midis gjallesave dhe jo gjallesave. Në librin e famshëm El Um të Imam Shafiut, gjejmë një përkufizim të tillë: “Ata që mbartin jetën janë ata që përjetojnë dhe ndjejnë dhimbje. Çdo mizori ndaj gjallesave përbën torturë, pra quhet torturë edhe ndaj kafshëve dhe kjo është e ndaluar.” Po kështu, Ibni Kudame, një nga dijetarët hanbeli, ka thënë se mizoria ndaj kafshëve të gjalla do të shkaktojë shkatërrim në tokë, madje dhe nëse janë kafshë që përdoren për luftë. Ai thotë se nuk lejohet as të shënjestrohet kali që bart armikun gjatë luftës. Nëse ai e përdor atë si mburojë për veten, atëherë konsiderohet e lejuar vetëm në rast nevojë. Çështja se si duhet të trajtohen robërit e luftës nuk përmendet vetëm në hadithe dhe libra të fikhut, por edhe në Kuran. “Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër.”¹⁰ Ashtu siç jemi të obliguar të ushqejmë jetimin nevojtar, jemi të obliguar të ushqejmë edhe robin e luftës. Ligji që aplikohet ndaj të dëmtuarit: I dëmtuari duhet të kompensohet.

Madje, vëllezërit e mi të dashur,

Në këto burime përfshihen udhëzime dhe parime të mëdha se si të trajtohen të vdekurit e armikut pas luftërave. Gjëja e parë që duhet të bëjmë është t’i dorëzojmë armikut trupin e pajetë dhe ta kthejmë aty ku i përket. Mirëpo, në rast se nuk merren nga armiku, është obligim që myslimanët ta varrosin atë. Dijetari i madh andaluzian, Ibni Hazmi thotë saktësisht kështu: “Nëse armiqtë nuk vijnë dhe nuk i marrin të vdekurit

e tyre, është detyrë e myslimanëve t'i varrosin të vdekurit e ushtrisë armike. Dhe nëse nuk e bëjnë këtë, nëse tregohen neglizhues në këtë dhe vendosin ta hedhin diku rastësisht, kjo quhet përdhosje veçanërisht përdhosje e trupit të të vdekurit, që gjithashtu është haram. Ekziston edhe një ligj pas luftës. Ligj për të siguruar paqen, përsëri i nxjerrë nga hadithet e Profetit tonë të dashur a.s.. Kur të përfundojë lufta, nuk ka vrasje të njerëzve të pafajshëm dhe dëmtim të të burgosurve të luftës. Dikush nga të burgosurit e luftës ia mbathi, madje pa e ndjekur askush nga pas. Pa asnjë keqtrajtim. Trajtimi njerëzor ndaj të gjithëve është thelbësor.”

Prej këtu dua të theksoj veçanërisht tri mësimet që i Dërguari i Allahut a.s. u dha sahabëve në lidhje me ligjin dhe parimet e luftës në rrugën drejt pushtimit të Mekës dhe tri mësimet që ai ua përcolli shokëve të tij dhe i përcolli përmes tyre. Kur ushtria u largua nga Medina dhe filloi të lëvizte drejt Mekës, flamurtar ishte Sad b. Ubade. Sad b. Ubade qëndroi mbi devenë e tij dhe mbajti këtë fjalim: “Sot është një ditë e vështirë që ndan mishin nga kocka. Sot është dita kur Allahu e lejoi derdhjen e gjakut. Sot është dita kur kurejshët do të poshtërohen.”¹¹ Sigurisht, myslimanët vuajtën më shumë se mekasit. Që andej u rrethuan. U detyruan të migrojnë. Ata organizuan edhe shumë luftëra për t'i eliminuar në Medine. Të gjithë ishin të mllëfosur, në fund të fundit. Por pavarësisht kësaj, të Dërguarin e Allahut e shqetësonin këto ndjenja urrejtjeje, zemërimi dhe hakmarrjeje. E mori flamurin nga dora e bajraktarit dhe ia dha të birit. Sipas një tjetër transmetimi ia dha hz. Aliut. Dhe më pas ai mbajti këtë lloj fjalimi: “Çfarë tha Sadi: Sot është dita e betejës kur mishi do të ndahet nga kocka?!” I Dërguari i Allahut tha: “Sot është dita e mëshirës.” “Sot është dita kur Allahu e ka ndaluar derdhjen e gjakut.” “Sot është dita kur Allahu na i ka bërë të ndaluar kurejshët.” Kështu e dha mësimin e parë dhe u nisën. Por gjatë rrugës, i Dërguari i Allahut pa një qen duke lindur tre këlyshë nën një shkurre. Ndaloi ushtrinë me dorë, zbriti nga deveja dhe shikoi me mëshirë qenin dhe këlyshët e saj. Dhe pastaj ai e thirri tek ai Xhuajl bin Surakan, një nga sahabët. Ai i tha: “Ju do të ruani këta këlyshët këtu. Sigurohuni që mos të dëmtohen.” Dhe kështu, ai në fakt po u jepte një mësim të dytë shokëve që shkuan të çlironin Mekën përmes dhembshurisë për kafshët. Mësimin e tretë e dha gjatë hyrjes në Mekë. “Kushdo që hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit dhe strehohet atje, ai është i sigurt.” Gjithashtu tha: “Ai që ngujohet në shtëpinë e tij është i sigurt.” Amnistinë e vazhdoi edhe më tej: “Kushdo që strehohet në Xhami al Haram është gjithashtu i sigurt.”¹² Dhe pastaj i mblodhi të gjithë në Qabe. Fillimisht i pyeti se çfarë mendoni se do t'ju bëjë? Ata thanë: “Ti je një njeri besnik dhe i mirë! Ti je biri i një njeriu bujar dhe të mirë!” thanë ata.¹³ Pastaj i Dërguari i Allahut tha: “Unë po them atë që Jusufi u tha vëllezërve të tij: “Sot nuk ka qortim kundër jush.”

Disa prej tyre, veçanërisht djemtë e Xhuzejmes, nuk e respektuan këtë udhëzim të Profetit dhe u larguan nga Meka. I Dërguari i Allahut a.s. e dërgoi pas tyre Halid b. Velidin. Por Halid b. Velidi i vrau ata edhe disa pjesëtarë të këtij fisi. Kur e dëgjoi këtë, i Dërguari i Allahut a.s. ngriti gishtin tregues dhe tha: “O Zot, unë tërhiqem (s'mbaj përgjegjësi) nga ajo që bëri Halidi, kërkoj strehim te Ti për këtë.” Dhe dërgoi Aliun dhe i kërkoj atij të paguante dëmshpërblimin e të vrarëve.¹⁴

Në fund, do të doja të sillja në vëmendje dhe një çështje tjetër. Siç e dini, njerëzimi, i cili ishte dëshmitar i brutalitetit të dy luftërave botërore, përjetoi vuajtje të mëdha dhe nënshkroi të ashtuquajturën kontratë “kurrë më”. Në fakt, Konventa e Gjenevës, e cila ishte në rendin e ditës në vitet 1850, u nënshkruan në Gjenevë, Zvicër, në vitin 1949. Kjo marrëveshje përbëhet nga katër nën marrëveshje dhe protokolle shtesë. Po çfarë thuhet në këto marrëveshje? Në pikën e parë flitej për të mbijetuarit dhe të plagosurit në luftë dhe më pas në nenin e tretë protokollat për civilët, jo pjesëmarrësit në luftë dhe robërit e luftës. Këto protokolle shtesë kishin të bënin me viktimat e luftës. Por fatkeqësisht këto marrëveshje u përtërinë më vonë me disa protokolle të tjera. Edhe pse përmban një pjesë të vogël të ligjit të luftës, për fat të keq, nuk u respektuan nga ata që vetë i vendosën. Dhe nuk gjejmë asnjë gjurmë të zbatimit të tyre gjatë kësaj masakre dhe brutaliteti ndaj Gazës, për të cilën jemi dëshmitarë prej dhjetëra ditësh. Megjithatë, njerëzimi po përballet vërtet me një sprovë të madhe. Jemi në një udhëkryq tashmë. Brutaliteti përmes përkrahjes së të fortëve po e varros njerëzoren. Lutja jonë drejtuar Zotit tonë që ky brutalitet të marrë fund sa më shpejt. Lutja jonë më e madhe që i gjithë njerëzimi të qëndrojë pranë popullit të shtypur të Gazës. Lus Zotin e Madhëruar që t'i mëshirojë dëshmorët dhe t'u japë ndihmën dhe mëshirën e Tij!

Përktheu nga turqishtja: Nada Dosti

1 El Haxh, 39.

2 El Bekare, 190.

3 Ebu Davudi, Kitabu'l-Xhihad, nr. i hadithit 2614.

4 En Nahl, 126.

5 Taberiu, Tarihu'r-Rusul ve'l Muluk, thk. Muḥamed Ebu'l-Fadl İbrahim, Bot. II-të, (Misir: Daru'l-Mearif, 1967), v. III, f. 226.

6 Nesaiu në Kitabu's-Sijer, 8928.

7 Ahmed b. Hanbeli në El Musned, 3868.

8 Ibën Kutejbe, Ujunu'l-Ahbar, Bejrut: Daru'l-Kutubi'l-İlmije, 1997, V. I, f. 185-186.

9 Bezzari në El Müsned, 2308.

10 El İnsan, 8.

11 Vakıdiu në Kitab'l Megazi, v.II, f.821.

12 Ebu Davudi në Sunen, f. 24, 25.

13 Bejhakiu në Es Sunenu'l-kubrâ, V.IX, f.195.

14 Buhariu në Sahih, nr. 58, Nesaiu në Sunen, Kudat, 16.

Kuptimi i haditheve në dritën e Kuranit fisnik

Dr. Muhamed Stublla

Nëse sipërfaqësisht shfaqet kundërthënie ndërmjet haditheve dhe ajeteve, kjo tregon se hadithi nuk është i saktë apo është i anuluar, ose ato argumente qofshin ajete apo hadithe nuk janë kuptuar drejt.

Parimet e paradhetë pazëvendësueshme për kuptimin e drejtë të fesë janë Kurani dhe hadithet e sakta. Këto dy burime duhet të besohen me besim të plotë e të palëkundur. Pastaj, tekstet hyjnë, të cilat duken në shikimin sipërfaqësor se kanë kuptim të kundërt apo kontradiktor duhet të harmonizohen ndërmjet vete. Konkretisht, duhet të harmonizohet apo sinkronizohet kuptimi i të gjitha ajeteve dhe kuptimi i të gjitha transmetimeve të haditheve. Në asnjë mënyrë nuk ekziston mundësia dhe nuk lejohet që të ketë kundërthënie reale ndërmjet tyre. Si do të ishte e mundur plotësimi i fesë nëse do të kishim kontradikta në Kuran dhe hadith?! Nuk mund të kontestohet fjala e Krijuesit të Gjithësisë kur thotë: “...Sot ua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj...” (El Maide, 3).

Nëse sipërfaqësisht shfaqet kundërthënie ndërmjet haditheve dhe ajeteve, kjo tregon se hadithi nuk është i saktë apo është i anuluar, ose ato argumente qofshin ajete apo hadithe nuk janë kuptuar drejt.

Është e paimagjinueshme që ajeti dhe hadithi i saktë dhe funksional – i pa anuluar – të kenë kuptime kontradiktore, apo që ato të mos kenë mundësi që të harmonizohen.

Këto parime të lartcekura, i ngjajnë një preambule, të cilës duhet t’i përshtatet çdo kuptim apo sqarim që ndërlidhet me burimet e fesë, Kuranin dhe hadithin. Zoti xh.sh., në Kuranin famëlartë thotë: “Sikur (Kurani) të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.” (En Nisa, 82).

Pra, përderisa Kuranit është prej Allahut, nuk ka mundësi të ketë kundërthënie reale

në përmbajtjen e tij dhe në raport me hadithet. Ndërsa, nëse nuk do të ishte prej Allahut, do të gjenim kundërthënie apo kontradikta ndërmjet vetë ajeteve, apo ndërmjet ajeteve dhe haditheve.

Rezultati i kësaj është se, çdo gjë që vjen prej Krijuesit të Gjithësisë është e saktë, respektivisht e pamundur të ketë kundërthënie apo gabime. Harmonia kuptimore e teksteve është argument se kjo shpallje vije nga i Gjithëdijshmi, Allahu xh.sh..

Hadithi është i njëjtë me Kuranin, për këtë Muhamedi a.s. ka thënë: “...Më është dhuruar Kurani dhe i ngjashmi i tij...”¹. I ngjashmi i Kuranit është suneti apo hadithet. Gjithashtu Zoti xh.sh., në Kuran thotë: “Ty (Muhamedi) ta zbritëm shpalljen që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre...” (En Nahël, 44).

Sigurisht që njëra nga shumë qëllimet e haditheve është edhe shpjegimi i ajeteve të Kuranit.

Në lidhje me pamundësinë e kundërthënies ndërmjet ajeteve dhe haditheve, por edhe nevojën e harmonizimit të tyre, dijetari i mirënjohur, Ebu Huzejmeh, ka thënë: “Nuk njoh ndonjë hadith të saktë, të transmetuar me rrugë transmetimi të saktë nga Resulullahu a.s., i cili është në kundërshtim me ndonjë hadith tjetër të saktë. Nëse dikush e gjen ndonjë shembull të tillë, të më informojë, në mënyrë që të shkruaj për harmonizimin e tyre.”²

Nëse nuk mund të gjejmë kundërthënie ndërmjet haditheve të sakta, të cilat rëndom e jo rrallë janë transmetuar kuptimisht, është e palogjikshme dhe e pamundur të gjejmë kundërthënie ndërmjet haditheve

dhe ajeteve të Kuranit, i cili është transmetuar dhe shkruar tekstualisht, siç ka zbritur.

METODOLOGJIA E TRAJTIMIT TË TEKSTEVE QË DUKEN KONTRADIKTORE

Në mënyrë që të sigurohemi që kuptimi i haditheve të jetë i drejtë dhe në kontekst me qëllimin e tyre, duhet të shikohet në Kuran, nëse kemi ajete që flasin për të njëjtën temë për të cilën flet hadithi, dhe të tillat duhet të shpjegohen në atë frymë kuranore.

Kjo është e domosdoshme, sepse shumë herë, edhe pse duket se kemi kundërthënie mes teksteve, realisht një gjë e tillë nuk ekziston, ato flasin për raste apo specifika të ndryshme të situatave. Andaj, nëse duket se kemi kundërthënie mes teksteve, duhet vepkohet si në vijim:

Saktësia e transmetimit të të gjitha ajeteve është e pa kontestuar, sepse janë transmetuar me zinxhir mutevatir të hifzit dhe shkrimit, (ajetet i kanë transmetuar grup i madh transmetuesish, në formë të shkruar dhe të memorizuar në mendje dhe zemra të besimtarëve). Nëse hadithi është mutevatir, është transmetuar grup pas grupi, që nga Pejgamberi a.s. e tutje.

Në këtë rast nuk ka mundësi të ketë gabime apo kundërthënie ndërmjet ajeteve dhe haditheve.

Në rast se në sytë tanë gjejmë kundërthënie ndërmjet teksteve hyjnore, dhe në asnjë mënyrë nuk mund t'i harmonizojmë ato, atëherë, shikohet cili tekst është para tjetrit, sepse teksti i fundit do ta anulojë tekstin e parë.

Nuk mund të ketë anulime të teksteve që flasin për besimin dhe tregimet. Nëse ndodhë kjo, do të përgënjeshtrohet shpallja, dhe kjo është e pamundur, përderisa rruga e transmetimit është e saktë, duhet të jetë i saktë edhe tregimi,

pa mundësi anulimi apo zhvlerësimi. Anulimi mund të ndodhë vetëm në norma juridike, të cilat janë kompletuar gradualisht, sigurisht, duke u plotësuar sikurse u plotësua tërësia e shpalljes.³

Nëse hadithi është mutevatir, por teksti përmban mundësinë që të japë dy apo më shumë kuptime, atëherë përzgjidhet kuptimi të cilin e mbështet apo përputhet me kuptimin e ajeteve. Mirëpo, nëse hadithi është mutevatir, dhe teksti është i drejtpërdrejtë, pa mundësi interpretimi, ndërsa shprehjet e ajetit të Kuranit përmbajnë më shumë se një kuptim, në këtë rast, ajeti interpretohet në përputhje me kuptimin e atij hadithi, i cili pamundëson gabimin në transmetim dhe nuk mund ta ketë interpretimin ndryshe.

Nëse hadithi nuk është mutevatir, edhe pse rruga e transmetimit është e saktë, përqindja e saktësisë nuk e përjashton mundësinë e gabimit, edhe pse mundësia e gabimit mund të jetë e ulët, në këtë rast, hadithi duhet të harmonizohet dhe të komentohet në përputhje me kuptimin që e përmban ajeti.

Nëse teksti i hadithit 'ehad – në tre brezat e parë ka vetëm një ose dy transmetues' – pra nuk është mutevatir, vije në kundërshtim me ajetin, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të harmonizohen me të, atëherë nuk punohet me atë hadith. Hadithi mbetet i pa funksion, apo i anuluar përderisa të gjendet një kuptim, i cili mund të përshtatet me përmbajtjen e ajetit, qoftë ai kuptim edhe përmes interpretimit indirekt.


Nëse nuk vepkohet sipas këtyre parimeve apo rregullave, do të zgjedhim tekstin apo kuptimin që është më i dobët, dhe do të anashkalojmë kuptimin më të fuqishëm, që do të ishte larg logjikës, respektivisht larg bazamenteve të shkencave islame. Këto koncepte i gjejmë në fushën e 'Muh'telef el Hadith⁴ - kundërthëniet në hadith, fushë e cila është pjesë e shkencës së Hadithit.

FORMA E TRAJTIMIT TË TEKSTEVE HYJNORE NË RAPORT ME TË VËRTETAT DHE TEORITË SHKENCORE

Ngjashëm me trajtimin që ua bëjmë teksteve fetare, nëse ndërmjet vete duken kontradiktore, të njëjtin trajtim ua bëjmë edhe të vërtetave dhe teorive shkencore.

Të vërtetat fetare (kur është e pa kontestuar rruga e transmetimit dhe interpretimi i teksteve) dhe të vërtetat shkencore, për të cilat nuk ka dyshim, siç është mundësia e shikimit të ndonjë koncepti, të vërtete shkencore etj., (jo teoritë shkencore) nuk mund të bien ndesh ndërmjet vete.

Nëse shfaqet ndonjë rast që disi duket sikur ka kundërshtitë ndërmjet të vërtetës fetare dhe të "vërtetës", ose thënë ndryshe ndonjë teorie shkencore, e vërteta fetare do të ketë prioritet në përzgjedhje.⁵ I padituri mund të bëhet i ditur, por edhe mund të avancoi në dituri, ama nuk mund të bëhet pejgamber. E vërteta hyjnore është para "të vërtetës" ose teorisë shkencore,



por në të vërtetë, ato, asnjëherë nuk mund të kenë kundërshtime thelbësore ndërmjet tyre, por gabimi është i mundshëm te njeriu. Si p.sh. mos kuptimi apo pamundësia e interpretimit të duhur, dhe nuk nënkupton në asnjë rast se paska ndonjë gabim te fjala e Krijuesit, i Cili ka zbritur shpalljen,⁶ sigurisht nëse nga ajeti nuk ka më shumë se një mundësi interpretimi.

Nëse ajeti apo hadithi, saktësia e transmetimit të së cilave është e pa kontestuar, por ato mund të kenë më shumë se një interpretim kuptimor, interpretimi i tyre nuk duhet të vijë në kundërshtim me të vërtetën shkencore, por duhet të komentohet në atë frymë. E vërteta shkencore ka fuqi apo është argument për përzgjedhjen e interpretimit të teksteve të cilat kanë disa kuptime dhe e përmbajnë edhe atë mundësi interpretimi që të përputhet me një të vërtetë shkencore.

Ndërsa nëse kemi të bëjmë me teoritë shkencore, dhe ajeti apo hadithi është i formës së prerë për nga transmetimi dhe kuptimi, atëherë teoria shkencore duhet të përputhet me tekstet hyjnore. Por, nëse teoria nuk mund të harmonizohet, atëherë, ajo anashkalohet apo refuzohet. Nga kjo rezulton se, nuk refuzohet teksti hyjnor për shkak të teorisë shkencore, sepse saktësia e saj është relative.

Nëse veprohet kështu, do të kuptohet çdo tekst dhe do të pamundësohet çdo keqkuptim. Andaj, çdo pretendim apo kontestim i teksteve hyjnore, se ajetet dhe hadithet janë të paqëndrueshme për shkak të kundërthënies mes vete apo me shkencën bashkëkohore, duhet t'u nënshtrohet këtyre kritereve të trajtimit të tyre.

Këto parime kërkojnë shembuj në mënyrë që të konkretizohen apo kristalizohen, por për shkak të hapësirës së kufizuar, nuk do të zgjerohemi më shumë. Ata që hynë në këtë fushë, shfaqen të 'mençur', andaj duhet të kuptojnë këtë shpjegim, përndryshe do të ishin injorantë në pretendimet e tyre, gjë e cila do të përmbyllte diskutimet e tyre para se ato të fillojnë, ose të tillët paraprakisht janë përcaktuar për të refuzuar argumentet, pavarësisht sa ato janë të qarta.

Çdo gjë që vjen
prej Krijuesit të
Gjithësisë është e
saktë,
respektivisht e
pamundur të
ketë
kundërthënie
apo gabime.
Harmonia
kuptimore e
teksteve është
argument se kjo
shpallje vije nga i
Gjithëdijsmi,
Allahu xh.sh..

KUPTIMI PRAKTIK I HADITHEVE NË DRITËN E KURANIT

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Nuk obligohet zekati i kulturave bujqësore nëse produkti nuk është pesë apo më shumë evsuk (njësi matëse) prej hurmave dhe drithërave.”⁷

Mbështetur në këtë, dijetarët nuk janë të unifikuar se për cilat nga kulturat bujqësore duhet të dhurohet zekati. Ata kanë mendime të ndryshme për llojet e kulturave bujqësore prej të cilave obligohet dhënia e zekatit. Diskutimet e tyre janë për drithërat të cilat janë ushqyese dhe që mund të peshohen, ndërsa prej frutave obligojnë vetëm hurmat dhe rrushi i tharë.⁸

Në këtë hadith përmenden drithërat sikurse janë: gruri, të cilit i ngjanë misri, orizi, etj.. Për nga lloji dhe mundësia e ruajtjes së tij janë: hurmat, të cilave ju ngjanë rrushi i tharë, etj.. Prandaj shumë dijetarë islamë, e kufizojnë zekatin e produkteve bujqësore, edhe pse dallojnë llojet e përzgjedhjes së tyre, për nga lloji dhe forma e llogaritjes, a peshohen në peshojë apo jo etj.. Këta e përjashtojnë zekatin në frutat dhe perimet, si p.sh. në: pemë, perime, sheqer, çaja, pambuk, zekati i të cilave është shumë më profitabil, sepse vlera e tyre është më e lartë.

Imam Ibën el Arabiju, i cili ishte prej kolosëve të medhhebit maliki, pas sqarimit të mendimeve të dijetarëve thotë: “Ebu Hanife, ajetin e Kuranit e ka vendosur si pasqyrë për kuptimin e hadithit dhe shikimit të së vërtetës, duke bërë obligim zekatin e të gjitha kulturave bujqësore, pavarësisht se a janë ushqyese apo jo, sa a janë të tilla që deponohen apo jo, etj.”⁹

Ajeti në të cilin Zoti xh.sh., e ka bërë obligim dhënien e zekatit në të gjitha kulturat bujqësore është: “...*Hani prej frutave të tyre (kulturave bujqësore) kurdo që të prodhojnë, dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre...*!” Përmendja e disa produkteve për të cilat duhet të dhurohet zekati, nuk përjashton obligueshmërinë e atyre që nuk janë theksuar, veçanërisht kur ajeti e përfshinë çdo kulturë bujqësore. Prej fjalës ‘حَقَّة’ d.m.th. të drejtën e tokës - jo të



fitimit - që nënkupton se është obligim dhënia e zekatit nga tërë ajo që e keni vjelë.¹⁰

Vlen të shënohet edhe që pjesa e ajetit: *“...Hani prej frutave të tyre (kulturave bujqësore) kurdo që të prodhojnë, dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre...!”*, i cili obligon zekatin e asaj që është vjelë, jo të asaj që është ngrënë para vjeljes,¹¹ që rezultojnë se kopshtet e vogla familjare, janë të liruara nga zekati përmes pjesës së parë të këtij ajeti, prej të cilave zakonisht ushqehen njerëzit gjatë dhe pas vjeljes.

Harmonizimi apo kuptimi i hadithit duket përmes klasifikimit me normën juridike në proporcion me fuqinë e tyre argumentuese, respektivisht duke anashkaluar atakimin me ajetin. Pranon hadithin, por e rangon në një shkallë apo normë më të vogël sesa ajeti.

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Nuk ka namaz për atë që nuk e ka lexuar (në namaz) suren Fatiha, elhamin.”¹² Kurse Zoti xh.sh. në Kuran thotë: *“Lexoni në namaz, atë që ju vije më së lehti prej Kuranit.”* (El Muzemil, 20).

Nga ajeti kuptohet se leximi i një pjesë të Kuranit në namaz është farz – obligim, këtë e përshkruan tekstualisht ajeti, nuk ka namaz pa Kuran, duke mos e përzgjedhur ndonjë pjesë. Kjo është minimalja e leximit, e cila është kusht i namazit.

Por, gjithashtu edhe hadithi obligon leximin i Fatihasë, duke e specifikuar atë, andaj Fatiha është vaxhib, gjithashtu obligim, por nuk është e fuqisë së ajetit për leximin e një pjesë nga Kurani. Andaj, leximi i një pjesë të Kuranit në namaz është obligim dhe kusht pa të cilën nuk pranohet namazi. Por edhe Fatiha është obligim, megjithatë, pranohet namazi edhe pa të.¹³

Kjo formë e harmonizimit apo shpjegimit të haditheve, duke i klasifikuar apo ranguar hadithet me kategori të ndryshme të normave juridike, varësisht prej fuqisë së tyre, është metodë e njohur te dijetarët, veçanërisht në medhhebin

hanefi. Prandaj, harmonizimi i të gjitha teksteve të cilat duken kontradiktore sipërfaqësisht, qofshin ato juridike apo të tjera, në fund të fundit duhet t'i referohen Kurani famëlartë e të përputhen me kuptimësitë e pakontestueshme të tij.

- 1 Ebu Davud, Sulejman bin el Eshath bin Is'hak bin Beshir, Sunen Ebu Davud, recensoi: Muhamed Kamil Kurrah, nën mentorimin e Shejh Shuajb el Arnautit, (Bejrut, Dar Errisaleh el Alemije, 2009), vëll.7, f.28. Hadithi i saktë, nr. 4604.
- 2 El Bagdadi, Ahmed bin Alij bin Thabit bin Ahmed, El Kifajetu fi Ilmi Errivajeh, recensoi: Ebu Abdullah, Ibrahim Hamdi (Arabia Saudite, Medine, El Mektebetu el Ilmijeh), vëll. 1, f.432.
- 3 El Mukrij, Hibetullah bin Selam bin Naser bin Ali, En Nasih ve El Mensuh, recensoi: Zuvej Eshevish dhe Muhamed Kenan, (Liban, Bejrut, El Mektebu el Islami, 1404 h.) vëll.1, f. 26.
- 4 Mund të quhet edhe hadithet kontradiktore, që vijnë në kontekste, që në shikim të parë duken të ndryshme.
- 5 Ibën ebi el Iz el Hanefij, Sadrudin Muhamed bin Alaiddin, Sherh El Akideh Et Tahavijeh, recensoi: Abdullah el Hasen et Trurkij, nën mentorimin e shejh Shuajb Arnautit, (Liban, Bejrut, Mesesetu Errisaleh, 1997) vëll.1, f.227.
- 6 Referenca paraprake, vëll.1, f.231.
- 7 Imam Muslimi bin el Haxhaxhi, Ebu el Hasan el Kushejri, Sahihu i Muslimit, recensent: Muhamed Abdulbaki, (Liban, Bejrut, Ihjau et Turath, 1954), nr. 979, vëll. 2, f. 674.
- 8 Ibën Kudameh, Ebu Muhamed Mu'afakudin Abdullah bin Ahmed bin Muhamed, El Mugnij li Ibën Kudameh, (Mektebetu el Kahira, 1968) vëll.3, f.4.
- 9 Ibën El Arabij, Gjykatësi: Muhamed bin Abdullah bin Ebu Beker, El Meselik fi Sherh Muvata Malik, (Tunis, Dar el Garb el Islami, 2007), vëll.1, f.17.
- 10 Imam Ebu Beker exh Xhesas, Ahmed bin Alij, Sherh Muhtesar et Tahavi, recensent i dr. Said Bektash, (Arabia Saudite, Medineh, El Beshair el Islamiye dhe Es Serraxh, 2010), vëll.2, f.288.
- 11 Ebu Mensur Eel Maturidiu, Muahmed bin Muhamed bin Mahmud, Tefsir el Maturidi (Tevilat Ehl es Suneh), recensoi: dr. Mexhdi Baslumi, (Liban, Bejrut, Dar el Kutub el Ilmije, 2005), vëll.4, f. 284.
- 12 Imam Buhariu, Muhamed bin Ismail, Sahihun i Buariut, recensent Muhamed Zuhejr bin Nasir en Nasir, (Turuk en Nexhah, 1422 h.) nr. 756 vëll. 1, f. 151.
- 13 Es Serahsiju, Muhamed bin Ahmed bin ebi Sehel, El Mabsut, (Liban, Bejrut, Dar el Marife, 1993), vëll. 1, f.19.

Formimi i xhematit të dytë në të njëjtën xhami për faljen e namazit që tashmë është falur njëherë

Myfti Ebrahim Desai

Nëse dikush nga xhemati dëshiron që të formojë një xhemat të dytë dhe insistojnë që ti t'u bëhesh imam, sqaroju atyre pozicionin hanefit rreth kësaj çështjeje. Megjithatë, nëse mund të lind ndonjë keqkuptim, atëherë mund t'i bashkohesh xhematit të dytë ose t'u bëhesh imam, pra ke një liri për këtë gjë.

Pyetja: *Sipas medhhebit hanefi, nuk lejohet që të formohet xhemat i dytë brenda xhamisë, por nëse është formuar xhemati i dytë, a më lejohet që t'i bashkëngjitëm atij, apo ta fali namazin vetëm?!, si dhe nëse namazfalësit (e xhematit të dytë) insistojnë që unë të dal imam, atëherë çfarë më duhet të bëj?!*

PËRGJIGJJA:

Bismi'l-lahi'rr-Rrahmani'rr-Rrahim

Sa i përket formimit të xhematit të dytë, ekzistojnë disa rrethana, ku normat e tyre janë të ndryshme. Ato janë si më poshtë:

1. Mesxhidi Tariki (lit. xhamia e rrugës). Me fjalë të tjera, xhamia që shfrytëzohet nga udhëtarët dhe e cila nuk ka ndonjë imam të caktuar dhe grup të njohur njerëzish që falen rregullisht aty.

2. Xhamia që nuk ka ndonjë imam dhe myezin të caktuar.

3. Në xhaminë e një lokaliteti, njerëz (xhematli) të tjerë nga ata të vendit e kanë formuar xhematin e parë.

4. Në xhaminë e një lokaliteti, vendasit e kanë formuar xhematin e parë dhe e kanë falur namazin pa ezan, d.m.th., nuk e kanë thirrur atë.

(Norma në lidhje me këto katër rrethanat e shënuara më lartë, është se jo vetëm që lejohet formimi i xhematit të dytë, por në fakt, është më e mira të veprohet një gjë e tillë. Shënim: Xhami e një lokaliteti, do të thotë, xhami që

ka një imam të caktuar dhe xhematli të njohur, të përditshëm.)

5. Në xhaminë e një lokaliteti, vendasit e kanë formuar xhematin e parë, duke e falur namazin me ezan, e edhe xhemati i dytë gjithashtu e kanë falur namazin me ezan (të tyrin).

6) Në xhaminë e një lokaliteti, vendasit e kanë formuar xhematin e parë dhe e kanë falur namazin me ezan, kurse xhemati i dytë e falë namazin pa ezan, por imami (i xhematit të dytë) qëndron në mes të rreshtit (safit) të xhamisë ose të korridorit të xhamisë, qoftë në safin e parë, qoftë në të fundit ose diku në mes këtyre dyve. Me fjalë të tjera, qëndrimi në mes të safit (rreshtit) nënkupton të qëndrosh në ose paralel me mihrabin (meqë mihrabi është në mes të xhamisë).

Norma në lidhje me dy rastet e lartpërmendura është se formimi i xhematit të tillë të dytë është mekruh tahrir (d.m.th., e palejuar, pra afër haramit). Ta kemi parasysh se në rastin në numrin gjashtë, norma e njëjtë vlen qoftë nëse formohet xhemat i dytë për namaz brenda xhamisë ose jashtë saj, bie fjala në korridorin e saj, d.m.th., nëse imami qëndron paralel me mihrabin (d.m.th., në mes të safit), një gjë e tillë është mekruh tahririmi, pra e palejuar (këtu theksojmë, a thua çfarë qenka nëse e falim sërish të njëjtin namaz direkt në mihrab?! – shën. i përkth.).

7. Në xhaminë e një lokaliteti, vendasit e kanë formuar xhematin e parë dhe janë falur me ezan, kurse xhemati i dytë formohet dhe



faleit pa ezan e imami nuk qëndron në mes të safit (rreshtit) të xhamisë ose jashtë saj, d.m.th., imami nuk qëndron në ose paralel me mihrabin. Me fjalë të tjera, imami i xhematit të dytë qëndron ose në anën e djathtë ose të majtë të xhamisë ose bie fjala të korridorit të saj.

Për këtë rast, ekziston dallimi në mendime (ka ihtilaf), është fjala për rastin e shtatë. Sipas mendimit më të fuqishëm, është mekruh tenzihi (e papëlqyeshme) të formohet xhemat i dytë. Mendimi tjetër është se lejohet një gjë e tillë. Megjithatë, për diçka ka pajtueshmëri, se sipas dyja mendimeve, nuk fitohen sevabe (nuk ka shpërblim) në formimin e xhematit të dytë. Njëherë Pejgamberi a.s. ishte diku për t'i pajtuar ca njerëz. Kur u kthye në xhami, xhemati vetëm se e kishin falur namazin. Pejgamberi a.s. shkoi në shtëpinë e vet dhe i tuboi anëtarët e familjes dhe e fali namazin me ta. Nëse do të kishte shpërblim në formimin e xhematit të dytë në xhami, Pejgamberi a.s. nuk do ta linte një gjë të tillë, sidomos në xhaminë e tij, ku shpërblimi shumëfishohet. Gjithashtu, dijetarët islamë, kanë numëruar shumë pasoja negative në lejimin e formimit të xhematit të dytë. Prandaj, duhet larguar totalisht nga formimi i xhematit të dytë në këtë rrethanë.¹

Tani, duke pasur parasysh normat dhe rregullat e lartpërmendura, le t'i kthehemi pyetjes tënde specifike:

Nëse nuk e ke zënë namazin me xhematin e vërtetë, atëherë në katër rastet e para të përmendura më lartë, bashkoju xhematit.

Mund të bëhesh edhe imam. Në rastin e pestë, të gjashtë dhe të shtatë, mos ju bashko xhematit të dytë, lëre më të bëhesh imam. Në vend të kësaj, mund të veprosh kështu:

- Mundohu të zësh namazin (xhematin duke u falur) në ndonjë xhami tjetër, nëse ke mundësi;
- Mund ta falësh namazin individualisht në të njëjtën xhami;
- Mund ta grumbullosh familjen tënde dhe ta falësh namazin me ta, në xhemat.

Nëse dikush nga xhemati dëshiron që të formojë një xhemat të dytë dhe insistojnë që ti t'u bëhesh imam, sqaroju atyre pozicionin hanefit rreth kësaj çështjeje. Megjithatë, nëse mund të lind ndonjë keqkuptim, atëherë mund t'i bashkohesh xhematit të dytë ose t'u bëhesh imam, pra ke një liri për këtë gjë. Kjo vjen në konsideratë vetëm nëse nuk thirret ezan për xhematin e dytë dhe imami nuk qëndron në ose paralel me mihrabin (d.m.th., në mes të safit), qoftë brenda në xhami ose në korridoret e saj.

E Allahu i Gjithëdijsëm e di më së miri!

(Fetva e kontrolluar dhe e aprovuar nga myftiu i njohur: Myfti Ebrahim Desai, Allahu i Madhërishëm e mëshiroftë!)

Përktheu: Daim Abazi

Imami i xhematit të dytë qëndron ose në anën e djathtë ose të majtë të xhamisë ose në korridorin e saj.

¹ Shih: Ahsenu'l-Fetava, vol. 3, f. 322-328, pastaj shih: Imdatu'l-Fetava, vol.1, f. 295-302, Mektebe Daru'l-Ulum, Karaçi, pastaj edhe: Kifajetu'l-Mufti, vol. 3, f. 148.

Edukimi si mision i (pa) përmbushur nga institucionet e Kosovës

Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi

“Edukimi është procesi me anë të të cilit individi fiton kapacitetet e shumta fizike, morale shoqërore që kërkohen prej tij/saj nga grupi në të cilin ai/ajo ka lindur dhe brenda të cilit ai/ajo duhet të funksionojë.

“Arsimi është arma më e fuqishme që mund të përdoret për ta ndryshuar botën”
– Nelson Mandela

Edukimi si proces është i rëndësishëm për zhvillimin e njeriut si qenie. Ai konsiderohet si agjens i socializimit përmes së cilit njeriu ngritët në piedestalet më të larta të shoqërisë. Me fjalë të tjera, mund të nënvizohet se “edukimi është procesi me anë të të cilit individi fiton kapacitetet e shumta fizike, morale shoqërore që kërkohen prej tij/saj nga grupi në të cilin ai/ajo ka lindur dhe brenda të cilit ai/ajo duhet të funksionojë. Ky proces është përshkruar nga sociologët si socializim”.¹ Zakonisht, kur flitet për edukimin, studiuesit e kësaj fushe atë e ndajnë në dy forma kryesore: edukimi formal dhe edukimi jo formal. I pari ka të bëjë me shumë me arritjet e nevojshme për jetën dhe mjedisin që na rrethon dhe është i domosdoshëm për tregun e punës. Ndërsa, i dyti ka të bëjë me shumë me procesin e edukimit gjatë gjithë jetës, qoftë përmes përvojave të ndryshme apo trajnimeve formale dhe jo formale, që ndryshe njihet edhe si ‘soft skills/shkathësi të buta’. Sot, shtetet e zhvilluara konsiderohen ato shtete të cilat kanë edukimin cilësor dhe janë pothuajse në piedestalet më të larta të shteteve të zhvilluara. Raporti anketon mijëra njerëz në 78 vende, më pas i rendit ato vende bazuar në përgjigjet e sondazhit. Sipas këtij raporti, vendet me sistemet më të mira arsimore - qytetarët globalë për të drejtat e njeriut 2020 janë: Danimarka, Finlanda, Japonia, Kanada, Suedia, Gjermania, Izraeli, Holanda, Singapori dhe Koreja e Jugut.² Këto fakte

njëherësh tregojnë edhe për pozicionin e këtyre shteteve në sfondin global.

Sido që të jetë, edukimi si komponentë është e rëndësishme edhe për Bashkimin Evropian, megjithëse ende nuk ka një politikë arsimore uniforme. Asnjë institucion i lartë nuk ndërhyt apo vendos kërkesa specifike në lidhje me arsimin në këto vende. Çdo vend është plotësisht përgjegjës për sistemin e tij arsimor dhe kurrikulën. Kështu, arsimi mund të duket krejtësisht ndryshe në këto vende. Megjithëse Bashkimi Evropian mbështet arsimin, edhe me subvencione për projekte apo udhëtime të studentëve të talentuar, ai nuk ndërhyt në vetë sistemin arsimor. Gjithashtu, zhvillimi i mësimdhënies është ndërmarrë nga UNESCO, Këshilli i Evropës, si dhe Kombet e Bashkuara (veçanërisht sektori i Arsimit, Shkencës dhe Kulturës).³ Bazuar nga kjo, del se secili shtet ka specifikat e tij dhe në këtë mënyrë edhe e organizojnë çështjen dhe sistemin e arsimit në shtetet e tyre. Në rastin e Kosovës, që nga viti 1999 e këtej, ka pasur një mori të reformave në sfondin e arsimit, progres, por edhe sfida të natyrave të ndryshme, të cilat e kanë përcjell Kosovën deri më tani, që nga infrastruktura e deri te rritja/ulja e numrit të nxënësve, pika kyçe për të cilat do të flasim më poshtë.

EDUKIMI NË KOSOVË, ORGANIZIMI, PROBLEMET DHE SFIDAT

Arsimi sot konsiderohet si një proces i lehtësimit të nxënies. Arsimimi shpesh zhvillohet nën drejtimin e edukatorëve, por nxënësit mund ta edukojnë veten edhe në procese të tjera të njohura ndryshe si të mësuarit “auto-



didakt”⁴ Ai si proces ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e individit. Duke parë këtë rol me rëndësi, institucionet e vendit, menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë, kanë filluar disa reforma me qëllim të zhvillimit të tij konform nevojave të tregut. Por, si rezultat i periudhës së tranzicionit, problemeve të natyrës socio – ekonomike, sfidave politike dhe integruese në vend, por edhe ndryshimet e shpeshta në qeveri, këto reforma, nuk kanë prodhuar ndonjë efekt. Sido që të jetë, disa studime kanë treguar se etapat e organizimit të arsimit në Kosovë janë:

Etapat e parë (1944 – 1966). Sistem arsimor socialist me përfshirje gjithë popullore për zhdukjen e analfabetizmit. Mësimi teorik me bazë ideologjinë komuniste. Forcimi i besimit në socializëm dhe vëllazërim – bashkim si rend politik e ekonomik Jugosllav. Në Kosovë orientimet programore të arsimit çonin deri në përfundimin e një shkolle të mesme gjimnaz apo normale dhe në vitin 1958 themelohet Shkolla e parë e Lartë Pedagogjike dhe më 1960 Fakulteti Filozofik në Prishtinë.

Etapat e dytë (1966 – 1980). Shënohet një demokratizim i sistemit të arsimit dhe konsolidimi i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet. Fillojnë punën edhe shkollat e mesme profesionale apo prodhuese, por nuk investojnë në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, ku 91% e buxhetit arsimor u dedikohet vetëm pagave.

Etapat e tretë (1981 – 1991). Rikthimi i ndikimit të politikës në arsim, humbja e orientimit arsimor të institucioneve, ndjekja dhe përjashtimi nga puna i ekspertëve dhe mësimdhënësve, zbatimi i politikës antiarsimore dhe antinjerëzore të pushtetit serb.

Etapat e katërt (1991 – 1999). Krijimi i sistemit të pavarur demokratik arsimor dhe ruajtjen e vazhdimësisë së punës së institucioneve arsimore dhe procesit arsimor nën okupim. Zhvillimi i plan programeve dhe botimi i teksteve mësimore të reja pa ndikime ideologjike dhe politike dhe me platformë të arsimit kombëtar dhe vazhdimi i shkollimit në “Shtëpitë Shkolle”.

Etapat e pestë (1999 e deri sot). Reformimi i plotë i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare. Zbatimi i metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies, të bazuara në standarde dhe objektiva mësimore. Zgjerimi i sistemit të arsimit të obligueshëm për një klasë dhe organizimi i arsimit privat si alternativë dhe konkurrues në zhvillimin e arsimit në Kosovë.⁵

Kosova, aktualisht ka një sistem të arsimit në bazë të formulës 5+4+3, e cila në fakt fillon qysh në moshën 6 vjeçare, megjithëse në të kaluarën ky sistem ka funksionuar sipas formulës 4+4+4 dhe sistemi ka ndryshuar me qëllim që Kosova të jetë në përputhje me sistemet e shteteve të Bashkimit Evropian, megjithëse secili shtet në BE ka specifikat e tij sa i përket strukturës dhe organizimit. Ndërsa, struktura aktuale e arsimit në Kosovë është:

Arsimi parashkollor (fëmijë të moshës < 6-vjeçare);

Arsimi fillor (klasat 1-5, fëmijë të moshës 6 – 10-vjeçare);

Arsimi i mesëm i ulët (klasat 6-9, fëmijë të moshës 11 – 14-vjeçare);

Arsimi i mesëm i lartë (klasat 10-12, fëmijë të moshës 15 – 18- vjeçare);

Arsimi i lartë.

Së fundi, institucionet e vendit kanë aprovuar edhe Ligjin për edukimin në fëmijërinë e hershme, i cili përveç tjerash, ka për qëllim ofrimin e edukimit cilësor gjithëpërfshirës në të gjitha format e organizimit të kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme për fëmijët prej lindjes deri në moshën 6 vjeçare, si dhe përcakton normat për organizimin, funksionimin, mbikëqyrjen, përgjegjësitë institucionale dhe profesionale të të gjithë akterëve për edukimin në fëmijërinë e hershme.⁶ Është miratuar legjislacioni për arsimin përfshirë këtu: ligjin parauniversitar, ligjin për arsimin në komuna, ligji për vetëqeverisje lokale, ligje e akte të tjera nënligjore. Gjithashtu, të një rëndësie të veçantë janë edhe hartimi i dokumenteve strategjike, fillimisht Plani Strategjik për Arsim 2017-2021, pastaj edhe Strategjia dhe Plani i Arsimit 2022 – 2026, të cilat kanë objektiva të caktuara, si dhe kurrikulat me të cilat punojnë institucionet e arsimit në Kosovë (kurrikula bazë dhe bërthamë).

Të dhënat tregojnë se deri më tani është investuar edhe në infrastrukturën e objekteve shkollore, sidomos në arsimin parauniversitar, ku këto të dhëna tregojnë se vit pas vit janë shënuar ndërtime të objekteve shkollore dhe rinovime nga institucionet e vendit. Të dhënat statistikore për vitin 2022-2023 nënvizojnë se në 38 komuna gjithsej janë 54 institucione parashkolllore/çerdhe, institucione edukative-arsimore filllore dhe të mesme të ulëta 869, institucione edukative – arsimore mesëm lartë 121 ose gjithsej 1,044. Këto të dhëna në përqindje janë shprehur, si vijon: institucione parashkolllore 5.2%, filllore dhe të mesme të ulëta 83.2% dhe mesme të larta 11.6%.⁷ Sistemi ka filluar edhe reformën e dixhitalizimit dhe është krijuar portali 'e-shkollori', e cila si platformë mundëson që prindërit të kenë një pasqyrë më të mirë për fëmijët e tyre dhe një raport objektiv të mësimdhënësve për performancën e fëmijëve, si dhe projekte të tjera të cilat janë duke u implementuar. Një çështje tejet e rëndësishme është edhe licencimi i mësimdhënësve në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të tyre dhe ri-licencimi brenda një periudhe 3, respektivisht 5 vjeçare. Kjo është edhe njëra anë e medaljes së kronologjisë ecures së arsimit në Kosovë. Ana tjetër e medaljes, tregon edhe shumë defekte dhe probleme të konsiderueshme në këtë sferë. Ndoshta ngritë hipoteza se vërtet a është edukimi një mision i pa (përmbushur) i institucioneve të Kosovës apo jo? Një pyetje e cila meriton një vëmendje më të thellë dhe atë shumëdimensionale. Në fakt, sistemi i arsimit në vazhdimësi është përcjellë edhe me një

Një çështje tejet e rëndësishme është edhe licencimi i mësimdhënësve në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të tyre dhe ri-licencimi brenda një periudhe 3, respektivisht 5 vjeçare.

mori të sfidave të natyrave të ndryshme, të cilat kanë prodhuar efekte serioze në shoqëri, përfshirë këtu edhe arsimin parauniversitar, por edhe atë universitar. Janë dy çështje që duhet nënvizuar këtu: Së pari, janë krijuar institucione të arsimit të lartë (universitar) Kolegje dhe Universitete Publike pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë vlerësimi konform nevojave dhe kërkesave të tregut të punës. Së dyti, në kuadër të arsimit parauniversitar, ky sistem është ballafaquar me probleme të theksuara përfshirë: mungesën e pajisjeve të teknologjisë informative, respektivisht laboratorëve të fushave konkrete, pastaj moshimin e mësimdhënësve, mungesën e ndryshimit të metodave të të mësuarit dhe rezultateve të të nxënit, dixhitalizimin e të gjitha shkollave në Kosovë, mungesën e projekteve konkrete, mungesën e decentralizimit të buxhetit sipas shkollave ose kjo ka ndodhur pjesërisht dhe atë varësisht nga profilet partiake në komuna, mos prioritizimi i arsimit si 'objektiv nacionale' nga institucionet e vendit, mungesa e profileve të këshilltarëve social në shkolla, si dhe shumë

probleme të tjera. Të gjitha këto në një ose tjetrën mënyrë kanë ndikuar edhe në rezultatet e nxënësve, sidomos në aspektin rajonal dhe atë global, duke e renditur Kosovën si një ndër vendet e fundit në rezultatet e PISA-së (Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve), i cili është një studim ndërkombëtar që filloi qysh në vitin 2000.

Sa i përket këtij programi, ky program synon të vlerësojë sistemet arsimore në mbarë botën duke testuar aftësitë dhe njohuritë e studentëve 15-vjeçarë në vendet/ekonomitë pjesëmarrëse. Që nga viti 2000, mbi 70 vende dhe ekonomi kanë marrë pjesë në PISA. Çdo tre vjet, një grup pesëmbëdhjetëvjeçarësh të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme bëjnë teste në lëndët kyçe – lexim, matematikë dhe shkencë – me fokus të caktuar në një lëndë në çdo vit vlerësimi. Fokusi ishte leximi në vitin 2000, matematika në 2003, shkenca në 2006 dhe leximi përsëri në 2009. Përgatitjet për vlerësimin e ardhshëm në 2012 janë në rrugë të mbarë dhe ka filluar planifikimi për vlerësimin PISA 2015. Kosova mori pjesë për herë të dytë në këtë test në vitin 2018 ndërsa në PISA-n e vitit 2015 ishte renditur po ashtu e treta nga fundi në tabelë, atëherë në mesin e 72 shteteve dhe në vitin 2022 kishte marr pjesë, por që rezultatet janë publikuar në dhjetor të vitit 2023. Në vitin 2018, Kosova "në fushën e leximit është renditur e katërta nga fundi, në matematikë e pesta nga fundi dhe në shkencë nga fundi. Sipas rezultateve që maten me indeksin e mesatares së OECD, nxënësit kosovarë kanë arritur 353 pikë në lexim, 366

në matematikë dhe 365 në shkencë. Krahasuar me rezultatet e vitit 2015, vërehet një rritje në lexim dhe matematikë, ndërsa ka rënie në shkencë. Në testin PISA 2015, nxënësit kishin marrë 347 pikë në lexim, 362 në matematikë dhe 378 në shkencë.⁸ Ndërsa, në vitin 2022 që është publikuar tani, del se Kosova “është në vendin e 74 nga 80 vende pjesëmarrëse, me 11 pikë më pak krahasuar me vitin 2018. Dallimet gjinore në matematikë në Kosovë nuk ka, 355 pikë vajzat, 355 pikë djemtë. Në lexim, Kosova është e 76-ta nga 80 vendet pjesëmarrëse, me 342 pikë. Në shkencë, Kosova renditet e 77-ta nga 80 vende pjesëmarrëse, me 357 pikë, në këtë fushë ka rënie më të ulët për 6 pikë krahasuar me vitin 2018. Në lexim, në të gjitha vendet vajzat kanë performuar më mirë sesa djemtë. Në shumicën e shteteve vajzat kanë performuar më mirë edhe në shkencë. %20 e nxënësve kosovarë, sipas testit ‘PISA’ kanë arrit nivelin e kënaqshëm, kurse të tjerët janë nën nivelin e kënaqshmërisë. PISA 2022 ka qenë cikli i tretë për Kosovën, teksa fushë kryesore ka qenë matematika dhe në të kanë marrë pjesë 6027 nxënës 229 shkolla. Rënia më e madhe e Kosovës në rezultatet PISA është që nga viti 2018.⁹

PROBLEMET, SFIDAT DHE ORIENTIMET E SË ARDHMES

Rezultatet të cilat janë pasqyruar çdo tri vjet dhe renditja e Kosovës pothuajse e fundit në këtë program, japin sinjal se arsimi në Kosovë ka shënuar një stagnim dhe kjo padyshim se ndërlikohet ngushtë me një mori të faktorëve: Së pari, mungesa e një politike të mirëfilltë publike, e cila do të prioritzonte arsimin si ‘top prioritet’ nacional për gjeneratat e së ardhmes. Në kuadër të kësaj hyn edhe mungesa e analizës

për kërkesat e profileve të rinjve konform nevojave të tregut të punës. Së dyti, infrastruktura e objekteve dhe pajisjet teknologjike, ku shpeshherë një pjesë e shkollave kanë poseduar një pjesë të pajisjeve të tilla, kurse pjesa tjetër jo. Ndërsa, objektet shkollore janë ndërtuar vend e pa vend, pa ndonjë planifikim, sa që në disa komuna ekzistojnë shkolla të mëdha me pak nxënës dhe shkolla të vogla në kuptimin e hapësirës me shumë nxënës. Së treti, roli i mësimdhënësve, i cili është krusial në edukimin dhe zhvillimin e nxënësve. Ky fakt tregon se mësimdhënësit janë duke shkuar drejt plakjes dhe migrimit. Një pjesë tjetër e tyre shpeshherë përdorin metoda mekanike të të nxënësve, pavarësisht faktit që kurrikulat tregojnë se duhet bërë kombinime të metodave. Gjithashtu, në këtë kontekst bëjnë pjesë edhe trajnimet e ndryshme, të cilat i përfundojnë mësimdhënësit, që në pjesën më të madhe të rasteve trajnimet bëhen vetëm sa për të plotësuar numrin e kreditëve për licencim dhe ri-licencim, por jo edhe për ndarjen e përvojave, krijimin e ALUMNIVE apo edhe bartjen/zëvendësimin e mësimdhënësve në një ose tjetër institucion shkollos me qëllim të shkëmbimit të ideve dhe përvojave të ngjashme. Së katërti, migrimet dhe braktisja e shkollimit, të cilat janë sfida goxha serioze që kanë kapluar jo vetëm Kosovën, por pothuajse të gjithë globin. Ky fakt ka bërë që si rezultat i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, numri i nxënësve, mësimdhënësve, por edhe i studentëve vit pas viti të bie dhe një gjë e tillë do të rrezikonte dukshëm edhe numrin e mësimdhënësve, gjë që MASHT-i, së bashku me institucionet e tjera duhet t’i analizoj këto fakte. Të dhënat nga MASHT-i sipas viteve të fundit flasin më së miri për këto fakte, si vijon:

Mësimdhënësit sipas niveleve në 38 komuna									
Viti	Parashkollor			Parafillor dhe i mesëm i ulët			I mesëm i lartë		
	M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej
2020/21	2	586	588	7,020	10,333	17,353	2,976	2,256	5,232
2021/22	2	609	611	6,557	10,654	17,211	2,911	2,300	5,211
2022/23	2	647	649	6,503	10,596	17,099	2,973	2,272	5,145
Diferenca	/	+39	+61	-517	+263	-254	-3	+16	-87

Tabela 1: Mësimdhënësit sipas niveleve në 38 komuna sipas viteve⁹⁰

Numri i nxënësve sipas moshave/klasave (Klasa 1 deri 13)			
Viti	M	F	Gjithsej
2020/2021	163,961	154,885	318,846
2021/2022	159,595	149,951	309,546
2022/2023	153,798	148,566	300,362
Diferenca	-10,163	-6,319	-18,484

Tabela 2: Mësimdhënësit sipas niveleve në 38 komuna sipas viteve⁹¹

Bazuar nga këto tabela, mund të shohim se ekziston një diferencë në mes të vitit 2020 – 2023 për sa i përket rënies së mësimdhënësve. Në nivel fillor ka pasur ngritje të mësimdhënësve prej +61, ndërsa në nivelin parafillor dhe të mesëm të ulët ka rënie në -254 dhe në nivelin e mesëm me -87 mësimdhënës. E njëjta situatë është edhe me nxënësit e klasave nga niveli 1 deri në nivelin ose klasën 13. Diferenca ndërmjet vitit 2020 dhe 2023 është -18,484 nxënës, të cilët për shumë arsye janë larguar, respektivisht kanë migruar nga shteti. Së pesti, mungesën e profileve të këshilltarëve social, e cila prek dukshëm shkollat në Kosovë, duke bërë që të shpërfaqen një mori e dukurive sociale dhe sjelljeve devijante, të cilat më parë ose kanë qenë të hermetizuara ose kanë qenë latente. Sot, në institucionet shkollare në Kosovë vërehet qartë mungesa e profilit të psikologëve dhe sociologëve, besa edhe të punonjësve social. Madje, në shumë raste një psikolog/e luan rolin e këshilltarit social në më shumë se dy shkolla, gjë që paraqet ngarkesë edhe për të, por edhe nuk ka ndonjë efikasitet dhe efektivitet. Sociologët dhe punëtorët social nuk përfillen dhe vetëm në raste të caktuara kërkohet mendimi/opinion i tyre. Së gjashti, problemet me tekstet shkollare – janë probleme që çdoherë e kanë përcjellë arsimin në Kosovë. Këto probleme ndërlihen ngushtë me mungesën e teksteve të mirëfillta pedagogjike dhe teksteve të cilat kanë tematike, e të cilat janë në interes të fëmijëve dhe janë bashkëkohore. Shembull shumë tekste shkollare janë të mbushura me stereotipizimin e njëres ose tjetres gjini, ngërthejnë mizogjini, madje në to ka edhe diskriminim dhe herë pas here edhe nuanca të bullizmit apo të dhunës. Ato zakonisht kanë dizajne ose janë tepër të ngarkuar ose të varfër dhe struktura e tyre, pavarësisht faktit që ka edhe tekste të mira, një pjesë goxha e madhe e tyre ka një strukturë boshe, pa ndonjë analizë, pa ndonjë ide për zhvillimin e mendimit analitik dhe kritik.

Bazuar nga ajo që kemi thënë deri më tani, mund të arrijmë në përfundim se, sa i përket ecurisë së arsimit në Kosovë, janë shënuar një mori i hapave të proceseve kyçe, duke përfshirë edhe anëtarësimin e Kosovës në disa mekanizma ndërkombëtar, aspekti ligjor, infrastrukturor, si dhe aspekte të tjera të rëndësishme. Por, në anën tjetër, kemi parë që shteti i Kosovës që tri herë radhazi klasifikohet në vendet e fundit, shumë më larg se vendet si Ukraina dhe Palestina, vende këto të cilat kanë probleme me konflikte. Prandaj, institucionet e vendit duhet paraprakisht të kenë prioritet arsimin dhe përmes projekteve të krijojnë programe konkrete konform nevojave të tregut të punës. Gjithashtu, e rëndësishme është ridizajnimi i infrastrukturës konform hapësirës së nxënësve dhe nevojave për nxënës, njëjtë sikurse në vendet e BE-së, e jo disa shkolla të ketë mbi 5 nxënës e në disa numrin i tyre të jetë +60, pra të bëhet një ridizajnim me plan konkret. Një çështje e rëndësishme është fakti i ndryshimit të teksteve

shkollare, puna e mësimdhënësve me nxënës jashtë-kurrikulare, instalimi i programeve bashkëkohore sidomos në fushën e TIK-ut, puna me nxënës në grupe të vogla, të mesme dhe të mëdha, aktivitetet jashtë shkollës, komunikimi dhe bashkëpunimi me këshillin prindëror, fokusi më i madh i nivelit lokal në decentralizim të buxhetit, ndryshimi metodave të mësimdhënësve krahas ndryshimeve dhe zhvillimeve sociale, fuqizimi i profileve sociale në shkolla si: psikologët, sociologët, punëtorët social, e të tjera.

Literatura/burimet

1. A Gary Dworkin, at al: "The sociology of education", (part of book), McMilan, 2014.
2. Dewey, John: "Democracy and Education", 1994, The Free Press.
3. Ligji Nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, neni 1.
4. Maliqi, Muhabere & Kamberi, Ferdi: "Reformat e Arsimit në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët dhe integrimi i komuniteteve jo shumicë në Kosovë", REFORMA, Gjiilan, 2015.
5. MASHTI: "Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/21", MASHTI, Prishtinë, 2021.
6. MASHTI: "Statistikat e Arsimit në Kosovë 2021/22", MASHTI, Prishtinë, 2022.
7. MASHTI: "Statistikat e Arsimit në Kosovë 2022/23", MASHTI, Prishtinë, 2023.
8. Subrata S Satapathy: "Sociology of Education", MA, Sociology, Paper No 16, India, Institutional programmes, National Educational policy 1986.
9. Education Rankings by Country 2023: "Countries with the Best Educational Systems - 2021 Best Countries Report*", shih: <https://worldpopulationreview.com/country-rankings/education-rankings-by-country>, qasur në muajin Dhjetor, 2023.
10. Indeksionale: "Rezultatet e PISA 2018 të pritshme, MASHT fajtor për dështim", Indeksionline, <https://indeksonline.net/%E2%80%8BRezultatet-e-pisa-2018-te-pritshme-masht-fajtor-per-deshtim/>, qasur në Dhjetor, 2023.
11. Our Kids: "Education in five European countries", shih: <https://www.ourkids.net/pl-en/education-european-countries.php#maincontent>, qasur në muajin Dhjetor, 2023.
12. Xhema, Shqipron & Uka, Arbrita: "Kosova me rezultate të ulëta në testin 'PISA', Nagavci arsyeton statistikën", artikull i botuar në: <https://kallxo.com/lajm/kosova-me-rezultate-te-uleta-ne-testin-pisa-nagavci-arsyeton-statistikat/>, qasur në Dhjetor, 2023.
13. Subrata S Satapathy: "Sociology of Education", MA, Sociology, Paper No 16, India, Institutional programmes,
14. National Educational policy 1986, fq. 7.
15. Education Rankings by Country 2023: "Countries with the Best Educational Systems - 2021 Best Countries Report*", shih: <https://worldpopulationreview.com/country-rankings/education-rankings-by-country>, qasur në muajin Dhjetor, 2023.
16. Our Kids: "Education in five European countries", shih: <https://www.ourkids.net/pl-en/education-european-countries.php#maincontent>, qasur në muajin Dhjetor, 2023.
17. Dewey, John: "Democracy and Education", 1994, The Free Press, fq. 4.
18. Maliqi, Muhabere & Kamberi, Ferdi: "Reformat e Arsimit në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët dhe integrimi i komuniteteve jo shumicë në Kosovë", REFORMA, Gjiilan, 2015, fq. 403.
19. Ligji Nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, neni 1.
20. MASHTI: "Statistikat e arsimit në Kosovë 2022/2023", MASHTI, Prishtinë, fq. 48-49.
21. Indeksionale: "Rezultatet e PISA 2018 të pritshme, MASHT fajtor për dështim", Indeksionline, <https://indeksonline.net/%E2%80%8BRezultatet-e-pisa-2018-te-pritshme-masht-fajtor-per-deshtim/>, qasur në Dhjetor, 2023.
22. XHema, Shqipron & Uka, Arbrita: "Kosova me rezultate të ulëta në testin 'PISA', Nagavci arsyeton statistikën", artikull i botuar në: <https://kallxo.com/lajm/kosova-me-rezultate-te-uleta-ne-testin-pisa-nagavci-arsyeton-statistikat/>, qasur në Dhjetor, 2023.
23. MASHTI: "Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/21", MASHTI, Prishtinë, fq. 36 & MASHTI: "Statistikat e Arsimit në Kosovë 2021/22", MASHTI, Prishtinë, fq. 36 & MASHTI: "Statistikat e Arsimit në Kosovë 2022/23", MASHTI, Prishtinë, fq. 37.
24. Po aty, fq. 34, fq. 34, fq. 35.



Beteja e Ankarasë - ngjarja që ndryshoi rrjedhën historike

Agon Krasniqi

HYRJE

Beteja e Ankarasë është treguesi kryesor i përballjes së dy fuqive, që burimin e krijimit të tyre e kanë në rajonin e Azisë dhe zhvillimit të tyre në Anadoll. Kjo betejë ishte një betejë mes dy liderëve aziatikë dhe dy shteteve aziatike, që betejën e zhvilluan mbi konceptin e përbashkët të gazasë, për depërtim në Evropë, e që osmanët veçse e kishin realizuar këtë dhe e kishin centralizuar pushtetin me bashkimin e Anadollit me Rumelinë. Kjo betejë, e cila ishte një përballje e dy fuqive të mëdha të kohës, osmanëve dhe timuridëve, ishte edhe një përballje ndërmjet dy liderëve gazinjë, Bajezidit të Parë dhe Timurit, i njohur ndryshe si Emir Timur.

Beteja në fjalë, është treguesi kryesor i ndryshimit të rrjedhës së historisë, e cila ndryshoi fatin e Ballkanit, Kostandinopojës dhe Anadollit. Përballja mes një lideri turk dhe një lideri mongol, ishte parandalim i ngjarjeve që do shkaktoheshin në atë periudhë, por që u shtynë për një gjysmë shekulli. Nëse flitet mbi atë se çka saktësisht përcaktoi kjo betejë, ishte fati i Kostandinopojës, fati i Romës dhe fati i Vjenës.

FAKTORËT QË NDIKUAN NË ZHVILLIM E BETEJËS SË ANKARASË SI DHE ZHVILLIMI I BETEJËS

Beteja e Ankarasë ishte një betejë e zhvilluar ndërmjet Bajezidit të Parë, i njohur ndryshe si "Yildirim" apo "Rrufeja" dhe Timurit, i cili nga origjina, mendohet se ishte mongol dhe

pasardhës i vijës gjenealogjike të Genghis Khanit (Xhingis Khanit).¹ Kjo betejë u zhvillua më 28 korrik të vitit 1402, një betejë e cila ndërpreu përkohësisht rrethimin e Kostandinopojës. Pikërisht beteja e Ankarasë i zgjati jetën Kostandinopojës edhe për pesëdhjetë vjet dhe Bizantit në përgjithësi për gjashtëdhjetë vjet.

Shkaqet që erdhën deri në zhvillimin e betejës së Ankarasë ishin të shumta. Faktor i kësaj është qëllimi i Timurit që ai të rikthente shkëlqimin e perandorisë së vjetër mongole, ku pretendonte se ai kishte gjakun e Genghis (Xhingis) Khanit. Duke pasur parasysh këtë, Timuri kishte qëllim rikthimin e traditës Ilhanide dhe e konsideronte Bajezidin e Parë si uç bej, apo prijës kufitar i shtetit Timurid. Megjithatë, pavarësisht kësaj, Timuri ende nguronte që të përballej me Bajezidin, duke pasur parasysh se ai ishte sulltan me suksese të mëdha ushtarake, siç ishte rasti i suksesit në Nikopol më 25 shtator të vitit 1396, ku mposhti koalicionin e përbashkët krishterë.²

Faktor tjetër i zhvillimit të betejës së Ankarasë, ishin letërkëmbimet ndërmjet Bajezidit të Parë dhe Timurit. Duke pasur parasysh ambicien e madhe të Bajezidit të Parë, ai filloi në akuza të rënda ndaj Timurit, duke e cilësuar atë si "qafir, qen plak", etj..³ Ishin pikërisht letërkëmbimet ndërmjet dy palëve që dërguan në zhvillimin e kësaj beteje. Timuri ishte që të arrihej një paqe ndërmjet dy udhëheqësve dhe së bashku të vazhdojnë rrugën e gazasë, megjithatë Bajezidi vazhdoi

Beteja në fjalë, është treguesi kryesor i ndryshimit të rrjedhës së historisë, e cila ndryshoi fatin e Ballkanit, Kostandinopojës dhe Anadollit.

rrugën me akuza ndaj Timurit, çka shkaktoi edhe zhvillimin e kësaj beteje.⁴

Si rezultat i supremacisë osmane, Evropianët dhe Bizanti, përkrahnin simbolikisht Timurin, duke pasur parasysh se Bajezidi i Parë e kishte rrethuar Kostandinopojën. Nga kjo, Bizanti do i premtojte Timurit që haraqin që ata ia paguanin osmanëve, pas triumfit të Timurit, do t'ia paguanin këtij të fundit. Në anën tjetër, Timuri sikurse edhe osmanët luftonte mbi parimin e gazasë dhe kishte qëllim lidhshpirtin në mes të liderëve mysliman. Kjo luftë për lidhshpirt, solli edhe zhvillimin e betejës së Ankarasë.⁵

Zhvillimi i betejës së Ankarasë shënohet në periudhën e 28 korrikut të vitit 1402. Përplasja e dy ushtrive u zhvillua në rajonin e Çubukut të Ankarasë. Nga propozimet e divanit osman se si duhej rrjedhur zhvillimi i betejës, kemi miratimin e propozimit të bejlerbeut të Rumelisë, Firuz beut, i cili propozoi një betejë frontale.⁶ Faktor i fitores së Timurit në betejë, ishte tërheqja në male e Timurit dhe shpërndarja e ushtrisë osmane. Po ashtu si faktor i rëndësishëm është edhe fakti se bejlerët e Anadolit u tërhoqën nga ushtria e Bajezidit dhe kaluan në ushtrinë e Timurit.⁷ Si rezultat i kësaj kemi edhe tërheqjen e princërve osmanë (Mehmet Çelebiut, Isa Çelebiut, Musa Çelebiut dhe Sulejman Çelebiut), nga beteja, çka shënoi edhe një periudhë të interrgnumit osman, interrgnum ky që zgjati për një periudhë -11 vjeçare.⁸

FATI I SULLTAN BAJEZIDIT (RRUFESË) PAS BETEJËS

Ka diskutime të shumta në lidhje me atë se cili ka qenë trajtimi i Bajezidit të Parë nga ana e Timurit gjatë kohës së robërimit. Ajo çka dihet është se sultani fillimisht u mirëprit në sofrën e Timurit dhe kishte një trajtim të mirë, megjithatë pas një periudhe, princi Mehmet (më vonë Mehmet Çelebiu), tentoi që ta rrëmbejë sultanin, dhe që atëherë mendohet se Bajezidi u vendos në një kafaz, ku historiani Erhan Afyoncu, e emërttoi si sultani në kafaz. Megjithatë nuk ka saktësi mbi këtë ngjarje. Ka mendime që sultani u vendos në një kafaz të hekurt, ku ky pohim ngritet nga ana e historianit Mehmet Fuat Qypriliut, i cili bazohet në veprën “Taxhu’t Tevarih” të Hoxhë Sadeddinit, ku ndër të tjera thekson se sultanin e kishin vendosur në një kafaz të hekurt mbi dy kuaj.⁹ Sipas studiuesit Cuneyt Kanat, i cili është marrë me burimet arkivore të kohës së Timurit dhe shtetit Timurid, thekson se Bajezidi nuk është mbyllur në kafaz. Kjo është një legjendë, e cila burimin e ka në shënimet arabe, që më pas kaluan tek osmanët. Kjo nuk gjendet në shkrimet e Memlukëve dhe as në shkrimet për Timurin.

Në përgjithësi, duke trajtuar këto koncepte bazë, pohojmë se Bajezidi i Parë nuk është mbyllur në kafaz dhe kjo është një legjendë e cila ende përdoret edhe sot nga grupe të caktuara të historianëve.

Diskutime të shumta ka edhe për vdekjen e Bajezidit të Parë, vdekje kjo që erdhi në kohën sa ishte në robëri. Bajezidi i Parë vdiq në vitin 1403 në qytetin e Akshehirit. Kjo vdekje ka zgjuar diskutim të madh ndërmjet historianëve. Diskutimet më të gjera i shohim në mes Mehmet Fuad Qypriliut dhe Mykrimin Halil Yinançit. Nga përfundimi që arrin Mehmet Fuat Qypriliu, është se Bajezidi i Parë kreu vetëvrasje, duke pirë helmin që mbante në unazën e tij. Nga burimet e kohës, kemi burime të shumta që flasin për këtë ngjarje. Nga burimet arabe kemi shënime e Ibën Arabshahut, i cili kishte takuar Timurin dhe e njihte mirë atë, dhe në anën tjetër ishte në rrjedha të ngjarjeve që zhvilloheshin para betejës, gjatë betejës dhe pas betejës së Ankarasë. Sipas Ibën Arabshahut, Bajezidi i Parë ka vdekur nga exheli dhe nuk ka ndonjë fenomen tjetër që karakterizon vdekjen e tij. E njëjta





pohohet edhe nga disa shkrime osmane, siç është ajo e Çelebi Mehmetit, ku thekson se Bajezidi i Parë ka vdekur nga exheli. Në anën tjetër, Ashik Pasha Zade (kronist osman), thekson se sulltani ka bërë vetë-vrasje, pasi piu helmin që mbante në unazë. Kronisti Ashik Pasha Zade, i referohet tregimeve të një ushtari osman, ushtar ky që kishte qenë përkrah Bajezidit të Parë gjatë betejës dhe kohës së robërisë. Po ashtu kemi edhe burimin e kronikës Anonim Tevârîh-i Âl-i Osman ku thekson se: “Timuri i kishte thënë Bajezidit se do ta merrte me vete drejt Semerkandit, fjalë e cila ia kishte humbur shpresat sulltanit. Bajezidi kishte një unazë të cilën e kishte mbajtur fshehur, ku aty kishte helm që e kishte përgatitur më herët dhe kështu vrau veten.”¹⁰ Në anën tjetër burimet bizantine dhe një pjesë e burimeve arabe theksojnë se Bajezidi është vetëvrasë.¹¹ Theksohet se vdekja e Bajezidit të Parë e kishte mërzitur Timurin.¹²

Në imazhin e osmanëve dhe idesë osmaniste, Timuri paraqitet si një person mizor dhe i privuar nga drejtësia, në anën tjetër, Bajezidin e fajësojnë për shkakun se e kishte kapluar krenaria dhe në anën tjetër nuk dëgjonte këshillat e krerëve të tjerë.

TRAJTIMI SE KUSH KISHTE TË DREJTË NË BETEJË, BAJEZIDI APO TIMURI

Një ndër çështjet më të diskutueshme në historiografi, është se kush kishte të drejtë, Bajezidi apo Timuri. Në imazhin e osmanëve dhe idesë osmaniste, Timuri paraqitet si një person mizor dhe i privuar nga drejtësia, në anën tjetër, Bajezidin e fajësojnë për shkakun se e kishte kapluar krenaria dhe në anën tjetër nuk dëgjonte këshillat e krerëve të tjerë.¹³ Kjo pohohet edhe në burimet arabe, ku Ibën Arabshahut thekson se: “Bajezidi ishte një trim, por ishte i paduruar dhe se kur fliste dilte nga vetja duke e humbur kontrollin.”¹⁴ Një pohim i ngjashëm vërehet edhe në burimet osmane, ku kronisti osman, Neshri thekson se: “Bajezidi ishte shumë i përkushtuar por edhe i nxituar.”¹⁵ Nga ajo që shihet në syrin e osmanëve, është një fat që i zuri këta dy liderë, si rezultat i të bëmave të tyre.

Arsyeja se pse historianët kanë fajësuar Timurin, është si rezultat i forcimit të pozitës së

rusëve, pengesës së unitetit të Anadollit dhe vonimit të marrjes së Stambollit për pesëdhjetë vjet.¹⁶ Megjithatë, këto pohime nuk janë të drejta, pasi që edhe osmanët kanë pasur luftëra të zhvilluara ndaj principatave turke dhe shteteve të tjera islame. Ajo çka është e saktë, vërehet në pikëpamjen se dy emirët, ishin gazinjë dhe kishin për qëllim gazanë. Megjithatë ajo çka sjelli luftën ndërmjet tyre ishte se kush duhej të ishte lideri i gazasë.

Ajo çka shihet si esenciale, është fakti se edhe pas triumfit të madh të Timurit dhe në anën tjetër disfatës së madhe të osmanëve në betejën e Ankarasë, për një periudhë të shkurtër kemi ngritjen e shtetit osman dhe dobësimin e timuridëve. Kështu që pavarësisht kësaj fitoreje të timuridëve, ata nuk do mund të ishin një shtet i cili do të qëndronte 500 vjet të tjera pas disfatës. Kjo ndikoi që osmanët e shohin shtetin si faktor kryesor, para sulltanit. Tërheqja e princave të Bajezidit të Parë, është faktor se osmanët vendosën shtetin para sulltanit dhe shteti është i lidhur pas dinastisë dhe jo pas një figure. Kështu që burokracia osmane, ka luajtur një rol të rëndësishëm në shpëtimin e shtetit pas disfatës së Bajezidit. Në anën tjetër, pavarësisht që shteti i Timurit nuk do kishte jetë të gjatë, janë të gabuara pretendimet e disa historianëve që fajësojnë Timurin si në raport me betejën, po ashtu edhe në raport se

çfarë i solli ai botës islame. Vetë themelimi i shtetit në zonën e Semerkandit është tregues i vlerës civilizuese. Po ashtu edhe vazhdimësia e Baburëve në Indi, ishte vijimësi e gjenealogjisë së Timurit. Në anën tjetër, kontributi i Ulug Beut dhe Ali Shir Nevait në astronomi janë tregues të vlerave civilizuese të timuridëve.¹⁷

KONKLUZION

Beteja e Ankarasë, ishte një betejë e cila ndryshoi rrjedhën e ngjarjeve historike. Kjo betejë ia zgjati jetën Bizantit, për pesëdhjetë vjet. Në anën tjetër ishte edhe një shpëtim për Romën, pasi që Molla e Kuqe e shtetit osman, pas Kostandinopojës konsiderohej Roma, ku kjo betejë shkaktoi që fokusi i osmanëve të ishte në mollën e parë (Kizil Elman), e që ishte Kostandinopoja. Rasti i njëjtë ishte edhe me Vjenën, që konsiderohej si molla e tretë kufitare e kuqe. Kjo betejë shënoi edhe destabilizim në rajonin e Ballkanit, ndër të tjera edhe te shqiptarët, si rezultat i interrgnumit osman.

Pohimi se Sulltan Bajezidi i Parë, ishte mbyllur në kafaz, është pohim i gabuar. Sulltani ishte mirëpritur nga ana e Timurit, megjithatë masat e sigurisë ishin të larta si rezultat i procesit të robërimit. Pohimet se ai u mbyll në kafaz, erdhën si rezultat i burimeve arabe, që kaluan te osmanët dhe u shndërruan në një legjendë, që gabimisht nga historianët shihen si burim i dorës së parë.



- 1 Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, (Tiranë: Çabej, 1997), 73.
- 2 Halil Inalxhik, *Devlet-i 'Aliye Studime mbi Perandorinë Osmane periudha klasike (1302-1606) zhvillimi politik, institucional e ekonomik*, (Tiranë: Fan Noli, 2021), f. 86.
- 3 Abdurrahman Daş, *Ankara Savaşı öncesi Timur ile Yıldırım Bazeyid'in mektuplaşmaları*, *Dergi Park, Sayı 15 (İstanbul: 2004)*, f. 145.
- 4 Mehmet Maksudoglu, *Historia Osmane dhe Institucionet*, (Tiranë: Alsar, 2019), f. 100.
- 5 Inalxhik, *Devlet-i 'Aliye*, f. 86-87.
- 6 Robert Mantran, *Historia e Perandorisë Osmane*, (Tiranë: Dituria, 2004), f. 62.
- 7 Halil Inalxhik, *Perandoria Osmane periudha klasike 1300-1600*, (Tiranë: Dituria, 2013), f. 28.
- 8 Halil Inalxhik dhe Gynsel Renda, *Qytetërimi Osman I*, (Tiranë: Alsar, 2016), f. 78.
- 9 Erhan Afyoncu, *Hija e shtetit Osman*, (Tiranë: Fan Noli, 2016), f. 71.
- 10 Inalxhik, *Devlet-i 'Aliye*, f. 94.
- 11 Afyoncu, *Hija*, f.72.
- 12 Pas vdekjes së Sulltan Bajezidit të Parë, Timuri i kishte dërguar Musa Çelebiut (djalin të Bajezidit), një hilat, brez, shpatë, këllëf për shigjeta, si dhe ia dhuronte bursën me dekret të tij. Kështu zotërimet që kishte Bajezidi i Parë kaluan te Timuri, i cili tashmë zotëronte Anadollin, dhe në anën tjetër mendonte që të kalonte për në Rumeli, gjë që nuk ndodhi si rezultat i vdekjes së shpejtë të tij. Shih: Inalxhik, *Devlet-i 'Aliye*, f. 94-95. Kështu kjo ndikoi që shteti osman të rikthehej në një pozicion varësie të shtetit timurid, ku edhe ndikoi në fillimin e interrgnumit apo bllokadës 11-vjeçare osmane. Rilindja Osmane do shënohej në vitin 1413, ku Mehmet Çelebiu mund të konsiderohet edhe si themeluesi i dytë i shtetit osman.
- 13 Afyoncu, *Hija*, f.73.
- 14 Inalxhik, *Devlet-i 'Aliye*, f. 86.
- 15 Inalxhik, *Devlet-i 'Aliye*, f. 86.
- 16 Afyoncu, *Hija*, f. 74-75.
- 17 Afyoncu, *Hija*, f. 76-77.

U promovuan veprat e Myftiut Naim ef. Tërnavë

Me pjesëmarrjen e shumë personaliteteve nga fusha shkencore, fetare e kulturore, të enjten, më 21 dhjetor 2023, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, promovoi tri veprat e Myftiut Naim ef. Tërnavë, “Besimi islam (shtyllat dhe veçoritë) I-II”, “Shkenca e Ilmul Kelamit – parimet bazë” dhe Ligjërime për fenë dhe atdheun III (fjalime, hytbe, urime, deklarata, intervista)”.

Kjo ceremoni, ashtu siç e do rendi filloi me leximin e pjesëve nga Kurani fisnik dhe me intonimin e himnit kombëtar dhe atij shtetëror.

Për ta përshëndetur këtë ceremoni, të parit që iu dha fjala ishte kryetari i Bashkësisë Fetare Islame në Maqedoninë e Veriut, Reisul ulema, Shaqir ef. Fetahi, i cili çmoi dhe vlerësoi lart kontributin fetar dhe kombëtar të Myftiut Naim ef. Tërnavë. Ai e cilësoi Myftiun Tërnavë si një burim frymëzimi, burim i ideve dhe prijës i palodhshëm i BIK-ut dhe atdheut. “Ndjehem tejet i nderuar që sot gjendem në mesin e këtij auditori të mrekullueshëm për t’i dhënë respektin e merituar mikut dhe vëllait tonë, Myftiut Naim ef. Tërnavë, në promovimin e këtyre katër veprave të tij, katër margaritarëve që sot i shtohen thesarit tonë fetar dhe kombëtar. Me këto vepra, dëshmohej edhe më thellë se Myftiu i Kosovës vazhdon të jetë burim frymëzimi, burim i ideve dhe prijës i palodhshëm i BIK-ut në shërbim të Zotit dhe atdheut. Myftiu Tërnavë, është pjesë e gjallë e identitetit kombëtar shqiptar, që kultivon vetëdije mbi Zotin, dijen, familjen, moralin,

paqen, humanitetin, tolerancën dhe bashkëjetesën” – tha ndër të tjera reisi Fetahi.

Zv.Reisi i Bashkësisë Islame të Malit të Zi, Omer ef. Kajoshaj, e cilësoi Myftiun Tërnavë si një udhëheqës që të inspiron për punë të mëtutjeshme. Ai tha se: “I Madhi Zot, nganjëherë çon njerëz jo vetëm që të udhëheqin, por edhe që të inspirojnë, e Myftiu Tërnavë është një nga ata, që edhe udhëheq, por edhe të inspiron, kështu që unë, sa herë që takohem me të, ai më inspiron, e një gjë të tillë e bëri edhe sot këtu. Nga sot, unë nuk mund të them që nuk kam kohë, për faktin se Myftiu, me gjithë punët dhe angazhimet e tij në udhëheqjen e institucionit të BIK-ut, ia ka dalë që të shkruaj e të sjellë për ne librat që sot po i promovojmë.”

Këtë ceremoni e përshëndeti edhe aktivisti dhe veprimtari i dalluar i çështjes fetare, Burhan ef. Fili, i cili tha se në këtë ngjarje e shoh një histori të tërë që ka dalë në pah me veprat e promovuara të Myftiu Tërnavë, e të cilat shprehin një botëkuptim të gjerë të tij, çiltërsinë për t’i nxjerrë në pah vlerat fetare e kombëtare dhe për t’i dhënë një shembull brezave që vijnë më pas që të vijnë këtë rrugë.

Më pas fjala kaloi te referuesit e këtyre librave, e që për veprën “Ligjërime për fenë e atdheun III”, prof. Sabri Bajgora, tha se gjatë shfletimit të saj, hasim copëza historie, fjalime me karaktere fetare, adresime të ndryshme në kohë dhe rrethana historike. “Gjatë shfletimit të këtij libri, do të shohim copëza historie, fjalime me karaktere fetare, adresime të ndryshme në kohë dhe rrethana historike, ndaj me plot të drejtë mund





të themi, se këto fjalime dhe adresime të Myftiut, do të mbeten pjesë të historisë sonë më të re, dhe vetëm pas disa vitesh e mbase edhe dekadash, këto ide dhe vizione të tij do të vlerësohen e çmohen edhe më shumë, për shkak të qëndrueshmërisë së tyre, sepse janë qëndrime të drejta, të cilat nuk i shkeli koha e as rrethana” – tha ndër të tjera prof. Sabri ef. Bajgora.

Për veprën “Besimi islam (shtyllat dhe veçoritë)”, referoi profesori i Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup, dr. Faredin Ebibi, i cili ndër të tjera tha se: “Unë nuk mund të flas më shumë sesa është botuar në këto vëllime, por mund të them dhe marrë të drejtën që këtë vepër të shpalli kryevepër të fushës së Akaidit, për arsye se çdo gjë që e meriton është e shkruar dhe e prezantuar në këto botime. Një fillim i tillë, lexuesit i ofron një qasje më të përafërt në renditjen e tematikave me karakter besimor, duke filluar nga gjeneza e fesë, për të shpjeguar pastaj bazat e besimit islam, si dhe për të vazhduar tutje me shtjellimin e kuptimit të drejtë të këtyre tematikave.”

Ndërkaq, për veprën “Shkenca e Ilmul Kelamit”, prof. Bahri Hoxha tha se autori, Myftiu Naim ef. Tërana, trajton konceptin e shpalljes, nga e cila rrjedh thirrja për besim. “Shpallja si forma e veçantë e kontaktit në mes të hyjnore dhe njerëzore, në libër trajtohet si koncept që ndërlihd rolin e pejgamberisë në iluminimin e njerëzimit, kur ajo paraqitet si rrugë që në bazë të lirisë së përzgjedhjes, njeriu shpreh vullnetin e vet, të jetë i rreshtuar komfor urdhrave të Zotit Krijues, drejt rrugës së amshueshmërisë”, tha dr. Bahri Hoxha.

Në fund të ceremonisë, fjala përmbyllëse i takoi nikoqirit të kësaj ceremonie, Myftiut Naim ef. Tërana, i cili para të pranishmëve tha se këto botime i adresohen audiencës shqiptare dhe atyre që duan të analizojnë.

“Temat e shkencës së Akaidit, të trajtuara në librin e parë “Bazat e besimit” dhe librin tjetër “Shkenca e Ilmul Kelamit”,

janë vetë baza mbi të cilën ngrihet apo ndërtohet Islami me mësimet e tij, të cilat kanë të bëjnë direkt me jetën e njeriut në këtë dhe botën tjetër. I shtyrë nga kjo, them këtu para jush se edhe këto tre libra që sot i kemi para vetes janë ndërtuar në këtë frymë të shtjellimit dhe shpjegimit, të përgjigjeve të shumta, të cilat e mundojnë dhe e shtynë njeriun në mendime të thella. Njëherësh, Akaidi apo Ilmul Kelami është edhe baza apo themeli i dijeve të tjera, andaj edhe si e tillë, kjo fushë studimi është e veçantë dhe nuk mund lehtë t’i besohet çdokujt që të merret me këtë fushë studimi, ngase ka të bëjë me besimin në Zotin xh.sh., Qenien e Tij, cilësitë dhe të gjitha argumentet që flasin dhe e vërtetojnë besimin e drejtë në Zotin Një dhe Njëshmërinë e Tij” – tha ndër të tjera Myftiu Tërana.

Ai këta libra ua dedikoi prindërve të tij, duke thënë se ndonëse jetova pak me ta, ishte e mjaftueshme që ata, në zemrën e shpirtin tim ta frymëzojnë dhe mbjellin ndjenjën, farën e dashurisë për fenë dhe vatanin, mësimet këto të cilat vazhdimisht më pëshpëritnin në shpirtin dhe qenien time.

“Këto frymëzime prindërore më shtynë që t’i qasem kësaj rruge pa hezituar në asnjë moment, në mënyrë që amanetin e tyre ta çoj në vend. Libri “Ligjërime për fenë e atdheun”, shpërfaq pikërisht porosinë dhe amanetin e marrë nga prindërit e mi. Andaj i falënderoj për këtë ndjenjë dashurie që në zemrën dhe shpirtin tim mbollën për fe e atdhe, ngase ata ishin burim frymëzimi dhe inspirimi për mua, ishin vendstrehimi më i sigurt në sytë e mi. Libri “Ligjërime për fenë e atdheun”, shpërfaq punën, aktivitetet e qëndrimet e mia si prijës i Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, përball sfidave me të cilat u ballafaqua populli i Kosovës, qofshin ato sfida fetare apo të natyrave të tjera. Nga këto mendime mund të mësojmë se zëri i Bashkësisë Islame është ngritur dhe është dëgjuar, se thënë thjesht, ne nuk jemi dëgjues pasiv karshi ngjarjeve me të cilat po ballafaqohet vendi ynë” – tha ndër të tjera Myftiu Tërana.

Përgatiti: Bajram Zeqiri

U mbajt Konferenca Shkencore “Xhamia te shqiptarët – histori, mision, identitet”

Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame, në mbështetje të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, më 9 dhe 10 dhjetor 2023, mbajti Konferencën Shkencore me karakter ndërkombëtar, me titull “Xhamia të shqiptarët – histori, mision, identitet”, e cila për qëllim kishte vënien në pah të rëndësisë, historisë dhe misionit që ka pasur xhamia si institucion te populli ynë. Në këtë Konferencë, u theksua roli i xhamive, ku përveç rolit në aspektin fetar, të adhurimit dhe të kryerjes së ritualeve, xhamia, u tha se kishte edhe karakter atdhetar dhe social, duke shërbyer si shkollë e kuvend.

Pas leximit të pjesëve nga Kurani fisnik dhe intonimit të himnit kombëtar dhe atij shtetëror, fjala ishte për drejtorin e Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri ef. Bajgora, i cili ndër të tjera tha se xhamitë te ne tejkaluan rolin e tyre, duke mos u kufizuar vetëm si vende adhurimi. “Përgjatë këtyre shekujve të hapërimit tonë me Islamin si fe,

në trojet tona u ndërtuan shumë xhami të bukura e me vlera historike, duke krijuar kështu një peizazh magjepsës fetar, sepse xhamitë, që në fillim të ndërtimit të tyre, e tejkaluan rolin e tyre duke mos u kufizuar vetëm si vende adhurimi, përkundrazi, misioni i xhamive kudo në tokat shqiptare shtrihet përtej madhësisë së tyre arkitekurore. Ato gjatë historisë, ishin vërtet qendra aktive të edukimit dhe ligjërimit intelektual. Brenda këtyre hapësirave të shenjta, dijetarët dhe mendimtarët, nxitën një kulturë të të mësuarit që i kapërceu kufijtë fetarë. Xhamitë nuk ishin thjesht dëshmitarë të heshtur të historisë, por kanë shërbyer si pika qendrore për ndërveprime sociale, ku individët bashkoheshin duke forcuar lidhjet e përbashkëta në mes tyre” – tha ndër të tjera drejtori Bajgora.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, fillimisht përshëndeti dhe përgëzoi punën e Institutit dhe të gjithë referuesve, të cilët me kumtesat e tyre shpalosën





pjesë të kulturës dhe identitetit tonë. Ai më pas tha se xhamia është vendi që bashkon të gjitha kategoritë e shoqërisë, duke e quajtur atë institucion, i cili i ka ruajtur vlerat gjuhësore e kulturore të besimtarëve tanë. “Vlen të theksohet në veçanti roli i xhamisë si vend i rëndësishëm social dhe edukativ. Vetë mënyra e hyrjes në xhami dhe kryerja e adhurimeve në të është edukatë dhe kulturë në vetvete, kurse qëndrimi në të është kalitje, përsosje dhe edukim shpirtëror. Xhamia pra ka qenë dhe është vendi që bashkon të gjitha kategoritë e shoqërisë, një institucion, i cili ka ruajtur vlerat gjuhësore e kulturore të besimtarëve tanë. Në ambientet e këtyre shtëpive të Zotit, zunë fill dhe u zhvilluan edhe shumë ngjarje me rëndësi jetike për popullin dhe vendin tonë, duke u vënë kështu në shërbim të çështjes kombëtare. Xhamitë tona u shndërruan në shkolla e kuvende burrash, nga aty dolën dhe i prinë popullit ulema e atdhetarë tanë të spikatur, që u vunë në ballë të proceseve të rëndësishme historike, politike e kombëtare, ku vlen të përmendet se në xhaminë “Bajrakli” të Prizrenit u mbajt edhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit, e deri te lufta e fundit, ku xhamitë tona u shndërruan në qendra të rezistencës e të mbijetesës sonë” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Një fjalë rahti e mbajti edhe kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, Reisul ulema, Shaqir ef. Fetahi, i cili tha se kjo Konferencë është unike për shkak të qasjes gjithëpërfshirëse ndaj xhamisë. “Kjo Konferencë shkencore po respekton institucionin e shenjtë të Islamit që quhet xhami. Për këtë jam i bindur se gjithë shqiptarët dhe

në veçanti për shqiptarët në trojet e tyre për shkak se për herë të parë, institucionit të xhamisë i qasemi nga të gjitha aspektet. Aspektin fetar, etik, shoqëror, social, ekonomi, artistik, letrar dhe në veçanti i qasemi xhamisë si shtyllë e identitetit kombëtarë e që ishte shtyllë në momentet më të rëndësishme. Kjo ka qenë një fuqi e madhe për të kuptuar se shqiptarët nuk janë rastësisht bartës së islamit, shqiptarët prej kohës së ezelit janë të caktuar që të jenë bartës së islamit në Ballkan dhe Evropë.”





Gjatë dy ditëve sa zgjati kjo Konferencë, me kumtesat e tyre u paraqitën mbi 70 studiues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Jordania dhe Egjipti. Pjesëmarrësi në këtë Konferencë ishin: Resul Rexhepi, dr. Faredin Ebibi, dr. Ferid Piku, dr. Valon Myrta, dr. Murtezan Idrizi, dr. Ziber Lata, dr. Abdulla Rexhepi, dr. Iljaz Rexha, dr. Sadik Mehmeti, Ramadan Shkodra, dr. Orges Drançolli, dr. Hysen Matoshi, Zeqirija Ibrahim, Petrit Zeneli, dr. Maksut Xh. Haxhibrahimi, dr. Mehmet Zeki Ibrahimigil, dr. Besir Neziri, Phd.C. Brunilda Basha, dr. Fahri Avdijsa, dr. Agron Islami, Tomor Kastrati, dr. Krenar Doli, Migen Matraku, dr. Shinazi Memedi, dr. Jusuf Osmani, dr. Fahrush Rexhepi, dr. Amra Hadžimuhamedić, Ali Bardhi, dr. Ferid Selimi, mr. Sami Isufi, Elza Shipoli, dr. Hatixhe Ahmedi, dr. Adem Zejnullahu, dr. Valon Shkodra, dr. Orhan Bislimaj, dr. Azmir Jusufi, dr. Mead Osmani, dr. Qerim Lita, Hamid Alaj, dr. Selim Selimi, Ejup Ramadani, dr. Behlul Kanaqi, dr. Naser Ramadani, Vullnet Iseni, dr. Genti Kruja, dr. Ermal Nurja, Roald Hysa, Ermal Bega, Elez Osmani, dr. Genc Samimi, dr. Fitim Rifati, Harun Shabanaj, Sabri Bajgora, dr. Sylë Ukshini, Baki Svirca, mr. Ali Sadiku, hfz. Arif ef. Emini, dr. Bashkim Aliu, dr. Sedat Islami, dr. Feim Gashi, dr. Qenan Ismaili, Vedat Sahiti, Besnik Kadriolli, dr. Rexhep Suma, Vahidin Beluli, dr. Shkodran Imeraj, dr. Ibrahim el Bejjumi Ganim, dr. Fajza Meluk, Akad. Muhamed Mufaku, Bashkim Mehani, dr. Saleh Lamei, Akad. Feti Mehdiu, dr. Isa Memishi, mr. Besim Mehmeti.

Pas përfundimit të pesë seancave paralele të ndara në dy ditë, u mbajt edhe ceremonia përmbyllëse e kësaj Konference, në të cilën pos shumë personaliteteve, mori pjesë edhe kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili ndër të tjerash theksoi: “Ne përgjatë dy ditëve me radhë, jetuam nën urdhrin e të Madhit Zot, i cili para 1400 vjetëve, na urdhëroi që të ndërtojmë shtëpia të

Zotit, të përkujdesemi për to dhe që në vazhdimësi të përmendet fjala e Zotit. Andaj falënderoj të gjithë pjesëmarrësit e kësaj Konference, në veçanti studiuesit, të cilët kanë bërë shumë, në mënyrë që kjo Konferencë të dalë e suksesshme dhe besoj që ia kemi arritur qëllimit.” Ai dha porosi edhe për Institutin e Hulumtimeve dhe Studimeve Islame që edhe më tej të vazhdojnë në organizimin e konferencave të tilla, të cilat do të hidhnin dritë mbi shumë gjëra të cilat tashmë i ka mbuluar pluhuri, duke ofruar kështu përkrahjen e vazhdueshme të institucionit të BIK-ut. “Bashkësia Islame e Kosovës edhe më do të përkujdeset për organizimin e tryezave, simpoziumeve dhe konferencave të tilla dhe se ne bashkërisht do t’ia dalim” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Ndërkaq, në emër të Këshillit Organizativ, fjalën përmbyllëse e mbajti dr. Valon Myrta, i cili në pika të shkurtra tregoi për ecurinë dhe mbarëvajtjen e kësaj Konference. Ai tha se konferencat e tilla nuk do të mund të realizoheshin pa pjesëmarrjen e studiuesve dhe referuesve, të cilët, me kumtesat e tyre, secili në fushën e vet, vunë në spikamë dhe ndriçuan fusha të ndryshme rreth xhamive të shqiptarët. Ai para të pranishmëve më pas shpalosi edhe fokusin e seancave të kësaj Konference. “Konferenca i zhvilloi punimet në dy ditë, ku në fokus ishte aspekti fetar dhe kulturor i xhamive, të lidhura me konceptin, rëndësinë, veçoritë, rolin dhe funksionin e xhamive, çështjet nga fusha arkivore dhe arkeologjike, çështje nga fusha e trashëgimisë kulturore në të drejtën ndërkombëtare, si dhe kontributi i xhamive në kultivimin e identitetit kombëtar në trevat shqiptare dhe nëpër botë. Përgjithësisht në fokus të kësaj Konference ishte historiku, roli, arti, kultura, arkitektura dhe trajtimi i trashëgimisë dhe shkatërrimi i xhamive në trojet tona.”

Përgatiti: Bajram Zeqiri

AMBASADORI I ARABISË SAUDITE UROI MYFTIUN TËRNAVA



Më 7 dhjetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka prituri në takim ambasadorin e Arabisë Saudite, z. Feisal Hefzi.

Në këtë takim, ambasadori uroi Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen edhe për një mandat në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i shprehur urimet dhe përgëzimet më të sinqerta për marrjen e kësaj detyre. Ai i

uroi Myftiut Tërnavë punë të mbarë, të bereqetshme dhe të suksesshme, duke rikonfirmuar edhe njëherë gatishmërinë e tij dhe të shtetit që ai përfaqëson që të jetë pranë kërkesave dhe nevojave të Bashkësisë Islame në veçanti, por edhe të Kosovës në përgjithësi.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, falënderoi ambasadorin për vizitën dhe për urimet e tij, duke shprehur kështu falënderimet e tij dhe të institucionit të

Bashkësisë Islame të Kosovës për ndihmat dhe përkrahjen e vazhdueshme që i ka dhënë shteti i Arabisë Saudite. Ai tha se si institucion mbështet të përkushtuar për të vazhduar bashkëpunimin e mirë që kemi pasur deri më tani me Ambasadën e Arabisë Saudite në projekte dhe fusha të ndryshme me rëndësi për qytetarët e vendit tonë.

U KONSTITUA KRYESIA E RE E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS

Më 2 dhjetor 2023, në ambientet e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, u konstitua Kryesia e re e Bashkësisë Islame të Kosovës, në përbërje kryetar, Myftiu Naim ef. Tërnavë, anëtarë, Burhan Hashani – Prishtinë, Shkelzen Hoxha – Mitrovicë, Musli Arifaj – Pejë, Orhan Bislimaj – Prizren, Sevdair Haxhiu – Ferizaj, Agim Hyseni – Gjilan, Valon Myrta – Gjakovë dhe Sulejman Fejzullahu – Preshevë.

Myftiu Tërnavë fillimisht falënderoi Zotin e Madhëruar për të mirat që na i ka dhuruar, e më pas i uroi anëtarët e ri të Kryesisë për marrjen e detyrës, duke kërkuar kështu përkushtim dhe sinqeritet në punë. Ai tha se amanetin që e kemi marrë mbi supet tona, duhet ta çojmë në vend dhe duhet të mundohemi që të jemi gjithnjë në shërbim të besimtarëve tanë.

Më pas Kryesia vazhdoi me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje, e që ishin parapërgatitja për mbledhjen e radhës së Kuvendit të

Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe u aprovua projekt-buxheti i Këshillave të BI-së dhe Kryesisë së BIK-ut për vitin 2024.

Ndërkaq, më 5 dhjetor 2023, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti mbledhjen e saj të rregullt, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Në këtë mbledhje u diskutua për parapërgatitjet për muajin e bekuar Ramazan, për hapjen e akademisë –

programit një vjeçar, si dhe u shqyrtuan lëndë dhe u morën vendime në bazë të kompetencave të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës.

Po ashtu, më 26 dhjetor 2023, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e rregullt të saj, të kryesuar nga kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Gjatë kësaj mbledhje u shqyrtuan dhe u morën vendime nga kompetencat e kësaj Kryesie.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KPM-SË, Z. JETON MEHMETIN



Më 1 dhjetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Komisionit të Pavarur të Mediave, z. Jeton Mehmetin.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë, fillimisht e falënderoi z. Mehmetin për

punën dhe kontributin e tij dhe të Komisionit të Pavarur të Mediave, e më pas e ngriti si temë diskutimi çështjen e mohimit të së drejtës së bashkësive fetare për të pasur frekuenca të radios dhe të televizionit.

Nga ana e tij, kryetari Mehmeti, gjatë këtij takimi shfrytëzoi rastin që të uroi Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e tij në krye të Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe më pas e njohu Myftiun me punën e KPM-së si institucion i pavarur kushtetues për rregullimin e hapësirës mediale në Kosovë.

KRYETARI I KMSH-SË, BUJAR EF. SPAHIU UROI MYFTIUN TËRNAVA

Më 4 dhjetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ka pritur në takim kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Bujar ef. Spahiun, i cili shoqërohej nga bashkëpunëtorët e tij.

Ky takim erdhi pas rizgjedhjes së Myftiut Tërnavë në postin e kryetarit dhe myftiut të Bashkësisë Islame të Kosovës, për çka kryetari Spahi u

uroi dhe e përgëzoi nikoqirin, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai vlerësoi lart punën dhe angazhimin e deritanishëm të Myftiut Tërnavë dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës dhënë për mbarëvajtjen e jetës fetare në Kosovë.

Ndërkaq Myftiu Tërnavë, e falënderoi kryetarin Spahi për vizitën dhe për urimet, duke thënë se ndjehet i nderuar me vizitën vëllazërore të tij

dhe të vartësve të tij. Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës dhe Komuniteti Mysliman i Shqipërisë gjithnjë kanë pasur dhe kanë një bashkëpunim të mirë në të gjitha fushat me interes për besimtarët e të dyja vendeve.

Gjatë këtij takimi u diskutuan edhe çështje të tjera me rëndësi për besimtarët myslimanë të Kosovës dhe të Shqipërisë, si dhe për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KOMUNËS SË MALISHEVËS, Z. EKREM KASTRATI



Më 5 dhjetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Komunës së Malishevës, z. Ekrem Kastrati.

Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin Kastrati për vizitën dhe për bashkëpunimin e deritanishëm me Bashkësinë Islame në përgjithësi, e në veçanti me Këshillin e BI-së së

Malishevës, duke theksuar se një bashkëpunim i tillë duhet të vazhdohet edhe në të ardhmen. Ai theksoi se si institucion mbështetës të përkushtuar që të kemi bashkëpunim me të gjithë kryetarët e komunave pa dallim, gjithnjë në shërbim të qytetarëve tanë.

Kryetari Kastrati, uroi Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e tij në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të

Kosovës, duke i dëshiruar kështu punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai vlerësoi lart punën dhe angazhimin e deritanishëm të Bashkësisë Islame të Kosovës në të gjitha sferat, duke potencuar kështu edhe bashkëpunimin e mirë që ka pasur deri më tani me Këshillin e BI-së së Malishevës.

KËSHILLI I BI-SË I RAJONIT TË GORËS UROI MYFTIUN TËRNAVA

Më 6 dhjetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur sot për urime kryetarin e Këshillit të Bashkësisë Islame të rajonit të Gorës, Miralem ef. Misinin, i cili shoqërohej nga administrata e këtij Këshilli dhe nga një pjesë e imamëve.

Në këtë takim, kryetari i Këshillit të BI-së së rajonit të Gorës, Miralem ef. Misini, uroi Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e tij në krye të institucionit

të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i uruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai me këtë rast, e falënderoi Myftiun Tërnavë për përkrahjen e vazhdueshme dhënë për imamët e rajonit të Gorës.

Njëherësh, kryetari Misini, e informoi Myftiun Tërnavë me atë se, vetëm Këshilli i BI-së së rajonit të Gorës nuk i është nënshtruar presionit të vazhdueshëm nga Serbia për t'iu bashkëngjitur organeve paralele, të cilat punojnë e veprojnë në rajonin e Gorës.

Nga ana e tij, Myftiu Naim ef. Tërnavë, falënderoi kryetarin Misini për urimet, si dhe vlerësoi lart punën dhe angazhimin e imamëve goranë. Myftiu Tërnavë kërkoi nga kryetari Misini dhe nga imamët punë të mëtutjeshme në atdheun tonë të përbashkët, për ta çuar në vend amanetin, të cilin e kemi marrë mbi supet tona, pra atë të mirëqenies së besimtarëve tanë.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM IMAMIN FERID EF. BEDROLLI



Më 6 dhjetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim imamin dhe sekretarin e Qendrës Shqiptare Islame Kulturore në Nju Jork, Ferid ef. Bedrollin.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë, shfrytëzoi rastin që të njoh mysafirin me ecurinë e punëve dhe zhvillimeve në Bashkësinë Islame të Kosovës, si

dhe për bashkëpunimin që kanë me qendrat islame në diasporë. Ai edhe njëherë rikonfirmoi gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton që të kenë edhe më tutje bashkëpunim në të gjitha fushat me rëndësi për besimtarët myslimanë.

Nga ana e tij, imami Bedrolli, fillimisht e uroi Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e tij në krye të institucionit

të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i uruar suksese në këtë detyrë. Ai më pas falënderoi Myftiun Tërnavë për bashkëpunimin e deritanishëm që ka pasur ai dhe institucioni i BIK-ut me qendrat islame në diasporë, e në veçanti me Qendrën Shqiptare Islame Kulturore në Nju Jork.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM PËRFAQËSUESIT E XHAMISË SË SHQIPTARËVE NË LONDËR

Më 14 dhjetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ka pritur në takim imamin e xhamisë së shqiptarëve në Londër, Zymer ef. Salihun, i cili shoqërohej nga Orhan Ramaxhiku, arkëtar në këtë xhami, si dhe nga Amir Qadari, drejtor për marrëdhënie për jashtë në shoqatën "Davetul Islam" në Londër.

Myftiu Tërnavë fillimisht iu uroi mirëseardhje mysafirëve, e më pas i

njohu ata me punët dhe zhvillimet në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai shprehu mirënjohjen e tij për angazhimin e diasporës shqiptare në mbarëvajtjen e jetës fetare në Diasporë. Ai tha se si institucion mbesim të përkushtuar që të vazhdojmë bashkëpunimin me qendrat e diasporës, si dhe jemi të gatshëm që t'i përkrahim këto qendra me gjithë potencialin dhe kapacitetet që kemi.

Nga ana e tij, imami Zymer ef. Salihu, fillimisht e uroi Myftiun Tërnavë për

rizgjedhjen e tij në krye të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme në udhëheqjen e këtij institucioni, e më pas e falënderoi atë për bashkëpunimin e deritanishëm që kanë pasur, duke shprehur kështu gatishmërinë e tij për një bashkëpunim edhe në të ardhmen.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për mundësitë dhe fushat ku mund të japë kontribut qendra islame shqiptare në Londër.



KRYETARI I KOMUNËS SË KLINËS, Z. ZENUN ELEZAJ UROI MYFTIUN TËRNAVA



Më 19 dhjetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, i cili shoqërohej edhe nga administrata e Këshillit të BI-së së Klinës.

Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin Elezaj për vizitën dhe për bashkë-

punimin e deritanishëm me Bashkësinë Islame në përgjithësi, por edhe me Këshillin e BI-së së Klinës. Ai tha se një bashkëpunim i tillë duhet të vazhdohet edhe në të ardhmen, gjithnjë për të mirën e besimtarëve dhe qytetarëve tanë.

Nga ana e tij, kryetari Elezaj, fillimisht uroi Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e

tij në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke çmuar dhe vlerësuar lart rolin dhe kontributin që ka dhënë Myftiu Tërnavë dhe Bashkësia Islame e Kosovës për tolerancën dhe bashkëjetesën ndërmjet besimeve të ndryshme në Kosovë. Ai tha se si institucion kanë një bashkëpunim të mirë me Këshillin e BI-së së Klinës.

MYFTIU TËRNAVA DHE KRYEMINISTRI KURTI VIZITUAN XHAMINË E NOVOBËRDËS

Më 20 dhjetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, së bashku me kryeministrin e Kosovës, z. Albin Kurtin dhe ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, vizituan xhaminë e “Osman Efendisë” apo Xhaminë e Çarshisë së Novobërdës, për të parë nga afër punimet në restaurimin e kësaj xhamie.

Ata u ndanë të kënaqur me gjithë punën që është bërë në restaurimin e kësaj xhamie, e cila përveç që shërben për kryerjen e riteve fetare, qëndron e hapur për vizitorë nga vende të ndryshme të botës.

Myftiu Tërnavë mes të tjerash tha se Bashkësia Islame e Kosovës është thellë e përkushtuar në ruajtjen e trashëgimisë kulturore islame të vendit tonë.

Xhamia e “Osman Efendiut” është rikonstruktiv i shekullit XVIII dhe është në proces të restaurimit që nga fundviti i kaluar. Procesi i restaurimit është duke u mbështetur nga BE-ja dhe duke u implementuar nga zyra e UNDP-së në Kosovë.

Ajo është ndër së paku pesë xhamitë sa ishin ndërtuar në periudhën osmane, 1455, shek. XV në qytetin e Novobërdës.



MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË CEREMONINË E DORËZIMIT TË REKORDIT BOTËROR PËR MEDRESENË “ALAUDDIN”



Më 22 dhjetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë mori pjesë në ceremoninë e dorëzimit të rekordit botëror për Medresenë “Alauddin” në Prishtinë.

Emri i Medresesë “Alauddin” arriti të shënohet në librin e rekordeve botërore “Genis”, kjo falë rekordmenes Arbnora Fejza-Idrizi, e cila i solli Kosovës një rekord të katërt botëror.

Bëhet fjalë për flamurin kombëtar, më të madhin në botë që Fejza-Idrizi arriti ta punojë bashkë me 74 medresistë vullnetarë të tjerë.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, vlerësoi lart kontributin e rekordmenes Idrizi, duke uruar që ky sukses të jetë motiv për të punuar në arritjen e sukseseve tjera.

Myftiu po ashtu dha një mesazh të fuqishëm për nxënësit e Medresesë dhe të gjithë rininë që të punojnë për atdheun e mos të largohen nga vendi.

“Unë dëshiroj që sot t’iu them juve diçka, t’ju porosis, mos synoni kurrë emigrimin nga Kosova, ndaluni në Kosovë, Kosova është e jona, nuk guxojmë t’ia lëmë të tjerëve, është

dëshirë e Zotit, ne nuk guxojmë të punojmë kundër dëshirës së Zotit, ngase na krijoi këtu në këtë vend, sikur të kishte dashur Zoti, do të na kishte krijuar në vende të tjera. Andaj e kemi amanet ta ruajmë këtë vend, përmes ruajtjes së këtij vendi do ta ruajmë edhe dinin, dinjitetin tonë kombëtar, atdhetar që e kemi”, tha Myftiu Tërnavë mes të tjerash.

Rekordmenia Arbnora Fejza-Idrizi, në fjalën e saj tha se ndihet e lumtur e krenare dhe mirënjohëse ndaj të gjithë atyre që e përkrahën në këtë rrugëtim.

Kurse, drejtori i Medresesë “Alauddin”, Fadil Hasani, tha se stafi i Medresesë me kënaqësi bashkëpunoi me Fejza-Idrizin, e cila bashkë me medresistët i sollën Kosovës një rekord të ri. Ai tha se Kosova ndihet krenare për kontributin e Medresesë në të gjitha periudhat e kohës, duke theksuar se ajo ishte aktive në të gjitha veprimtaritë më të rëndësishme të atdheut.

Në fund rekordi i ri botëror iu dorëzua Medresesë “Alauddin” dhe u ndanë certifikata për të gjithë ata që kontribuan në një formë apo tjetër që të arrihet ky sukses.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KOMUNËS SË OBILIQIT, Z. XHAFER GASHI

Më 22 dhjetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Komunës së Obiliqit, z. Xhafer Gashi.

Gjatë këtij takimi u diskutua për bashkëpunimin e mirë që ka Bashkësia Islame e Kosovës dhe Këshilli i BI-së së Obiliqit me Komunën e Obiliqit, për çka Myftiu Tërnavë, u shpreh falënderues dhe tha se një bashkëpunim i tillë duhet të vazhdohet edhe në të ardhmen, gjithnjë për të mirën e besimtarëve dhe qytetarëve tanë.

Nga ana e tij, kryetari Gashi, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, dhe më pas e uroi atë për rizgjedhjen e



tij në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës edhe për një mandat, duke shprehur kështu urimet më të mira për punë të mbara dhe të suksesshme. Ai çmoi lart punën dhe

kontributin e Myftiut Tërnavë dhe të Bashkësisë Islame të Kosovës dhënë për vendin tonë në përgjithësi në procese të ndryshme.

MESAZH URIMI PËR IPESHKVIN DODË GJERGJI

I nderuari ipeshkëv, Dodë Gjergji

Me nderim e respekt të posaçëm, në këtë ditë të shënuar për besimtarët e krishterë, më lejoni që t'ju drejtohem me mesazh urimi e përgëzimi Juve, meshtarëve tuaj, si dhe të gjithë vëllezërve të krishterë, duke ju dëshiruar shëndet, mbarësi e lumturi.

Festa e Kërshëndellës është moment i veçantë për besimtarët e krishterë, sepse në zanafillën e saj ka lindjen, shpresën e mbarësinë.

Festat fetare te ne, ashtu si edhe besimet tona, te populli ynë gjithëherë

kanë qenë momente të reflektimit, që kanë përçarur unitet, dashuri, mirëkuptim e harmoni, vlera këto të shtresuara thellë në identitetin tonë.

Zotni Ipeshkëv, përmes jush, uroj e përgëzoj edhe të gjithë praninë ndërkombëtare katolike në Kosovë.

Duke ju përshëndetur, ju dëshiroj shëndet, mbarësi e lumturi!

Prishtinë, 24 dhjetor 2023

Me respekt,

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë



MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË CEREMONINË E SHPËRNDARJES SË DIPLOMAVE NË FSI

Më 26 dhjetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në ceremoninë e shpërndarjes së diplomave për 37 studentë të diplomuar përgjatë vitit 2023. Nga këta 37 studentë, 29 prej tyre i takonin nivelit bachelor, ndërsa 8 nga niveli master.

Myftiu Tërnavë uroi studentët për përkushtimin e tyre, duke iu dëshiruar shëndet e suksese tutje. Ai po ashtu falënderoi dekanin, sekretarin dhe gjithë stafin akademik për kontributin që po japin për të nxjerrë kuadro të përgatitura profesionalisht.

“Është kënaqësi e madhe kur edhe praktikisht e shohim që e kemi dhënë një mund, një kontribut të tillë bashkërisht” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë. Ai gjithashtu tha se sot, mundësitë për t'u ngritur e avancuar profesionalisht janë më të mëdha, duke theksuar se në Fakultetin e Studimeve Islame, përveç nivelit bachelor e master, tani studentët në këtë institucion mund t'i përfundojnë edhe studimet e doktoratës.

Myftiu Tërnavë, si gjithëherë nuk harroi t'u japë këshilla studentëve por

edhe t'ua rikujtojë barrën e përgjegjësisë që kanë para vetës.

Ai gjithashtu tha se Bashkësia Islame e Kosovës me të gjitha institucionet e saj do t'i mbështes gjithmonë studentët dhe ata që kanë përfunduar studimet në këtë institucion.

Studentët i uroi edhe dekanin e Fakultetit të Studimeve Islame, dr. Islam Hasani, i cili po ashtu falënderoi Myftiun Tërnavë për prezencën dhe fjalën e tij.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË PUNISHTEN E XHAMISË QENDRORE NË PRISHTINË, Z. BILAL ERDOGAN

Më 27 dhjetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mirëpriti në punishten e Xhamisë Qendrore në Prishtinë, z. Bilal Erdogan, i cili qëndroi për vizitë në vendin tonë.

Myftiu Tërnavë, pasi i shprehu mirëseardhje, e njohu më pas z. Erdoganin me ecurinë dhe zhvillimin e punimeve në ndërtimin e Xhamisë Qendrore.

Ai falënderoi atë për vizitën dhe për mbështetjen e shtetit turk, gjegjësisht fondacionit të DIJANET-it në ndërtimin e Xhamisë Qendrore në Prishtinë.



KUVENDI I BASHKËSISË ISLAME MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT

Më 28 dhjetor 2023, Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës ka mbajtur mbledhjen e rregullt. Kjo mbledhje, njëkohësisht ishte e para pas konstituimit të Kuvendit në muajt paraprak.

Mbledhja filloi me lexim të Kuranit, për të vijuar më pas me hapjen e kësaj mbledhje, me c'rast kryetari i Kuvendit, dr. Ajni Sinani, u dëshiroi mirëseardhje, duke i kujtuar vetës dhe anëtarëve të tjerë për detyrat me të cilat janë ngarkuar.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, foli për gjendjen e përgjithshme të organizimit fetar në Kosovë.

Ai kërkoi të ruhet uniteti dhe të orientohet puna në ruajtjen dhe kultivimin e paqes, tolerancës dhe mirëkuptimit.

“Ajetet e Kuranit na obligojnë të punojnë siç na ka urdhëruar Zoti dhe Muhamedi a.s.. Uniteti është jetike duke pasur parasysh pozitën gjeo-strategjike dhe gjeopolitike që ka vendi ynë, rrymat e shumta të cilat kalojnë në

këtë nën qiell, por edhe rryma të cilat vinë në tokën e Kosovës që synojnë një plasaritje në mesin e myslimanëve, andaj ne jemi të thirrur ta ruajmë këtë unitet. Me përgjegjësinë me të madhe mund të themi se ne ja kemi arritur t'ia dalim, përkundër sfidave të mëdha.”

Gjatë kësaj mbledhje u shqyrtua dhe u miratua projekt-buxheti i Kryesisë për vitin 2024, ndërsa u shqyrtuan edhe lëndë të tjera me iniciativë të anëtarëve të Kuvendit, bazuar në mandatin dhe kompetencat e tyre.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KOMUNËS SË PRIZRENIT, Z. SHAQIR TOTAJ



Më 29 dhjetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Komunës së Prizrenit, z. Shaqir Totaj.

Gjatë këtij takimi u bisedua për bashkëpunimin e mirë që ka Bashkësisë Islame e Kosovës me Komunën e Prizrenit, për çka Myftiu Tërnavë, u shpreh tejet falënderues, si dhe shprehu

gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton që ky bashkëpunim i mirë të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Nga ana e tij, kryetari Totaj, së pari uroi Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e tij në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i uruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai vlerësoi dhe çmoi lart kontributin e Myftiut

Tërnavë dhe të Bashkësisë Islame e Kosovës dhënë në të gjitha proceset që ka kaluar vendi ynë.

Në fund të takimin, Myftiu Tërnavë, i dhuroi kryetarit Totaj botimin “Sallnametë e Vilajetit të Prizrenit (1873-1874) I-II”, i botuar nga Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË TAKIMIN PËRMBYLLËS TË MUALIMEVE TË DEPARTAMENTIT TË GRUAS

Më 29 dhjetor 2023, Departamenti i Gruas pranë Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti takimin përmbyllës, në të cilin është vlerësuar puna një vjeçare e Departamentit.

Në këtë organizim mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë, i cili në fjalimin e tij tha se ndihet krenar për punën e të gjitha mualimeve, duke falënderuar kështu secilën për përkushtimin dhe punën, e cila, institucionit të Bashkësisë Islame i solli vlerësim të vazhdueshëm.

“Nuk ka mundësi që fjalët e mia të arrijnë të përshkruajnë dhe t’ju falënderojnë dhe vlerësojnë aq sa meritoni për punën tuaj, ndaj më e pakta që mund t’ju them është faleminderit për gjithçka që keni ofruar dhe keni bërë për nxënësit dhe gratë tona në edukimin e tyre me mësimet islame dhe mësimin



e leximit të Kuranit librit tonë të shenjtë. I madhi Zot xh.sh., në suren En Nexhm, thotë: “Njeriu do të ketë vetëm atë për të cilin ka punuar; dhe pa dyshim, përpjekjet e tij do të shihen.” Ju mualime të nderuara, i dhuroat këtij institucioni kaq kredibil e domethënës për popullin tonë vlerësimin e vazhdueshëm. Unë besoj se edhe në të ardhmen me punën tuaj do të shkëlqeni dhe bashkërisht do të arrijmë nivelet më të larta të suksesit”, tha Myftiu Tërnavë.

Udhëheqësja e Departamentit të Gruas, znj. Vaxhide Bunjaku, përmendi aktivitetet e realizuara gjatë këtij viti dhe falënderoi të gjitha mualimet për angazhimin e tyre dhe sukseset e arritura.

“Si rezultat i punës së Departamentit të Gruas, gjatë vitit 2023, kemi arritur të përmbushim objektivat tona në edukim të grave, vajzave dhe fëmijëve tanë, përmes realizimit të shumë programeve të ndryshme edukative, ligjëratave, dua të hatmeve, aktivitete gjatë gjithë muajit Ramazan, ligjërata për muajin e Mevludit, kemi përcjell zhvillimin e mësim-besimit nga mualimet dhe të akademisë “Hifdh Kids”, kemi organizuar konferencën për Ditën Botërore të Mbulesës, kemi marrë pjesë në trajnime të ndryshme,



kemi arritur socializim e bashkëveprim me institucionet e vendit, me komuna, OJQ të ndryshme, fushata për parandalimin e fenomeneve negative, sensibilizime, kontribute humanitare etj.”, tha mes të tjerash znj. Bunjaku.

Edhe kryeimami Vedat ef. Sahiti, vlerësoi lart punën një vjeçare të Departamentit të Gruas në veçanti dhe angazhimin e tyre ndër vite.

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës përmes Drejtorisë Fetaro-Arsimore ndau mirënjohje për

mualimet, Xhevrije Derguti-Vila, Kadrije Dragusha-Ademi dhe Mihana Goga-Bekteshin, të cilat në periudha të ndryshme kohore dhanë kontribut në zhvillimin e aktiviteteve fetare dhe në fushën e mësim-besimit.

Gjithashtu në këtë ngjarje u shpallën edhe tri vendet e para të fituara në konkursin letrar kushtuar pejgamberit Muhamedit a.s..

Vendin e parë e fitoi Munira Nura, të dytin Amar Gashi dhe Ajan Hoxha, kurse vendin e tretin Elmedina Tahiri.



MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË INAUGURIMIN E PROJEKTIT PËR QËNDRIMIN DITOR NË VUSHTRRI



Më 30 dhjetor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë në ceremoninë e inaugurimit të projektit qëndrimin ditor në Vushtrri, i ndërtuar nga Shoqata “Jetimat e Ballkanit”.

Në këtë ceremoni morën pjesë shumë personalitete të ndryshme, nga fusha politike e fetare.

Në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, Myftiu Tërnavë, tha se njeriu te Zoti do

ta gjejë atë për çfarë është angazhuar dhe ka punuar në këtë botë, në të mirë të vendit, të fesë dhe të mirëqenies së njerëzve. “Puna e çdonjërit, nesër kur do të dalim para Zotit, do të shihet prej tij, prej pejgamberëve dhe prej të gjithë besimtarëve, andaj edhe këtë objekt që sot e kemi para vetes, sigurisht se është argumenti më i mirë, se kombi ynë ka një zemër bujare, si në të kaluarën ashtu edhe tash, dhe do të jetë gati gjithëherë për të kontribuar për të mirën e fesë

dhe të kombit” - tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Ai më pas citoi hadithin e Pejgamberit a.s., i cili thotë se: “Nuk ka falënderuar Allahun ai i cili nuk i falënderon njerëzit”, duke shfrytëzuar rastin kështu që të falënderojë të gjithë ata që në çfarëdo mënyre kanë kontribuar dhe kanë ndihmuar që të ndërtohet ky objekt, e posaçërisht një falënderim të veçantë ia dedikoi udhëheqësit të Shoqatës, z. Halil Kastratit.

KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM MINISTREN E DREJTËSISË, ZNJ. ALBULENA HAXHIU

Më 2 dhjetor 2023, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka pritur në takim ministren e Drejtësisë, znj. Albulena Haxhiu, me të cilën diskutuan për hartimin e planit të veprimit të Memorandumit, të nënshtkruar ditë më parë mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Bashkësisë Islame të Kosovës, i cili ka për qëllim bashkëpunimin kundër dhunës në familje dhe ofrimin e sesioneve informuese për komunitetin, si dhe mobilizimin e liderëve fetarë kundër të gjitha formave të dhunës në familje e dhunës ndaj grave.

“Bashkësia Islame e Kosovës mbetet e përkushtuar që të luftojë të gjitha



format e dhunës në shoqëri, e në veçanti kundër dhunës në familje dhe dhunës

mbi bazë gjinore” - theksoi ndër të tjera kryeimami Sahiti.

KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË PUNËTORINË PËR VLERËSIMIN DHE ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E TERRORIZMIT 2023-2028

Më 4 dhjetor 2023, me ftesë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në Punëtorinë për vlerësimin dhe zbatimin e Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e

Terrorizmit 2023-2028 dhe planit të veprimit 2023-2025, në të cilën po marrin pjesë përfaqësuesit e institucioneve të vendit dhe ato ndërkombëtare si pjesë e grupit punues për hartimin e strategjisë dhe planit të veprimit.

Kjo punëtori u mbajt në Pejë dhe zgjati dy ditë, deri më 6 dhjetor.

Në hapje të Punëtorisë mori pjesë edhe ministri i Punëve të Brendshme, z. Xhelal Sveçla dhe ambasadori i OSBE-së në Kosovë, z. Michael Davenport.



U PËRURUA XHAMIA E RE NË FSHATIN PLESHINË E ULËT TË FERIZAJIT



Më 14 dhjetor 2023, me këndimin e tekbiereve, në mënyrë solemne, u bë hapja e xhamisë së re në fshatin Pleshinë e Ulët të Ferizajt.

Në këtë ceremoni, përveç shumë banorëve të fshatit dhe të rrethinës, morën pjesë edhe përfaqësuesit më të lartë të Kryesisë së BIK-ut, sekretari i Përgjithshëm, Ahmet ef. Sadriu dhe

kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti.

Ceremonia hapëse filloi me leximin e disa pjesëve nga Kurani fisnik, e më pas imami Mensur ef. Avdyli, përshëndeti të pranishmit, duke falënderuar kështu të gjithë ata që në çfarëdo forme kanë kontribuar në ndërtimin e kësaj xhamie.

Kryetari i Këshillit të BI-së së Ferizajt, Nexhmedin ef. Bajrami, tha se

përkundër faktit që kjo xhami qenka zbuluar me mure të bukura, kësaj, prapë se prapë hijeshinë ia jep xhemati e besimtarët.

Në fjalën e tij përshëndetëse, sekretari i përgjithshëm i Kryesisë së BIK-ut, Ahmet ef. Sadriu, tha se xhamia te ne është identitet, ngase ne me xhamitë, tregojmë se identiteti ynë është besimi islam.

Ndërkaq kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, foli rreth vlerës dhe rëndësisë që ka xhamia në aspektin fetar. Ai përmendi ajetet kuranore dhe hadithet profetike, të cilat flasin për vlerën e xhamisë. “Përgamperi a.s. në një hadith ka thënë se çdo xhami është një kopsht Xheneti, andaj, më lejoni që t’ju përgëzoj që tashmë edhe ju, me ndërtimin e kësaj xhamie, keni ndërtuar kopshtet e Xhenetit. Zoti i shpërbleftë me mirësitë e Tij të pakufishme të gjithë ata që kanë kontribuar në ndërtimin e kësaj xhamie” – tha kryeimami Sahiti.

KRYEIMAMI SAHITI TAKOI IMAMËT E GJILANIT

Më 18 dhjetor 2023, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në trajnimin e organizuar nga KBI në Gjilan, ku morën pjesë imamët e Këshillit të BI-së së Gjilanit. Fillimisht imamëve me një fjale rasti iu drejtua kryetari i Këshillit, Naim ef. Aliu, i cili falënderoi kryeimamin Sahiti për prezencën e tij në këtë takim, dhe imamët për punën e kontributin e tyre në mbarëvajtjen e jetës fetare.

Kryeimami Sahiti në pjesën e parë të paraqitjes së tij, në fokus kishte rolin dhe misionin e imamat në edukimin e brezave të rinj dhe sfidat e imamëve në kohët moderne, ndërsa në pjesën e dytë të trajnimit, kryeimami Sahiti, theksoi angazhimin e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës në organizimin e trajnimeve profesionale me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të kuadrit fetar, dhe në fund zhvilloi një bashkëbisedim me imamët lidhur me aktualitetin tonë.

Gjatë trajnimit, edhe imamët shpalosen përvojat dhe sfidat e tyre, me çka kontribuuan që ky trajnim të jetë më efektivë e më i suksesshëm dhe që ky trajnim të realizojë objektivin e vet. Ky ishte trajnimi i dytë me radhë për imamë, i organizuar nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjilan, që kishte për qëllim trajnimin e imamëve me moton “Imami i suksesshëm”.



KRYEIMAMI SAHITI TAKOI STUDENTËT E FSI-SË



Më 20 dhjetor 2023, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, së bashku me koordinatoren e Departamentit të Rinisë, Fejsal ef. Spahiun, pritën në takim Unionin e Studentëve të Fakultetit të Studimeve Islame, në krye me kryetarin e këtij Unioni, Arlind Gajtanin.

Kryeimami Sahiti falënderoi studentët e Unionit për angazhimin dhe përkushtimin e tyre në organizimin e aktiviteteve studentore, e më pas i inkurajoi ata që akoma më shumë të bashkëpunojnë dhe të koordinohen me Departamentin e Rinisë në organizimin e aktiviteteve kulturore e fetare, sidomos në organizimin e kurseve, seminareve

dhe aktiviteteve të tjera me të rinj me profile të ndryshme profesionale.

“Bashkësia Islame e Kosovës mbetet e përkushtuar që të mbështes aktivitetet rinore dhe përfshirjen e tyre në aktivitetet fetare të studentëve të Fakultetit të Studimeve Islame”, theksoi ndër të tjera kryeimami Sahiti.

KRYEIMAMI VEDAT EF. SAHITI MORI PJESË NË PËRURIMIN E RENOVIMIT TË XHAMISË SË FSHATIT PRELEZ I MUHAXHERËVE TË FERIZAJT

Më 21 dhjetor 2023, në mënyrë solemne, nën këndimin e tekbiereve dhe ajeteve kuranore, me praninë e përfaqësuesve nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Këshillit të Bashkësisë Islame të Ferizajt, imamëve, e shumë besimtarëve, u përurua renovimi i xhamisë së fshatit Prelez i Muhaxherëve në Ferizaj.



Në emër të Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë dhe në emër të BIK-ut, këtë tubim e përshëndeti kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i cili përcolli urimet e Myftiut Tërnavë për banorët me rastin e përrurimit të renovimit të xhamisë.

“Është kënaqësi që këtë sukses e gëzim ta ndajmë së bashku me të gjithë

ju, andaj lus të Madhin Zot, që të gjithë ata që kanë kontribuar për renovimin e kësaj shtëpie të Zotit, Zoti t’ju japë shëndet e bereqet në punën e tyre. Me këtë rast ftoj edhe xhematet e tjera që ta ndjekin shembullin e këtij xhemati në renovimin e xhamisë, në mënyrë që t’i

avancojmë shërbimet dhe të kemi hapësira më komode për kryerjen e faljeve e ibadeteve tona, sepse xhamitë janë të Zotit dhe në to madhërohet vetëm Zoti i Plotefuqishëm – tha mes të tjerash kryeimami Sahiti.

KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË KONFERENCËN E PARË TË KËSHILLIT EVROPIAN TË KURANIT



Nga data 22 deri më 25 dhjetor 2023, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në Konferencën e parë të Këshillit Evropian të Kuranit, e cila u mbajt në Stamboll të Turqisë.

Kryeimami Sahiti në kumtesën e tij kishte në fokus rolin e institucioneve edukativo-arsimore të Bashkësisë Islame të Kosovës në shërbim të Kuranit, duke filluar nga institucionet joformale të mektebit, ku zhvillohet

mësim-besimi, e që në qendër ka mësimin e Kuranit, pastaj Medresetë e hifzit, për të vazhduar pastaj me medresetë e mesme “Alauddin” e deri te institucionet e arsimit të lartë islam, Fakulteti i Studimeve Islame. Kryeimami mes të tjerash theksoi se mësimi i leximit të Kuranit, bukurleximit, rregullave të texhvidit, nxënies së Kuranit përmendsh, e mbi të gjitha kuptimi dhe interpretimi i drejtë i Kuranit ka qenë gjithmonë prioritet i

parë i institucioneve fetaro-arsimore të Bashkësisë Islame ndër shekuj.

Në këtë Konferencë morën pjesë mbi 52 delegacione nga qendra, akademi dhe institucione fetaro-arsimore nga vende të ndryshme të Evropës, si dhe nga Turqia dhe disa shtete të Lindjes së Mesme. Kryesues i kësaj Konference ishte dijetari i njohur i Kiraeteve dhe shkencave Kuranore, prof. dr. Ejmen Suvejd.

VEDAT EF. SAHITI, VIZITOI INSTITUTIN PËR HULUMTIMIN E KRIMEVE TË KRYERA GJATË LUFTËS NË KOSOVË



Më 28 dhjetor 2023, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, vizitoi Institutin për Hulumtimin e Krimeve të kryera gjatë Luftës në Kosovë, ku u prit nga drejtori, z. Atdhe Hetemi.

Kryeimami Sahiti fillimisht uroi drejtorin Hetemi për detyrën dhe

përgjegjësinë e re në krye të Institutit, duke i dëshiruar suksese e mbarësi dhe të njëjtën kohë theksoi gatishmërinë e Bashkësisë Islame të Kosovës për të bashkëpunuar me Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, sidomos në dokumentimin e krimeve në fushën e trashëgimisë kulturore-

fetare dhe asaj shpirtërore të shkatërruara dhe të dëmtuara gjatë luftës së fundit 1998-1999, ku pësuan perlat e monumenteve arkitekturore të trashëgimisë fetare islame në vend.

Nga ana e tij, drejtorit i Institutit, z. Atdhe Hetemi, falënderoi kryeimamin për vizitën dhe për gatishmërinë e Bashkësisë Islame të Kosovës për bashkëpunim në dokumentimin e krimeve të luftës, krimeve ndaj imameve të vrarë gjatë luftës, shkatërrimin e monumenteve dhe djegien e dorëshkrimeve dhe arkivës shekullore me rëndësi të veçantë për kulturën dhe historinë e popullit tonë.

Në fund të takimit, kryeimami Sahiti, i dhuroi z. Hetemit, monografinë e xhamive të Komunës së Vushtrrisë, i botuar së fundi nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Institutit për Trashëgimi Kulturore Islame.

KRYEIMAMI SAHITI VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË VITISË



Më 29 dhjetor 2023, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, qëndroi për vizitë në Këshillin e Bashkësisë Islame të Vitisë, ku u prit nga kryetari Husamedin ef. Hoxha dhe Kryeimami Xhevdet ef. Ismajli.

Kryetari Hoxha e njohu kryeimamin me ecurinë e jetës fetare në Viti, si

dhe e falënderoi atë për përkrahjen e vazhdueshme të Kryesisë dhënë Këshillit të BI-së së Vitisë.

Pas takimit, kryeimami Sahiti bashkë me kryetarin Hoxha dhe kryeimamin Ismajli, vizituan edhe parcelën e re të vakëfit, e cila është dhuruar së fundi nga

një familje bujare për ndërtimin e një xhamie.

Pas takimit, kryeimami Sahiti, mbajti hytben e xhumasë në xhaminë e Pozharanit, xhamia me e madhe e komunës së Vitisë.

KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË CEREMONINË E HAPJES SË QENDRËS SË RE TË MËSIM-BESIMIT NË GJILAN

Më 30 dhjetor 2023, në mënyrë solemne, nën këndimin e tekbiereve dhe salavateve nga nxënësit e mësim-besimit, në qendër të Gjilanit, u hap qendra e re për mësim-besim.

Në këtë ceremoni morën pjesë kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, kryetari i Këshillit të BI-së së Gjilanit, Naim ef. Aliu, anëtari i Kryesisë së BIK-ut, Agim ef. Hyseni, anëtarët e Këshillit dhe mualimet e këtij Këshilli.

Në fjalën e tij, kryeimami Sahiti, përgëzoi dhe uroi Këshillin e BI-së së Gjilanit, për kontributin dhe angazhimin e tyre, fillimisht për blerjen e këtij vakëfi të ri, e më pas edhe për përgatitjen e kësaj qendre për Departamentin e Gruas, me qëllim të zhvillimit të edukimit e të mësim-besimit, si dhe zhvillimin e aktiviteteve të tjera kulturore e fetare.

Gjatë kësaj ceremonie përrurimi, u ndanë edhe certifikatat për vijuesit e



mësim-besimit, të cilët kanë kryer me sukses ciklin e parë të mësim-besimit

pranë mualimeve të tyre, ku tashmë kanë filluar leximin e Kuranit fisnik.

DELEGACIONI NGA KRYESIA E BIK-UT VIZITOI AMBASADËN E KUVAJTIT NË TIRANË

Më 19 dhjetor 2023, delegacioni i Kryesisë së BIK-ut, i përbërë nga shefi i kabinetit Besim ef. Mehmeti, zv. sekretari Rexhep ef. Luma dhe zv. kryeimami Fatmir ef. Iljazi, vizituan Ambasadën e Kuvajtit në Tiranë, me ç'rast në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Myftiut Tërnava përcollën ngushëllimet më të sinqerta me rastin e kalimit në amshim të emirit të Kuvajtit, Sheikh Nevaf al Ahmet al Xhaber al Sabah.

Delegacioni në këtë takim u prit nga z. Khaled Ahmed al Shami, zv. ambasador i shtetit të Kuvajtit në Shqipëri, si dhe nga ambasadori i shtetit të Katarit, z. Jabir bin Ali al Dosari.

Ambasadori Al Shami e vlerësoi lart këtë vizitë, duke rikujtuar bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e mira të Ambasadës së Kuvajtit me Bashkësinë Islame të Kosovës.

Në librin e homazheve, shefi i kabinetit shënoi:

“Me ndarjen nga jeta të emirit të Kuvajtit, sheikut Nevaf al Ahmet al Xhaber al Sabah, populli i Kuvajtit humbi njërin nga udhëheqësit më të shquar të tij.

Ai ishte njeri i urtë, bamirës dhe ndihmëtar i popujve në nevojë në mbarë botën.

Lusim Allahun xh.sh. ta mëshirojë dhe ta bëjë nga banorët e xhenetit!”



Titujt e librave autorial të myftiut Naim ef. Tërnavë,
botuar së fundi nga Bashkësia Islame e Kosovës



DITURIA ISLAME • Nr. 398 JANAR 2024